

Festivali Ndërkombëtar i Poezië
“Ditët e Naimit”

Biblioteka
MERIDIANE POETIKE

Përgatiti
Shaip EMËRLLAHU

Këshilli botues
Ymer ÇIRAKU
Giuseppe NAPOLITANO
Craig CZURY
Ndue UKAJ
Silke Liria BLUMBACH
Xhelal ZEJNELI
Niels HAV
Bujar PLLOSHTANI
Francoise ROY
Isuf SHERIFI
Arjan KALLÇO
Shaip EMËRLLAHU

Përktheu
Silke Liria BLUMBACH

Piktura e ballinës dhe të brendisë
Reshat AMETI

www.ditetenaimit.org

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë
“DITËT E NAIMIT”

Edicioni XXII

PËSHTJELLIM I DENDUR



Ditët e Naimit
Tetovë, 2018

UNIVERSI POETIK SI SHIJE ESTETIKE

Letërsia si art i fjalës është tërësia e domosdoshme ideo-estetike e prirur të shërbejë në çdo kohë, dhe si e tillë mundëson ta njohësh ekzistencën e njeriut, konceptin e botës dhe veten. Letërsia është shkencë që përpiqet të hapërojë në udhë të cilësuar, duke vënë në dukje realitetin shoqëror përmes figurave letrare, dhe vetëm kështu, si e tillë ajo mundëson në njohjen e jetës së njeriut dhe të botës. Ndërkohë, po të kemi në kujtesë atë që thoshte filozofi Martin Heidegger se, «*Arti është rruga kryesore përmes së cilës ndodh e vërteta*», na kthjellon mendimin se, artet në përgjithësi na shpiejnë drejt të bukurës, pra shijes estetike dhe të vërtetës së duhur.

Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «*Ditët e Naimit*», me të drejtë mund të konsiderohet si simbol i rezistencës dhe dominimit të kulturave të ndryshme, dhe si simbol i fjalës së bukur për përparimin e njeriut për të sjellur ndryshimin e domosdoshëm te raca njerëzore, dhe kulti për të cilën njeriu duhet të kalojë veten mbi fatin ekzistencial. Poetët e botës, përmes fjalës si shije estetike, janë prezent për të shprehur emocionin nga poezitë, që realisht burojnë si një e drejtë e pamohueshme për realitetin njerëzor. Poetët e botës, përmes fjalës do të jenë një zë metaforik, me synimin për të ngritur zërin ndaj fenomeneve të imponueshme, dhe porositë se si duhet të duket një model i përsosur i artit, individit dhe shoqërisë së qytetëruar. Pra, «*Ditët e Naimit*» me poetët e kulturave të ndryshme të botës, që aq bukur e identifikojnë poezinë përmes fjalës estetike mbeten si «*krijues të vërtetë të fjalës së bukur dhe të diversitetit kulturor*».

Poetët sjellin copëza shpirtrash, ku me stilet e tyre, që mund të kuptohen si veçantia e çdo poeti, kujdesen të shmangin gjuhën e zakonshme para publikut. Edhe

«Ditët e Naimit», si arenë që tubon poetë nga vende të ndryshme, pothuaj janë të ngjashëm me pikëpamjet e mirëfillta individuale, duke u përpjekur të ruajnë shprehësinë emocionale dhe gjuhën e zakonshme para publikut entuziast. Kur jemi te pikëpamjet e poetëve që vijjnë të entuziazmuar për të sjellur pak poezi në mesin tonë, them mbase kanë arritur ta bëjnë mjeshtërisht të kuptueshme për masën, se arti është shija e vetme estetike që ka mundësinë për ta bërë një shoqëri dhe një masë të tërë për vete.

Porosia e fjalës poetike midis poetëve të huaj dhe atyre vendas mund të thuhet se reflekton si një lundrim ajrorë të shpirtrave të lirë. Si rrjedhojë «Ditët e Naimit» simbolizojnë kultin poetik që sjell diversitetin kulturor përmes fjalës së bukur për të imponuar pak shije estetike, ndërsa poetët, simbolizojnë fjalën që është e gatshme të thyejë gjuhën e forcës, të keqen, duke dashur të reflektojë mirësinë, barabarësinë dhe lirinë. Poetët përmes fjalës premtajnë absolutisht të mirën, edhe pse e keqja është më e imponueshme si koncept individual e shoqëror. Por, kjo nuk është e gjitha, edhe «Ditët e Naimit» si institucion kulturor tashmë posedon në praktikë atë sensin për t'i kthyer poetët brenda një zëri që sundojnë të bukurën dhe reflektojnë të mirën e duhur gati për çdo shoqëri. Që me fjalë tjera janë poetët, ata që e kuptojnë më së miri se funksionimi dhe zgjidhja më e mirë e fenomeneve të ndryshme shoqërore bëhet përmes tolerancës, dhe jo dominimit ndaj tjetrit. Kështu që, Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit» mund të konsiderohet si një zgjidhje përafërsisht e ngjashme, ku përmes organizimit brilant sjell poetët e të dy poleve të reflektojnë mirësinë, shijen estetike dhe të bukurën ndër racat njerëzore.

Letërsia dhe kultura shqiptare në përgjithësi dhe vetë kujtimi i poetit Naim Frashëri, në njëfarë mënyre ndërliidhet ndjeshëm me kulturën dhe qytetërimin evropian. Shkrimtari ynë i shquar, Ismail Kadare në një prej edicioneve të këtij festivali është shprehur se, «Kultura shqiptare dhe vetë kujtimi i Naimit të Madh, të gjitha këto bëjnë pjesë në qytetërimin evropian». Prandaj, edhe poetët e botës të entuziazmuar zbresin në tokën pranë shtatores së Naim Frashërit, në Tetovë, për të nderuar kujtimin e tij me kulturën dhe qytetërimin evropian. Ky është nder dhe kujtim i pazëvendësueshëm ndaj vle-

rave kombëtare, dhe ndaj poetëve që tubohen për të reflektuar sadopak shije estetike në mesin e publikut.

Leximet e poezive nga poetët, si të thuash me ëndje i përjetojmë, ku së pari pa asnjë dyshim përpiqemi të pluskojmë brenda shijes, duke u munduar ta njohim poezinë. Poezia është krijim që brenda duhet të përmbajë filozofinë e mendimit mbi çështje të ndryshme shoqërore dhe ekzistenciale. Lexuesi ndeshet me poezinë, pra me vargjet që i referohen ndjesive, dashurisë, botës, njeriut, dhe kështu, ai mund ta përjetojë porosinë që paraqitet nga poetët. Gjithkush prej poetëve të talentuar kërkojnë me ngulm ta shprehin të bukurën dhe rëndësinë e saj për shoqërinë dhe kohën. Poetët shohin përtej realitetit njerëzor dhe përmes fjalës së bukur e kthen këtë realitet si çështje thelbësore. Festivali Ndërkombëtar i Poezisë «Ditët e Naimit», këtë realitet njerëzor e arrin ta bëjë realitet thelbësor përmes poezive të poetëve të botës, ku në esencë reflektojnë shijen estetike nga anët e ndryshme të poleve, të cilët i sjellin me emocione përpara publikut artdashës.

Festivali i poezisë, me përmasa ndërkombëtare «Ditët e Naimit», përgjatë rrugëtimit të vet ka mundur të përcjellë emocione nga më të ndryshmet, dhe ndërkohë poezinë dhe kulturën shqiptare e ka vënë në vëmendjen e poetëve të botës. Mes tjerash e ka kthyer universin poetik, si një shije estetike, ku rrezaton gjurmë përtej anëve të rruzullit. Poetët e botës me poezitë e tyre shquajnë refleksione mbi të vërtetën dhe të bukurën, si simbol që lëvizin përjetësisht, ku në thelb e pasurojnë dhe e zhvillojnë ndërgjegjen e individit dhe të shoqërisë.


Poezia si formë e artit të shkruar, në të cilën gjuha njerëzore përdoret për ato cilësi estetike, ku të ndërlikuarën e bën vërtet të thjeshtë, duke e ruajtur në përmbajtje gjithnjë shijen estetike. Poezia është zbritur përmes muzës te mendjendriturit, me synimin për ta shquar të vërtetën dhe për ta ravijëzuar të bukurën sublime brenda njeriut. Të jesh poet duhet të jetë mbase nevojë e patjetërsueshme që lind nga qiejt. Duket të jetë një nevojë e domosdoshme shpirtërore të pajisesh me muzën për të shkruar poezi, pasi përmes poezisë në njërin anë mund të luftohen bindjet hermetike të pushtetmbajtësve, dhe për të vënë një shpresë në anën tjetër, që mbase mund të ngre një popull të zhytur me forcë në zhgënjimin ekzistencial. Kështu, edhe Festivali Ndërkombëtar i

Poezisë «Ditët e Naimit» e ka pasur për qëllim, që të tubojë zëra poetësh nga vende të ndryshme të botës, me shpresën për të sjellur sa më shumë besueshmëri, shpresë dhe përndritje për një fat të ri ekzistencial në mesin e publikut artdashës.

Të tillë janë poetët, të rrëmbejnë me fjalën e tyre, që e kanë si nevojë të kohës dhe si domosdoshmëri për ta reflektuar të mirën si mjet ekzistencial. Poetët e talentuar, ndoshta në këtë mes janë të paktë, por fjala e tyre si shtizë depërton anekënd rruzullit.

Bujar PLLOSHTANI

Fitues i çmimit letrar "Naim Frashëri"
Beat BRECHBÜHL (ZVICËR)



BEAT BRECHBÜHL (ZVICËR)

Beat Brechbühl u lind më 28 korrik 1939, në Opplingen, ndërsa fëmijërinë e tij e ka kaluar në Niederwichtrach. Në qytetin e Bernës ka mësuar zejen e litografisë. Kundrejt kësaj zeje, ai ka ndjekur edhe

kurse shkollimi për fotografi dhe typografi.

Nga viti 1966 deri më 1971, ai ka qenë redaktor i revistës CLOU dhe nga viti 1964 deri më 1965 në Berlin dhe Cyrih vazhdon sërish të punojë si vendosës shkronjash në pllaka shtypshkronjeje. Nga viti 1966 deri më 1971 ka qenë udhëheqës për botim i Shtëpisë Diogeni në Cyrih. Në vitet 70 realizoi shumë emisione në radio në kuadër të programit „Musik&Lyrik“ (muzikë dhe poezi).

Nga viti 1971, ai punon si shkrimtar i lirë dhe në grafik, së pari në Wald, kantoni i Cyrihut. Nga viti 1978 deri më 1985 ai ka udhëhequr me Shtëpinë botuese „Zytglooge“ në Berlin. Më 1980, ai themelon Shtëpinë botuese „Walgut“, e cila nga viti 1987 qendrën e vet e ka në Frauenfeld të Kanonit Thurgau. Më 1985, paralel kësaj Shtëpisë botuese „Waldgut“, lind edhe „Atelie Bodoni“, e cila merret me shtypje të librave, kryesisht kopertinave përmes teknikës së kallajit. Beat Brechbühl jeton në Frauenfeld.

Beat Brechbühl shkruan kryesisht poezi, prozë për të rritur dhe për fëmijë.

Ai është anëtarë i Penqendrës së Zvicrës Gjermane dhe anëtarë i Shoqatës së Autorëve dhe Autorëve të Zvicrës.

Beat Brechbühl është njëri ndër autorët shumë të lexuar, si në në kaluarën, por edhe në të tashmen. Nga qarqet letrare dhe nga kritika e vendit ai çmohet për punën dhe krijimtarinë e tij të vazhdueshme, e cila ka filluar që nga mosha 16 vjeçare.

A botoi një numër të madh veprash letrare (42 tituj)

Publikimet e Beat Brechbühlit janë të katalogizuara dhe mund të gjenden në katalogun HELEVTICAT, të Bibliotekës Nacionale Zvicerane.

Në këtë kalaogizim gjenden të arkivuara 123 vepra, tituj librash të Beat Brechbühlit dhe për Beat Brechbühlit. Aty, pos librave në gjuhën gjermane, gjenden edhe librat e tij të botuara edhe në shumë shtete të botës, siç janë librat e botuara në gjuhën angleze, franceze, rumune, italiane, polake, japoneze, shqip etj. Beat Brechbühl është prezentuar në mëse dhejtëra e dhjetëra antologji të vendit dhe jashtë tij.

Çmimet dhe shpërblimet

- 1966 dhe 1968 Çmimi për Literaturë i Kantonit të Bernës
- 1970 dhe 1999 Çmimin e Fondacionit zviceran të Shillerit në Zvicër. (çmim ky ndër tre çmimet më të mëdhaja që jepen në Zvicër)
- 1973 Çmimi Vjetor për Kulturë i Kantonit të Cyrihut.
- 1975 Çmimi Conrad – Ferdiandn - Meyer
- 1978 Çmimi për librin më të mirë për fëmijë të Kantonit të Cyrihut
- 1985 Çmimin për literaturë të qytetit të Bernës.
- 1987 Çmimin për austriak për librin për fëmijë.
- 1992 Çmimin e Librit të Qytetit të Bernës.
- 1999 Çmimin për Literaturë të Bodensee (çmim që e ndajnë tri shtete bashkarisht: Zvicra, Gjermania dhe Austria)
- 1999 Çmimin për Kulturë të Kantonit Thurgau.
- 2001 së bashku me Atelien e tij Bodoni, çmimin Victor Otto Stomps që e ndanë qyteti i Mainscit në Gjermani.
- 2009 Çmimi i Mirënjohejhes së Lartë i qytetit të Frauenfeldit.

MOS PYET KU DHE PSE

- udhëtoj lëvizem jetoj.

Kërkoj bukurinë në ndryshimin e vendeve të tua. Pi etjen për tjetërkund, për të qenë tjetërkush.

- lëvizem jetoj udhëtoj.

Kërkoj kuptim në aventurat e jetës: pafjalësi, kam harruar gjithçka që thashë më parë. Kuptim në këtë kuptim: një vaskë uji të zbrazët të mbushur me shkumën e mallet tuaja.

- jetoj udhëtoj lëvizem.

Nganjëherë natën vizitohem nga të afërmit e mi. Cendrars Chatvin Orhan Veli Kanik Segalen Gauguin Bashô.

Nganjëherë preken vetmitë tona, nganjëherë një fjalë familjare, një buzëqeshje përtej dhimbjes, drejt burrave, në drejtim të grave.

- udhëtoj lëvizem jetoj.

Të udhëtosh është të hysh në errësirë dhe të shohësh gjithçka më mirë.

Të futesh në gjithçka si në dashnoren dashnorin.

Të ndiesh mrekullitë e jetës dhe vdekjes:

të hash dhe pish me to, të dashurosh me to dhe të jesh gazmor. Të ndahesh nga to dhe të jesh i trishtë.

Jeta. Vdekja. Udhëtimet nga njëra

te tjetra. Ndarjet nga tjetra

drejt njëres.

Pessoa, këtij treni i ke hipur në të vërtetë.

Dhe nuk ke zbritur më: ende

ecën

tej e më tej dhe

Përktheu nga gjermanishtja

Silke Liria Blumbach

LETRA

- livadhi i thatë erotik
për fjalët e mia.

- vetëm 2000 vjeç i ri,
material dytësor sensual haptik
nga bimë dhe
lule të njëhershme.

Krahë fluturë.

*Përktheu nga gjermanishtja
Silke Liria Blumbach*

SALSA CUBANA

Celulari im: 1 katastrofë plus. Kurrë me vete, i
pangarkuar,

i mbyllur, ose thjesht mut, zero.

2 x në jetë e pata me vete: siç duket, i hapur, i
ngarkuar,

çdo gjë në rregull, në xhep (i harruar).

1. Në teatrin e mbushur të qytetit Bremen: I vetmi
recitim pa muzikë & zhurmë,
një poete e re gjermane, e qetë, zë të mirë, poezi të
mira, impresionuese,
ngroh zemrën & trurin. BAM > në heshtje përdëllim:
celulari im, *Salsa cubana*,
zhurmë muti! & crescendo! Të gjithë më shpuan me
shikime vrasëse.

Derisa të kuptoj se nga vjen kjo salsë,
bota u ngordh – edhe unë nga turpi.

2. Referati „Poezia e sotshme“ në Zyrih. Kapardsje
universitare,
hundëpërpjetë, pa humor. Kush interesohet për
këtë?

Pse jam unë këtu?

Pastaj fjalía e shenjtë:

„Poezia në formën e saj më të pastër është ende...“

BAM > *Salsa cubana* nga xhepi im, në kohë më të
përshtatshme, & crescendo! Kjo më pëlqen:
poezia është salsa cubana, nuk e mbyll celularin
menjëherë – me vonim;
nuk dua të linçohem.

A po sheh: *Celulari merde*. Por santa *salsa cubana*,
duke u qaravitur nga xhepi i BB-së, duke bezdisur
të shenjtën,
marrëzi malagueña, réaction bernoise
pra vonë a kurrë.

Olé celular Santana.

Olé celular nirvana.

Ciao salsa. Amor furor.

Mendoj që sonte do të gatuaj ende lakër turshi me
rrush dhe salcë kosi.

Mariposas,
gjuha në formën e saj më të lehtë,
e shpërthyer në ngjyra,
duke çukitur nga pak fjalët, gjuhët,

duke çukur shikimet, në trupat,
duke ndier lëkurën
duke harruar zërat.

(Duke llupur një gosti të madhe shprehjesh
- por jo pa salsë.)

*Përktheu nga gjermanishtja
Silke Liria Blumbach*

KUR FILLON DASHURIA

kur fillon dashuria, s'e di asnjë
saktësisht; pas një gjysmë gotëze
ndoshta,
ka të ngjarë, atje
apo pastaj -
E di gruaja kur fillon dashuria, e di

burri? Më pak e di fëmija,
më pak akoma e dinë gratë e thinjura
dhe burrat e tharë, askush nuk e di,
kur fillon dashuria -
Ndoshta pas një toni të ngrohtë,
ndoshta pas një fjale të bardhë,
ndoshta gjatë lyerjes së panines në librarinë Biazza
ndoshta tek një ndarje, teksa dora ime,
vetëpërgjegjëse poshtë bluzës sënde zgjatet -
Kur dashuria fillon,
unë s'e di, ndoshta
pas të qeshurës tënde,
ndoshta në peizazhet fantastike të lëkurës
dhe në afërsinë frymëngrohtë,
ndoshta pas largësisë, pas mallit kaltërosh,
apo pas një prekjeje tjetër fjalësh
apo simpatisë çelur madhërishtëm.
Se kur fillon dashuria,
nuk i duhet askujt ta dijë saktësisht. Detyruar
je të rrish pikërisht zgjuar për ta vënë re,
që ta japësh, ta marrësh. Por ndoshta
ajo nis edhe në gjumë.

Kryesorja, ajo është këtu e beftë si
stuhia magjepsëse, si rrufeja e ngadaltë miqësore dhe
qejfprishur.

E mua më pëlqen, kur kjo rrufe
qëndron paksa dhe duke çelur
stërpik
lëkurën tonë,
duart tona, që pastaj e dinë
ç'duhet bërë, po kështu dhe këmbët,
flokët, gjuha, buzët,
gjithçka e di, ç'duhet bërë, që
tërmetimi i brendshëm
të shndërrohet së jashtmi në një ngarkesë të plotë,
gjersa vdekja e vogël të shtyn tek jeta vlonjëse e të
mishëron

marrëzishëm -
një ditë mbrëmjet bëhen më të freskëta,
valët e detit tonë thyejnë
ngjyrat e vjeshtës,
e paskëtaj hamë paninet e mbushura,

pijmë verën e athtë të Friaulit,
 dhe jeta lirshëm nis
 prapë e prapë &
 ndoshta shkon më tej,
 e ti ke aromë të mirë për mua,
 shumë të mirë,
 jashtëzakonisht të mirë
 e më pas erëmoj unë si ti dhe ti erëmon si unë
 & e tëra
 jep një pështjellim të dendur
 të gjatë të fuqishëm përfshirës

që me sa duket do të zgjasë akoma
 që s'don të dorëzojë asgjë
 përkundrazi - dhe
 çka është kjo e kundërt e madhe, ju duhet
 ta shihni & të jeni vetë.

*Përktheu nga gjermanishtja
 Ferdinand Laholli*

ÇIFT GJATË NGRËNIES SË DARKËS

I heshtojnë njëri-tjetrit.
 Hanë gjënë e përhimtë.
 Pastaj bien
 të vdekur prej karrigeve.

*Përktheu nga gjermanishtja
 Ferdinand Laholli*

ESENCA E BEHARIT ME GRUAN E SHEQERTË

E ëmbël dhe e bollshme
 unë
 të gjerb të thith
 dhe askush

s'më ndal dot
& askush s'më pengon
të të puth duke përplasur buzët tërë dëshirë dhe epsh
ty
rrjetë e ngrohtë
shalqini.

*Përktheu nga gjermanishtja
Ferdinad Laholli*

“KJO ËSHTË THJESHT KËSHTU.”

I dua gratë e kolme që rrinë shtrirë,
kur dielli i mëngjesit dhe i mbrëmjes bie
mbi këmbët e saj belin faqet
shkurre dhe hendeqe, kur
hap kofshët, mbledh krahët përbrenda,
ngre vetullën mbi sy,
kur pusët e kërthizave sisët -
kur era shikimet e mia
turbullon me bukuritë, kur
ëmbëlsia e prekësve të stinëverës
më anon çakërdisë, kur
arinjtë e lëkurës gicilojnë kokrra gishtash,
gjuhët thithin shtëpi veshësh,
nëse kuq brun bjondë flokëzinj
lajkatarë mërmëritje ledhësi gishtash
rrumbëllsi shpatulle gjerbje gjuhësh,
zhurma prej lëkure në lëkurë,
trupa në trupa,
kundërmimet e tua, të fuqishmet, dhe parandjenjat,
se ato flatrojnë si rritja e fuqishme
e pranverës
nëpër nervat e mia
dhe unë i dua
gratë e kolme që rrinë shtrirë
o shpinë deti, o marri e butë.
Hopa-la.

*Përktheu nga gjermanishtja
Ferdinad Laholli*

PORTRETI I MADH PËR TY

E hënë mbasdite, autostrada
 Cyrih-Bern, peizazhi heshton
 para shiut, fjongoja notuese e asfaltit
 është e pabesë si fjalë e rrejtshme
 e befas,
 tre kilometra drejt mbi autoban,
 ndonjë Krisht vigan hap
 qiellin, dhe pas peizazhit
 ngrihet i brishtë
 një qiell i kaltër,
 një balonë e një premtimi,
 dhe mes kësaj skice
 varet një eksplozim uji
 në formën e një morri gjigand, varet
 duke pompuar dhe ikur,
 para zjarrit përfshirës,
 një qiell mbushur zjarr,
 një shpirt mbushur zjarr,
 marria e plotë është mbi autostradë,
 e unë udhëtoj me 160
 brenda këtij qielli-ferr.
 (E kështu të dua.)

*Përktheu nga gjermanishtja
 Ferdinand Laholli*

FETA BUKE LYER GJALPË E QEPË TË NJOMA PËRSIPËR

Së shpejti vij në shtëpi,
 më the në telefon.
 T'i lyej gjalpë dy feta buke e qepë të njoma përsipër,
 ato të pëlqejnë më së shumti,
 natën pas një udhëtimit të gjatë autostrade. Edhe
 vetes ia lyej dy të tilla. Nëse
 do t'më duhej veç të të shihja gjatë ngrënies,
 kisha për të vdekur nga uria
 dhe kënaqësia për ty.
 E vë edhe Rozenë korsike e vë të ftohet -

sikurse ti e shpie nëpër mend,
 ti kurrë nuk thua gjë,
 por mjerë, po të mos jetë ashtu.
 Gëzohem çdoherë si një fëmijë,
 kur ti ha fetat e lyera gjalpë e qepë të njoma.
 E ndërkohë rrëfen mbi punën tënde,
 e shqetësuar,
 apo e lodhur.

*Përktheu nga gjermanishtja
 Ferdinand Laholli*

MJEKIMI I RASMIHE HUSSEINIT NË ZVICËR

I

Madje as Allahu s'e dinte,
 përse Gamal Farrid Husseini me gruan e tij Rasmihen
 dhe tetë fëmijët & një veturë të ndryshkur
 erdhi në Zvicër.

Ciganët nomadë nga Jordania
 qëndronin habitur dhe të prekur
 mbi veturat e shpejta të zviceranëve
 në mes të Cyrihut.

Frika e policëve mbet modeste;
 qenë mësuar, ciganët dhe llumin e shoqërisë
 t'i vendosnin te kufiri
 për pasurim të përgjithshëm të botës së jashtme.

II

Thuhet se nomadja Rasmihe
 kishte vjedhur 300 franga zvicerane ndaj u dënua
 me 3 muaj burg;
 meqë:

300 franga zvicerane japin burgim për 3 muaj,
 (është e qartë!)

pra

jep për shembull një vjedhje
 mbi 3 milionë - pa zbritjen për shuma të mëdha -
 një sasi burgu prej 2500 vitesh.

Këtë së paku
 duhej ta dinte një grua cigane

për Zvicrën,
përpara se të vidhte diçka
tek firma Gelbert në Cyrih.
Tjetra:: fisi qe kundër,
ta linte vetëm nënën,
se një gjini është një gjini njerëzore -
por policët njohin vetëm gjininë e tyre,
dhe kjo është policia.
Askush s'e mbajti për të domosdoshme
të merrej një përkthyes, nga që
gjuha e shenjave të policisë
është mëse e njohur botërisht,

III
dhe personat ligjorë e shpunë Rasmihen
në burgun e Hindelbankut*,
që ruhej nga lulekuqet e qeshura
dhe drejtori Majer.
Të tronditurës tërësisht, gruas astmatike
donin T'IA MËSONIN TË PUNUARIT
se siç dihet PUNA TË BËN TË LIRË
dhe sidomos në Zvicër është mëse shëndetprurëse,
përafërsisht si gëlltitja e një gërshëre apo
tharja-në-diell e një truri të gjallë.
Britmat e Rasmihes njihnin
veçse kufinj të shiringave të infermiereve,
që i rrëfenin asaj, se i shoqi
qe shpërngulur pa adresë familjarisht;
TEKSA NË TË NJËJTËN KOHË Farrid Husseini tok
me pesë nga fëmijët kërkonte dëshpëruar gruan e tij,

një javë të tërë,
çdo ditë,
në ndërtesën e policisë kriminale
në rrugën e depove të armatimit në Cyrih.
Marquis de Sade nuk qe në shtëpi, porse pasuesit e tij
të zellshëm, në uniformë, dëshminë e sjelljes
pikturuar direkt në fytyrë. Pra
përmes sharjesh gjarpër e gënjeshtar
policia e flaku në rrugë
grupin nënëkërkues
se është mirë, të kesh një rrugë,

kur vendbanimi i njerëzve është mjaft i ngushtë
dhe mbushur plot
me perime të zgjedhura

IV

Ndërkohë infermjerja R. ua rekomandoi të burgosurve
të tjerë
në Rendelbank,
në një shpërthim të ri dëshpërimi të Rasmihes,
thjesht të trokisnin
së jashtmi në derën e qelisë,
për të mos i dëgjuar britmat e Rasmihes.
Më pas infermjeres R., që personalisht qe ngopur
me marrëzinë e nomades,
i erdh në mendje dhe premtoi
t'ia tregonte Rahsmihes njëherë,
t'ia bënte asaj siç duhej një shiringë
të lishin paskëtaj të gjithë qetësi.

Infermjerja R. vendosi gjilpërën, dhe menjëherë kishin
të gjithë

të gjithë

të gjithë

QETËSI

prej vjedhëses, nomades të sëmurë rënde, ciganes
Rasmihe Husseini.

V

Dhe

Farrid Hussein u thirr nga jashtë shtetit, ku
qe dëbuar,
të merrte
kufomën e gruas së tij
tek zyrtarët.

- Që të merrte kufomën e gruas së tij tek zyrtarët.

- Që ai, Husseini,

të merrte kufomën e nënës së fisit,

e cila, siç thuhet,

kishte vjedhur 300 Franga

në një dyqan makinash qepëse dhe hekurosëse të
frimës Pfaff

në Cyrih
e për këtë qe dënuar 3 muaj dhe Hindelbank të
ngahershëm.

- Që Farrid Husseini ta largonte kufomën
prej derës së fajtorit.

- Që
ne
të jetojmë në paqe
dhe
të mos
ndryshojmë
kurrë.

*Hindelbank: qytezë në krahinën Burgdorf të
kantonit të
Bernit. Në kështjellën e Hindelbankut ndodhet burgu
i grave, i
vetmi në tërë Zvicrën.

Përktheu nga gjermanishtja
Ferdinad Laholli

CIGANIA

Për Frans Halsin

Për një natë, vashëz,
për një natë.
Këtu s'hiqet dorë prej asgjëje veç kohës.
Këtu s'ka ç'të humbitet përveç një takimi.
Këtu s'ka asgjë ç'të heshtohet
veç dashurisë.
Për një natë, vashëz, një të pafundme,
natë zhuritëse.
Ikur prej mendjes, hyjnizuar çastin,
larë në djersë prej shtytjes dhe dëshirimit,
shendi lakmitar i syve,
gjuha,
veten duke harruar supeve gjatë,
sisët mbushur hareje,

vetja e harruar ijëve barkut,
 e befase paturpshmja brendësi e butë
 e kofshëve -
 Për një natë, vashëz, për një natë vitale,
 të paharrueshme.
 Ti pohon me kokë. Ti qesh.
 Ti s'mendon tek mëngjesi, unë s'mendoj tek
 mëngjesi ... asnjë tjetër nuk është në botë
 këtë natë

Vetëm një emër, si një rrugë e numër shtëpie
 diku, vetëm shkarkimi i një behari
 të ndalur, i tërësishmi mosrespektim i njerëzve,
 kjo është e tëra çka mbetet.
 Pastaj e mbramja prekje e kujdesshme nga buza
 në buzë, e vetmja mirënjohje e çiltër për
 botën tonë -
 Le të çohemi. Po agon.

*Përktheu nga gjermanishtja
 Ferdinand Laholli*

THELBI I SHOQËRISË

1

Të shohësh vështrime, të nuhasësh, të pish.
 Të prekësh lëkurën te vendet e simpatishme dhe de-
 likate,
 të gjesh një vetëdijë, një kopsht mbushur besueshmëri.
 Ta nxjerrësh diellin spontan
 prej ngricës permanente të SiAshtuEdhe,
 prej pickimit të mushkonjave të mediokërve,
 prej fraksionit të letrave mërzitëse.

2

2-3 herë në vit egoja ime prodhon shumë testosteron.
 Kush më dorëzohet mua: haleluja. Ai apo
 ajo nuk dua të jem.
 Ne shpesh përshpetohemi
 dhe me pasion zemre

kritikojmë pjesën më të mirë të vetes.

Por 1-2 të tillëve u kërcënohet një fat i çuditshëm:
bëjhem miq, ngandonjëherë të bollshëm; ngan-
donjëherë
dhimbjeprurës.

3

Çuditërisht

veç çekanë të fillë shendimi të fshehtë u bëjnë ballë
të shumtave bashkëshortësimuti përditshmërie & festash,
Perpetuum Mobile të drejtësisë miqësore, apo:
çfardo që të bësh: qëndrojmë qiri më këmbë.

Ngandonjëherë nuk na shohin dhe aq mirë
dritës së ngrysur;
ngandonjëherë guximi ynë nuk është aq solid;
ngandonjëherë marrim përsipër më shumë
nga ç'mund të bëjmë;
ngandonjëherë jemi thjesht veç të dobët.

4

Nëse rinia është boshe
nëse puna bërë e përcjellë më tej
nëse festat ngopur me gjumë
Nëse lodhur kohërat më të mira
nëse mosha nxjerr jashtë gjembat e panevojshme
nëse të rralla lulet
nëse netët të buta e të gjata
nëse diejt më të ftohtë
nëse puthjet më të rralla

5

Miqësia është lidhja më e mirë
pa ceremoni, shtet apo organizatë.
Lidhëset zgjidhen rrallë, por
ato mund të këputen apo flenë.

6

Shokët nuk rimohen.
Shokët nuk janë problem matematikor.
Shokët nuk janë armiq janë shokë.

7

Njerëzit pa partnerë janë ishuj notues.

Njerëzve pa fat s'u janë rritur flatra.

Njerëzit pa fshatra janë qytet i zbrazët.

Njerëzit pa shokë asnjëherë s'kanë kuptuar gjëkafsh
dhe jetën e tyre jo e jo.

për Gudrunin

*Përktheu nga gjermanishtja
Ferdinad Laholli*



TOZAN ALKAN

(TURQI)

I lindur më 1963. Ai është anëtar i *PEN-it turk*, *Sindikatës së Shkrimtarëve të Turqisë* dhe *Shoqatës Turke të Autorëve*. Prej 25 vjetësh punon si pedagog në Universitetin e Stambollit. Ka përkthyer shumë poetë dhe autorë nga anglishtja, frëngjishtja dhe spanjishtja në turqisht, si Anatole France, Charles Baudelaire, Lord Byron, Victor Hugo, Oscar Wilde, William Blake, Emily Dickinson, Tristan Tzara, Philippe Soupault, D.H. Lawrence, William Butler Yeats, Antonio Machado, Garcia Lorca dhe Alfonsina Storni. Poezitë e tij u përkthyen në shumë gjuhë. Ka marrë pjesë në shumë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare poezie, panai-re libri dhe punëtori përkthimi. Botimet e tij të poezisë: *Koha dhe maska* (Botime Donkişot, 2003), *Mbrëmje të hershme të zemrës* (Botime Donkişot, 2005), *Po era* (Botime Artshop, 2007), *Death will hit the spot* (Poezi të përzgjedhura në anglisht, Botime Yasakmeyve, 2009), *Një qytet do të vijë drejt teje nga larg* (Botime Yasakmeyve, 2012), *Derë e hapur* (Botime Islık, 2014). Ai është njëri prej koordinuesve të Festivaleve të Poezisë në Izmir dhe në Eskisehir. Ai është anëtar i *PEN-it turk*, *Sindikatës së Shkrimtarëve të Turqisë* dhe *Shoqatës Turke të Autorëve*.

— 27 —

PËRGATITJE PËR VERËN

Sikur të isha në një vakuum i pezulluar në humnere

Eja, le të gjejmë një pije të nxehtë diku
Një derë të gjatë, porta për ëndrra të pafund
Një gjuhë që askush nuk flet më
Domate të thara dhe diej të tharë
Një mace të përgjumur bredhëse, një dashuri që nga
askush nuk përfiton
Në lagjen historike *Yeldeğirmeni*
Bukë dhe verë në pezullim
Përralla që pëshpërit në vetë veshët e tu
Eliksirë varfërie dhe vetmie

Vera është larg, në gjysmë të rrugës drejt fytyrës sonë
Vera është larg
Ka shelgje të larta
Ka parqe të braktisura
Tinguj që parashikojnë të heshtin
Dhe ngjyra që parashikojnë të vshken
Ekranet çeliku për t'i mbajtur zogjtë të burgosur,
Frymëmarrje dhe fjalë të grumbulluara brenda nesh
Çdo grua ka një animus
Çdo burrë, një verë
Ka në gjithçka diçka të papritur
Diçka që prisje të gjeje

Eja, shih, është kthyer dashuria jonë e vçit
Pemë të shkulura nga vendet e tyre në pyll
Bashkë me kapelet tona janë edhe çadrat tona
Legjendat e Mesjetës të harruara prej kohe
Ninulla, shkronja të lëna jashtë, shkronja të reja për të
mbushur boshllëkun
Tani le të heqim qafe gjërat e këqia deri të hënën e
ardhshme
Dhe të gjejmë ndonjë pije të nxehtë për të na ngrohur
Ti, eja me mua, vera ende është larg.

JEPNI VEND PËR MUA MES JUSH, MIRË?


Isha ende i njomë dhe i izoluar në avullin e një trilli
I mësyre nga një tallaz që ka marrë haraçin e vet,
Çdo tallaz më bëri të kaltër nga e ftohta
Isha një fëmijë i druajtur duke pritur adoleshencën
Ti mund të më marrësh për një borzilok mali
dhe në qytet, një lajmëtar të heshtur
Kujtoj se si u hidhja pulëbardhave simite të shijshme
Duke anashkaluar Tokën poshtë
Ku një brohoritje e llahtarshme pengonte njerëzit ta
dëgjonin njëri-tjetrin

Duhet të isha një hero në një përrallë të lashtë prej
kohësh në harresë.
Një i huaj isha që kishte ardhur vjedhurazi mes jush në
mënyrë të shkathët
Të themi, si një sëmundje, si dridhërimi i inteligjencës
Graviteti specifik i një guri, distanca midis dy zogjve
Një shkronjë munguese në një tufë letrash në historinë
e dashurisë
Një thikë në dhimbje goditëse; po, sa frikë kisha, në të
vërtetë
Frikë nga gjakderdhje, mund të merresha për një
pjesëmarrës në një eksod
Si një rrënjë që shkon thellë, si një rrugë që ndërron
drejtimin
Isha në kohët para përmbytjes së botës, kur ende isha atje
U ula për të kapur frymën time në hijen e botës,
bota ishte e juaja, hëna ishte e juaja, kurse unë
gjendesha diku midis parajsës dhe Tokës, midis një
gënjeshtrë dhe të vërtetës, midis një ëndrre dhe një
gjumi, midis betonit dhe dheut.

Isha i hutuar nga ndjenja shpërqëndruese si një luledielli
Që ishte çuar nga shtrati në vapën erëmirë
Dhe rastësisht u ngulita në bishtin e një balone
I fshirë nga një erë, isha një kalë i liruar për t'u durur
sipas dëshirës
Duke mos marrë pjesë më në garat për shkak të një
plage të gjakosur
Tani ndihem si çapkën i përjashtuar nga një lojë nga
djem të tjerë



Valzim 2. Vaj në pëlhurë 70x60 2018



BRAHIM AVDYLI (KOSOVË)

Brahim Ibish Avdyli është i lindur më 5. IX. 1960, në fshatin Morinë, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës. Që në vitet e hershme të rinisë u dha pas dy priirjeve: pas artit të fjalës dhe pas lëvizjes konspirative për lirinë dhe bashkimin e kombit shqiptar.

Autori merret paralelisht me shkrime shkencore, gazetar e publicist, krahas krijimtarisë letrare (prozë, poezi, dramë, etj.)...

Avdyli e ka kryer shkollën fillore "Ganimete Tërbeshi" në Morinë e Ponoshec; Gjimnazin "Hajar Dushi" në Ponoshec të Gjakovës; Fakultetin e Filologjik, Dega e Letërsisë e Gjuhës Shqipe, në Universitetin e Prishtinës; Sudimet Diplomike e Pasdiplomike në UNI të Strugës/Maqedoni, Fakulteti i Shkencave Politike, Dega "Marradhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci". Atje e ka mbrojtur edhe temën e Magjistraturës, në vjeshtë të vitit 2010.

Ka botuar këto libra:

- "Në hijen e Alpeve", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1983;
- "Buka e kuqe", poemë, Atdheu, Cyrih, 1990;
- "Kur zgjohet Dodona", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1992;
- "Pasqyrë e përgjakur", poezi, Marin Barleti, Tiranë, 1994;
- "Klithje nga fundi i ferrit", poezi, Onufri, Tiranë, 1997;
- "Gjuha e dheut tim", poezi, Albin, Tiranë, 1999;
- "Klithje nga fundi i ferrit", botim i dytë, Jeta e Re, Prishtinë, 2000;

- "Baraspesha e humbur", poezi, Qëndresa, Gjakovë, 2003;
- "Vragat e një kohe", prozë, Faik Konica, Prishtinë, 2005;
- "Lëvozhga e vdekjes", prozë, Faik Konica, Prishtinë, 2007;
- "Stelele Veşniciei /Yjet e Përjetësisë", Poezie albanez, din Kosova, BKSH të Rumanisë, Bukuresht, 2008;
- "Zogu i këngës", poezi të zgjedhura, SHB "Pjetër Bogdani", Has, 2009;
- "Mërgata shqiptare e Zvicrës dhe roli i saj", politikë e publicistikë, Brezi `81, Prishtinë, 2011;
- "Qielli i paprekur", poezi, Brezi `81, Prishtinë 2012;
- "Vetëvrasja e një poeti", dramë e kthyer nga romani me një titull tjetër, Shoqata e Intelektualëve "JAKOVA", Gjakovë, 2013;
- "Shtegtimi i lirisë", poezi, Faik Konica, Prishtinë 2014;
- "Torzo e shpirtit tim/Der Torso meiner Seele", zgjedhje e poezive në shqip e gjermanisht, Amanda Edit Verlag, 2015;
- "Arena e dhembjeve", poezi, Meshari, Prishtinë 2017, etj...

Krijimtaria e tij është shpëtblyer me disa çmime letrare. Ai është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (LSHK); i Autoreve dhe Autorëve të Zvicrës (AdS); i Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë të Mërgatës (LKMSH); i Lidhjes së Poetëve Ndërkombëtarë, Galaktika Poetike "Atunis";... dhe i disa organizatave të tjera...

Poezia e tij kryesisht është përkthyer në gjuhët italisht, gjermanisht, rumanisht dhe anglisht...

KUJTIMET E KËSAJ BOTE

Dal papritmas në breg të këngës
 shoh Naimin të copëtohet me qirin që digjet,
 shoh Asdrenin që martohet me vetminë
 për të mos e përsëritur veten,
 shoh Çajupin të nxjerrë zemrën
 e të gjej Stefanin të gjallë
 duke u martuar përfundimisht me dhembjen...

Migjenin e ndej në veten time sikur të isha mësues
të më digjej zemra me leckat e Lulit të Vocërr,
hijen tonë që shet veten
për pak qindarka nëpër botë,
botën e madhe të vendlindjes me vetminë...

Jam i njëqindti fyell i kësaj botë
nga Deti i Zi e deri në Oqeanin Atlantik-
Naim Beu, ti Asdren, i mjeri Çajup
më pritni kur të vi me Migjenin e Vocërr për dore

e të qajmë së bashku kujtimet e kësaj botel!...

PËRMASAT E SHTEGËTIMIT

Kam ecur pafund
nëpër shtegun e shqetësimeve
për ta gjetur njeriun e humbur

dhe kam ndihmuar ëndërrën e tij
që të mbijë e gjelbërt
në fushën e hapur të përpjekjes.

Nuk e di kush ka vrapuar më shumë
ditë e natë përmbi dallgë
me këmbët e qullura të këngës

diellin e fshehur për të zënë
përtej reve të mbarsura në vetëtima!

Shpesh kam braktisur vetveten
e shembur jam nga ankthet e mbledhura
nëpër skutat e ferrit

kotjen e kam ndjekur nga sytë
gjumi që të mos na zërë
në prehrin djallëzor të dështimit!...

Nuk di kur jam nisur së pari,
nuk di kur jam ndalur së fundi
për të qetësuar unin e cfilitur,

zembrën e kam lëshuar prore në fluturim
që të vizatojë diellin e shpirtit
me krahët e praruar të dashurisë
në mes të horizontit,

e ndjekur pastaj e kam nëpër kohë
deri në pikën e panjohur
të ngarendjes së pafund!...

DRITARET E DITËVE

Mëngjeseve
zgjohem e dal përsëri
në dhomë të pritjes


e ulem
para tryezës së kohërave...

Për dritaret e hapura të ditëve
futet shëndetshëm Dielli
e buzëqesh
sikur dëshironte të më përkëdhelë...

Mirë o Diell
pak më ngroh e më jep shpresë,
ditët do të sjellin
gjithë të mirat
me rrezet tua të pashmangshme,

por, unë, vërtet,
do të ik përtej të mundshmes

e do të kthehem
me Diellin e ëndrrave të mia...



NOAH AYALA

(PORTO RIKO)

I njohur edhe si n.o (no otha - askush tjetër), u lind në Reading, Pennsylvania dhe u rrit në ishullin e Porto Rikos.

Më vonë si djalë i ri u kthye në Reading.

Atëherë u takua për herë të parë me hip-hopin. Ndikimet e tij përfshijnë klanin Wu-tang, Mobb Deep, Big Pun, Mos Def, Nas dhe Jay Z. Gjithmonë mendonte se hip-hopi ishte më shumë se vetëm rap, qenja një kulturë, një mënyrë e pasionuar e shprehjes. Kjo formë arti është ushqimi bazë në jetën e tij, poezia / fjala e folur është arma e tij e preferuar.

Më 2010, Noah pat debutimin e një pjesë të talentit të tij në Samitin e Reading-ut të Hip-Hopit, ku ai mori pjesë në shumë ngjarje lokale.

U bë po ashtu anëtar i Berks Bards-ve, me të cilët mori pjesë në ngjarje si poezi kinetike, reale për jetë, 100 mijë poetë për ndryshim, Shpirti flet, Qendra "RACC Miller" për artet.

Noah Ayala pëlqehet edhe për angazhimin në bashkësinë e tij.

U botua në gazetën "Reading Eagle" dhe disa revista, si "EL PALO", "Latino Lifestyle" dhe "Afro Latino".

Ka organizuar shumë punëtori dhe ngjarje për ndarjen e kulturës së fjalës së folur dhe hip-hopit nëpër shkolla, si shkolla "I-LEAD Charter", kolegji "Albright", universiteti

“Pace”, universiteti “Kutztoën”, burgu rinor “Abraxas”, “Second Street Shelter” si dhe Shtëpia e Fëmijëve në Reading.

Momentalisht po punon në librin e tij dhe organizon një ngjarje mujore lokale, “Thepoetree”.

Gjithmonë, mund ta gjesh Noah-un duke u shprehur poetikisht diku.

NËPËR QYTETIN

Nëpër qytetin kohët e fundit, gjithçka duket aq e ngulët
Aq e orkestruar.

E vendosur aq mirë.

Sikur një gjigant që me kujdes vë të gjitha pjesët mirë
dhe bukur kurse ne flemë gjumë thellë

sikur çdo hap që hedhim u vendos atje me dashje që
të ndjekin shputat tona.

Këto rrugë do të të gëlltisnin plotësisht, bësomë.

Nëpër qytetin kohët e fundit, gjithçka duket aq gri.

Re të çuditshme me rreze ananasi mangoje që djegin
nëpër hijet e diellit

duke krijuar ngjyrime të ndryshme.

Këto rrugë më kanë krijuar plotësisht duke të zbehur ty.

Një prodhim prodhimi, edhe unë do ta urreja.

Ua ngul sytë dritareve të thyera që projekton mbrapa
bllaqe

të rrethuara nga gardhe të galvanizuara me brava me
shilte.

Nëpër qytetin kohët e fundit, të duhet më shumë se
vetëm fjalë si armë.

Një vend i njohur gjerësisht për vajza skaute që shesin
mendër të hollë dhe tregtarë droge që shesin

drogat e tyre,

poetë që flasin fjalët e tyre dhe politikanë të korruptuar
që shesin shpresën e tyre.

Ky shkëmb që u lye me paqe tani është vetëm një
pjerrësi e mbuluar.

Nëpër qytetin kohët e fundit, asgjë nuk duket e drejtë.

Një djalë 15 vjeçar vdes nga një brisk në kanalën e tij
 të frymëmarrjes,
 një burrë grabitet për një qindarkë pastaj humb jetëm
 kurse djem të hijshëm zbehen çdo të tretën ditë të
 shqetësuar që nuk duken mirë,
 fytyrat e tyre kundër xhamit shikojnë nga jashtë brenda
 duke jetuar të kundërtën e kësaj jete;
 nuk duket e drejtë.

Një ndryshim i vogël në dritare prej xhami kur era fryn
 turp
 Retë gri ulërijnë përsëri,
 "Këtu po vjen shiu!!!"
 Furtuna e pikëllimit e pasuar nga dushi i dhembjes
 A ke humbur ndonjëherë një vëllë nga një e shtënë?
 A u gjuajte ndonjëherë nga policë nëpër 12 blloqe të
 qytetit?
 Apo a fjete në një pikë kokaine edhe pse dije që ishte
 e nxehtë?
 Me siguri jo.
 Disa jetojnë në frikë nga jeta e përditshme.
 Disa flenë gjumë por nuk fikin kurrë dritat.
 Të tjerë lypin në fund të kësaj fuçie për vetëm një ditë
 tjetër.

Nëpër qytetin kohët e fundit kam parë gjak e më
 shumë
 Kam parë fqinj të mbyllur brenda shtëpive të tyre tepër
 të trembur për t'i hapur dyert
 Kam parë shiun të vërshojë rrugët tona të ndotura
 duke shpëlarë plehurat në breg.
 Kam parë burra të pastrehë jashtë që lypnin për kusur
 nga derdhej dëbora.
 Kam parë qytetin dhe këshillin e vet duke mbyllur dyert
 sepse folëm dhe kishim nevojë për më shumë.
 Kam parë ruajtëset e rendit që dhanë gjoba vetëm
 sepse ishin të mërzitura.
 Kam parë njerëz në nevojë që injoroheshin troç.
 Kam parë burra të rritur të shtrirë në trotuar me
 çarçafe kartoni
 dhe ndërtesa në kushte të përsosura të mbuluara nga
 trarë.
 Sikur të pasurit të bëheshin euforikë duke u ngopur
 dhe grumbulluar.

Pyetja është
Për se i duhen një burri të vetëm të gjitha këto
ndërtesa?
A duhet të them më shumë?

MUZA IME

U largova nga skena por ende kisha diçka për t'u
thënë
Ende nuk kisha mbaruar
Doja të flisja për dashuri doja të komentoja për urrejtja
Doja të bërtisja por nëpër heshtjen mund të dëgjoja se
si era theu një pikë gjilpëre
Ndihem si gjilpërë në mullar sane të bërë mullar dikur
në një mënyrë që askush mund të më gjejë
Fola troç por verbërisht
Domëthënë duartrokitjet e audiencës më verbërojnë
drita po nxin reflektimin e zbehtë të lëkurës sime
Betohem që çdo herë që flas
nuk jam unë
por një forcë aq e fortë brenda meje që rri thellë përtej
ekzistencës sime
ka një distancë një rezistencë e pafolur midis nesh
mes meje dhe muzës sime
dhe nuk dua të tingëlloj i hutuar
por është ky zjarr brenda meje që ndez atë siguresë
herë të panumërta u shtriva mbrapa dhe shikoja si
gjithçka mbushej
a mund të kem, ju lutem, një çast heshtjeje
Jo
jo tani
sepse mu tani kjo do të ishte gjëja e gabuar
nuk kam të gjitha përgjigjet por këto shkrime
ndihmojnë të zbulohen çelësat
edhe kjo heshtje respektohet më shumë kur kjo heshtje
vjen prej teje

I ULUR MBI VERANDËN

I ulur mbi këtë verandë kuptova pse shumica e burrave
ëndërrojnë

Kam qenë këtu më parë por kjo gjë kurrë s'më shkoi
ndër mend

Çfarë të shkreh brenda

Pse një grabitës bën makinacione ose pse një grua aq
e përsëritshme shprehet dhe këndon

Pse tragjedia përgjithësisht sjell dhembje dhe pse hip-
hop ka qenë gjithmonë ëndrra e një burri të varfër

I ulur mbi këtë verandë kuptova pse shumica e burrave
ëndërrojnë

Ka më shumë qiell se tokë

Është shumë më i madh se ne

Pse luftojmë për një objekt të cilin e bëri njeriu

Që thekson fjalët "në Zot ne besojmë"

kur në fund të ditës na krijoj të gjithë njëlloj
dhe pikërisht për këtë arsye eshtrat tanë do të marrin
kore

vërtet cili është dallimi mes dashurisë dhe qejfit

kur shikoj përreth në dhomë dhe zbuloj ujkun në
veshjen e deles

kujt mund t'i besoj

drogimet e jetës kur bie ç'do të marrim si patericë

i ulur mbi këtë verandë kuptova pse shumica e burrave
ëndërrojnë

nuk është një çështje e tij ose e saj është më tepër për
ne të gjithë lypësit ndjekësit

udhëheqësit dhe madje ata që vendosën të na vizitojnë
ata që duan të ndryshojnë të shikojnë qiellin lart duke
thirrur zot të lutem mjaft

kumarxhiu kur djersa del nga balli i tij, me dëshirën që
do të kishte marrë letra të tjera

ne të gjithë duam diçka ç'mund të jetë kjo për mua

i ulur mbi këtë verandë zbuloj pse shumica e burrave
ëndërrojnë

ishte një edukim i rëndë duke i parë si binin

ishte e dhimbshme të dëgjoje zërat e tyre duke injoruar
thirrjet

vetëm duke dashur që gjithçka të mbarojë dhe unë
jam pjesë e kësaj kauze
stilet e jetesës së të pasurve dhe të famshëmve ua
kthejnë fytyrat në mashtrime
ndërkaq në botën time duke krijuar hapet e mia duke
shkruar citatat e mia
duke jetuar përcaktimin e vërtetë të këmbënguljes
kam parë gjithmonë atë që nuk mund të pikturonin
kurrë
shkrim të shenjtë pas shkrimit të shenjtë
a mund të pikturosh një pikturë pa kornizë pikturë me
asnjë mur të thjeshtë banuesi
kanë kaluar disa vite prej rënies së një aeroplani
por çdo ditë djali im thërret babi a mund të më ngresh
dua të luaj lojën pushim
kur predikuesi më tërheq vëmendjen
djale a je i humbur duke shikuar dimrin që fiton dhe
mbulon ngricën e dheut
kush jam unë
Jam vetëm një poet një djale i ri i trazuar që u rrit dhe
tani e di këtë
Jam balsami i buzëve për buzët e tua të plasaritura
Gabova u profilova dhe gabimisht u akuzova nuk
është vetëm rap
Përfytyrohu duke shprehur një ëndërr me frymën e
shpirtit tënd
Dhe fuqinë e një ekipi
Kurse je i ulur në xhinset e tua
Kuptova i ulur mbi këtë verandë pse ëndërrova
shumicën e jetës sime



**SLLAXHANA
BOJANOVSKA**
(MAQEDONI)

Sllaxhana Atanasova u lind më 27 maj 1988 në Blatec, Maqedonia Lindore. Ka diplomuar në Katedrën e Letërsinë komparative dhe të prëgjithshme në Fakultetin Filologjik

“Blazhe Konevski”, në Shkup.

Ka marrë pjesë në puntori krijuese në Strugë, në Mbrëmjet poetike të Strugës, Nata e bardhë në Shkup, Poetët për ndryshim, Strumicë, në Festivalin Ndërkombëtar në Tiranë, në Festivalin Ndërkombëtar të Poezis në Kiev/Ukrainë etj.

Ka botuar vëllimet me poezi:

“Kerubin në han” 2006

“Njerëzit në vakum,, 2009

Ka botuar tregime, poezi dhe ese në revista të ndryshme në vend dhe jashtë saj.

Është përkthyer në disa gjuhë të huaja dhe ka marrë pjesë në Festivale të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare.

DUKE KËRKUAR SHTËPI

Tërë jeta e verës ah,
mbaron kur e vë në gotë.
Të shoh në të je,
e ndërron formën

dhe shndërrohesh në njeri.

Vallë ndoshta nuk je ti?

Por, përsëri,
për shkurt kohë kthehesh
në formë të verës.

Vdekje.

pa dhimbje ajo të shtyn në pafundësi,
fundosesh në atë trup njeriu që të pi,
përgjithmonë,
pa e kuptuar atë, ti ikën.

Në heshtje. Ti hesht

dhe e zemëruar lëviz nëpër venat e tij.

Ti nuk kërkon ndërtime tempujsh.

Ai të mbyt, të ndalon të shfaqesh nga fillimi.

Më vonë e tëra është e kot,
sado që të tmerrohesh zhdukesh,
megjithatë ti je verë.

Harresë.

Era nuk të prek dhe nuk të ngroh,
ngase ti nuk zhdukesh nën tokë,
varri yt është trupi i njeriut.

Ti nuk ekziston tanimë,

ngel vetëm aroma në fund të gotës,
paramendo sa e fshehtë është e vërteta për jetën,
kush do ta zbulonte në këtë errësi të thellë.

Si edhe tymin në pasqyrë.

Askush nuk i përmbledh hijet endacake,
ajo që atyre u nevojitet është bota e pangjyrë,
vetëm padukshmëria e eshtrave të tyre
i vesh në vdekje,

vetëm sytë e verbër ngushëllohen.

Nuk lëshon zë,

tymi luan mbi sipërfaqe të pasqyrës,
me shumë karaktere
agresiv, i sjellshëm, i qetë.

Tym dhe muzikë me shumë karaktere
në shtëpinë e pasqyrës.

LOJA

Tani jeta jonë është aq e shkurt
 Sa, duke u afruar te përgjigjet
 E humbim zgjedhjen
 E mundësive të shumta.
 Patjetër të shpejtojmë
 Rrëshqitja e jetës
 Është arsye e mirë që t'vendosim
 Për ndryshime të shpejta
 Pa bërë lëvizje të gabuar
 Edhe në këtë parti shahu.

GJAHTARË TË ANASHKALUAR

Poqëm ca ëndrra të dyshimta
 shpalosëm ca mahi.
 Shtrydhëm edhe dy tre fate dashurie

U gjetëm si të përkëdhelur nga jeta
 Të përbirë nga mendimet
 E pakursyera e të prapështa
 U ngarkuam me pamundësinë


Dhe tani mendoj
 këtu është fundi, vallë ky është
 Apo ka edhe diç tjetër
 nga kurthet e turpshme të mendjes

FJOLLËBORE

Notoj në pluhurin e lodhjes
 u linda nga djersa e hijes tënde
 u ngjalla në vesën e mëngjesit
 më mbuloi përqaqimi i motit të keq...
 Më fal, unë nuk e dija se ekzistoj,
 më fal, nuk e dija se ekzistimi im
 do të ndihmoj të sfidosh frikën
 Më fal, që vdiqa shumë herët.

Por, ti më thirr unë përsëri
Do të ngjallem.
Unë kam kokë ujore
nuk kam formë, do të vij
e jotja jam shkrihem nga prekja jote
do të vij të më vrasësh me prekje ledhatuese...

Përktheu: Ekrem Ajruli



PIERFRANCO BRUNI

(ITALI)

Është lindur në Kalabri. Është drejtor Arkeologjik i ministri-së së kulturës trashgimore, formalisht pjestar i Komitetit të UNESCOs për difuzionin e kultures italiane jashtë vendit, është udhëheqës i Qendrës së Studimeve “Grisi”. Ai gjithashtu ka detyra të shumta institucionale në lidhje me promovimin e kulturës dhe literaturës në shtetet e huaja. Ai është përgjegjës për projektin e studimit për Prezencën e Minoriteteve në Itali në emër të MiBAC.

Ai ka botuar libra me poezi (duke përfshirë “Via Carmelitani”, “Traveling Island”, “Do not Love You anymore”, “Moonlight Fire”, “Requiem Song”, “Ulisse is broken”, “I’ll love you” asleep in the red of your afternoon”), tales and novels (including “The Last Night of a Magistrate”, “Country of the Ęind”, “Claretta and Ben”, “The Last Spring”, “And then came dreams”, “Ęhen the rocks bloom”, “The sea and the shell”). Ai ka qenp i pprfshirp në Italianin e shekullit të 20, literaturën Euro-piane dhe Mesdhetare. Ai është përballur me literaturën e shekullit të 20 me librat Pavese, Pirandello, Alvaro, Grisi, D’Annunzio, Carlo Levi, Quasimodo, Ungaretti, Cardarelli, Cat, Pen, Vittorini etj.

KËNDOMË, O HYJNESHË

1

Hapat e mi
Mbartin brazdën e Homerit
Ndër udhëtimet e Uliksit
Dhe pasionin e Elenës.
Nuk do të ketë më histori tjetër
Në këngën e mitit
Pas zjarrit të Trojës.
Këndomë, o hyjneshë,
Nga shkëmbi i Safos
Për vajtimet e bukurisë.

2

Elena nuk kërkoi
Prej marrëzisë
Përëndimin e dashurisë
Në Tempullin e Erës.
Kur e mësoi prej shpirtit
Koha u ndal
Në fushën e mitit.
Era flaku tutje
Kripën e valëve
Për një premtim të pambajtur
Apo një shpresë të përhumbur.

3

U zgjuam
Kur po niseshin anijet
Dhe remat u lëshuan
Mes valëve.
Dritat duhen
Për t'i larguar fantazmat
Nëpër çarrjet e humnerës.
Hyjnesha e bardhë u largua
Kur zërat e natës
U bënë kimerë.

12.
Shkrova në fjalët e tua
Gërvishtjen e vetmisë sime
Por nuk përpiqem
Që të të tregoj
Orët e njohjes së pashmangshme.
Jemi dy zëra
Që dialogojnë
Pa thënë asgjë.
Sikur të mos ishte kjo
E shohim njëri-tjetrin
Në mungesë
Që ta kërkojmë njëri-tjetrin
E t'i tregojmë
Atë që ne tash e dimë.

13.
E pyes veten shpesh
Përse u largova
Duke e përdhelur fytyrën tënde
Atë mbrëmje të kapërcyer
Mes një hapësirë hëne
Dhe një ylli të djegur në errësi.
Nuk kishte pishtarë
Por mes fijeve të udhëtimit
Nuk e mendova kurrë
Se midis nisjes dhe kthimit
Fiton gjithmonë
Nisja.

14.
Tani ai kujtim
A do të m'i sjellë vallë kujtimet e tua?
Apo cili kujtim
Do të më përcjellë
Në kujtimet e tua?
Desha të luaja me ty
Lojën e fundit të shahut.
Por
Sa e hutuar është jeta.
Nuk e vuri re
Që ti
Ma kishe bërë me hile
Duke e spostuar në çastin e fundit

Kullën tënde.
Unë rrashë në kurthin tënd
Të lëvizjes shah mat.

15.

Gjithmonë u përpoqe t'i justifikosh
Ofendimet dhe plagët në zemrën tënde.
Unë si luftëtar që ecën
Kam qënë gjithmonë në llogore
Që të bëja
Luftrat dhe heshtjet e mia
Përballë horizontit.
Humba dhe fitova
Por edhe me fitoren
I harxhova humbjet e mia.
Në vetminë e kësaj dhome
Mbaj ndër duar
Çibukun e magjistarit.
Çdo re tymi
Është një erë e çmuar.
Tenda ime
Mbeti
Në shiun
E kopështit
Dhe ndoshta këtë herë
Rëra ndodhet mes gurëve.

16.

Është me hënë kjo mbrëmje.
I theva anët e horizontit.
Ti je një hije
Një dëshirë që i thurr fijet
E harmonive tona të shkuara.
Gjendet gjithmonë një pikë
Në rrethin që e përcakton
Udhëtimi i Arianës
Tek ia rrëmben kohën Ulksit.
Fushimi im
Nuk i ka më perde me shirita.
Me vallëzimin e fallxhiut
I qepa prapë
Epokat e bastit.
Ti je një shqiponjë
Dhe unë një luftëtar.

17.

Po të më duhej të vrapoj përgjatë
 Trembëdhjetë hënave
 Nuk do të të çoja në pragjet e guvave
 Por do të të lija të dëgjoje
 Këngën e eksodit.
 Thërrime mbeten udhëtimet
 Gjysma të vërteta
 Gjysma gënjeshtër në të vërtetat.
 Edhe pse jam i lodhur
 Nuk jam shumë i lodhur
 Që të të tregoj
 Ëndrrën e Alices
 Midis letrave të trukuara.
 Nëse mundesh
 Qëndro akoma pranë meje.
 Kështjella
 Dikur e fshehur nga palma
 I ka kullat e rrëna
 Dhe era
 Ngjan me një banderolë kujtimesh
 Që s'kanë më shtigje.

18.

Loja me fjalët
 Është një ves midis heshtjes dhe absurdes.
 Nata e ka morsën e ditëve të thyera
 Prej klesidrës në rërë
 Tek mban gjurmën e heronjve të Homerit.
 Luftova në beteja kujtimesh
 Por vdekja ngjan me mungesën
 E syve të tu
 Që turret
 Si një uragan
 Në rrugët e detit dhe fushave të gjakut.
 Kur luan me fjalët
 Merr fund furtuna
 E përjetuar në brejtjet
 E mundimeve të paforma

Përktheu Arjan Th. Kallço



Nga tradita 18.5. Vaj në pëlhurë. 70x90 2018



**GEMA BOCARDO
CLAVIJO**
(SPANJË)

Avokate, shkrimtare, redaktore dhe tregimtare.

Tregim historish dhe recitime poetike prej fëmijërisë së saj. Ishte pjesëtare e Rrjetit të Artit të Ri të Bashkësisë së Madridit.

Poetja e parë spanjolle që recitoi në "Tirremën e Poezisë Joniane", Sarandë, Shqipëri. Disa prej shkrimeve të saj letrare u përkthyen në shqip dhe maqedonisht.

Bashkëpunëtare e *lamagiadelossentidos.com*. Shumë prej poezive dhe tregimeve të saj u botuan në revista letrare, faqe interneti dhe blogje. Edhe në antologji kolektive si:

Prozë (përralla dhe tregime të shkurtra):

Banco de Maridos Defectuosos (Banka e bashkëshortëve me të meta)

Viejos Amigos (Shokë të vjetër)

Poezi:

Ecos del Grito (Jehona të klithmës)

Diez Voces de la Poesía Actual (Dhjetë zëra të poezisë bashkëkohore)

Palabra Viva (Fjalë e gjallë)

Punto G (Pika G)

Disa prej çmimeve të saj letrare kombëtare dhe ndërkombëtare

Prozë:

Ars Creatio (2012)

El Dinosaurio (2013)

Marzorelatos (2013)

Aste Nagusia (2014)

Biblioteca de Godella (2015)
Aldaia Cuenta (2015)
Ángeles Palazón (2015)
Pasión por Leer (2016)
Konkurs letrar “Por la Igualdad” (Për barazinë) nga Ayuntamiento de Burgos (2017)
Certamen Internacional de Microrrelatos de Pilar de la Horadada (2017)
Poezi:
Picapedreros (2012)
Aseapo (2013)
Tamariu (2015)
La Nucía (2016)
Bullas en Verso (2017)
Blog: Puentes y muros (<http://gemabocardo.blogspot.com.es/>) (Ura dhe mure)

KUR ISHA NJË VAJZË E VOGËL

Vetëm më duhej një qen
dhe një ishull të shkretuar për t’u humbur,
sepse njerëzit ikin,
tradhëtojnë,
lëndojnë.

Por kur u rrita mësova
që vetmia është e përhershme
sepse qentë vdesin.
Qentë vdesin.
VDESIN.

Çmimi i parë i poezisë për gra La Nucía 2016

LOJË

Në plazh
një djalë i vogël
qëllon babain e vet
me gishtin e vogël.
Babai bie në ujë
dhe çohet
përsëri.

Djali i vogël qëllon
dhe babai i tij pluskon mbi valët
duke pretenduar që ka vdekur.

Të dy po qeshin.

Trembem të mendoj që
ndoshta,
pas një kohe,
si i rritur
qëllon një tjetër
duke besuar ende
që është lojë.

KËLYSHA

Një ambulancë në një qoshe.
Para meje, dy fëmijë të vegjël.
“Çfarë mund të ketë ndodhur?” pyeti djali.
Vajza u përgjigj: “Një plak më pak”.

Ecte shpejt.

Në secilën dorë

një rrip qeni.
Këlyshat bindeshin
por ajo tërhiqte fort
duke lënduar qafet e tyre.

Duhet të ketë ndier shikimin tim
sepse u kthye për një çast.
Fytyra e saj u befasua
kur ajo lexoi në sytë e mi
përbuzjen.

Habitem
se sa mjerim
një zemër e vogël
mund të mbajë.

Finaliste në I Certamen Literari Tamariu (2015)



Drita 18.3. Vaj në pëlthurë. 70x60 2018



YLLI ÇELA (SHQIPËRI)

Ylli Çela u lind më 1966. Shkollen fillore dhe gjimnazin i kreu në Pogradec. Arsimin e lartë e mbaroi në Universitetin “Aleksander Xhuvani”, Degën Mësuesi. Mbaron studimet e larta në 1989. Për tre vjet rre-

sht punoi aktor në Teatrin “Skampa” në Elbasan me regjisorin, Artistin e merituar, Spiro Duni. Punoi mësues në Mokër.

Me 1998, botoi vëllimin e parë poetik me titull. “Koha në çantën e zemrës, ku ka marrë edhe shumë çmime të para në shumë konkurse poetike. Ai njihet edhe si gazetar i gazetës lokale “Enkelejast” dhe këngëtar i muzikës popullore. Për shumë vite është marrë me biznese të ndryshme dhe së fundmi si specialist i aktiviteteve kulturore artistike dhe sportive. Ka në duar vllimin e dytë poetik.. “100 perla për dashurinë”. Ai ka rreth 1500 poezi e tregime të pabotuara. Thuajse është i lindur për dashurinë. Do ndahet nga poezia kur zemra të mos rrahe më... Do ndahet nga arti, kur zemra do thotë stop... Dhe jeta do i thotë; Më fal që me art s’të ngopa dot... Për te, arti është dashuria më e madhe se vetmia në jetë.

NATA TINZARE

Sonte nata, dhe hëna,
mbi ujë dhe terr,
kërkojnë të treten.
Nata ulkonjë,
që kërkon, të gllabërojë vetveten.
Një jetë të tërë uri,
që nginjet , duke ngrënë uri.
Kërkon
të shqyejë hënën, nëpër det.
Për të ngopur egon,
dhe xhanin e vet.
Nata, gremisur,
në humnerën e marazit,
në fund të hoazit.
Nata...
Katilja... Nga hyn, e del hilja.
Nata tinzare ,
që pjell vetëm „zarare“.
Heshtarakja, që su lodh njëherë,
duke përgjuar derë me derë.
Natë... Shhhhhhhh... Qetsi.
Nata, po jep shpirt në terr të zi.
Duke, mbllaçitur një copkë dashuri.


KOMSHIA E VJETER...

Ajo portë, ishte e re atëhere,
kur, trokisja dhe ikja me vrap.
E dija që trokitjen ma ndjeje.
Po s'dilje se, s'të linte yt at.
Pastaj, sikur mu „rrite“.....
Dhe vitet të mësuat,
të tjera marifete.
Seç,
të pëlqenin ca llafka me lulka.
Dhe „gangensterët“ ,
që aq kollaj, i bëje për vete.
Një ditë,
veshe fustanin e bardhë.
Dhe more,

atë që ishte, „i pari“ në radhë.
Por...
..zgjodhe interesin , jo dashurinë.
Prandaj,
dhe jeta të iku rrokullimë.
Dhe sot,
po kaloj pran portës së vjetër.
Brenda saj, asgjë s’pipëtin.
Veç maces që qan,
për maçokun e komshijes.
Sepse,
ka net, që ja ka harruar shtëpin.

KËNGË SABAHU..

Ç’më thua darkës lanete?
Moj nepërrka që më trete.
Hallet, barrë përmbi vete.
Ç’më lëpihesh, ndër lezete.
Në mëngjez ,pa zbardhur mirë,
Përmbi gjoks, ma shtie synë.
Zgjoju moj. Ta piva gjinë.
Me se do, ushqesh fëminë?!
Prit më thua, o i poshtë.
Atij qumësht, ty kulloshtë.
Qajm’ të dy, unë dhe ai.
Shërruam, për pakëz ti.
Të dy, për të njëjtin gji...
Kush më parë, po ta pi?!
Ti, mëndjen nga mua.
Dorën shtrir nga djali.
Qasmu moj leshhënë.
Të zëntë poshtë mali.
Më zhuriti zjarri.
Mëllaga me vesë.
Që kur linde djalë.
Seç më lë pa pjesë.
Moj drit e mëngjezit,
Që për ty bëj be...
Ja më fut në ise.
Ja më fut në dhë.



Nga tradita 18.14. Vaj në pëlthurë. 60 x70 2018



ERINA ÇOKU

(SHQIPËRI)

Erina Çoku ka mbaruar shkollën e mesme “Pjetër Budi” në Burrel (1994-1998) dhe studimet e larta për Gjuhë-Letërsi (profil Gjuhësi), në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Ti-

ranës (1999-2003).

Ka botuar dy vëllime poetike: “Krahë s’kanë ëngjëjt e mi” (“Toena”, 1997) dhe “Gjurma e gjethes” (“Botimet ËestPrint”, 2011).

Poezitë dhe e shkrimet e saj janë publikuar në revista, antologji dhe medime të ndryshme letrare, si: “Poeteka”, “Milosao”, “Radi and Radi”, “Poets and Writers”, “Botimet shqiptare”, “Fjala Revieë”, “Emathia”, “Kul-plus”, “Tetova neës”, “Darsiani.com”, “Mapo”, “Telegraf”, “Dita”, “Observer.com”, “Albmendimiarts.com”, “Shekulli”, “Tirana Post”, “Shkodra Press”, “Zemra Shqiptare”, “Gentleöomen”, “Fjalashqipe.com” etj.

Ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme poetike, si: “Poeteka”, “Portiku letrar”, Festivali i poezisë së pabotueme”, “Verë dhe poezi”, TransformArt”, “Takimet Ndërkombëtare Azem Shkreli”, “Këngë dhe poezi” etj.

Ka pasur një bashkëpunim artistik (si krijuese dhe redaktore) për tekstet përshkruese të pikturave të artistit italian Luca Morici (Luca Morici) paraqitur në ekspozitën “Il dolore” (Dhimbja), 2012.

Është redaktore e mjaft librave me poezi dhe prej disa vitesh punon si redaktore letrare në shtëpinë botuese “Pegi”.

DIELLI LIND HERËT NË TETOVË

Dielli lind herët në Tetovë
si një tullumbace e lehtë dhe e shndritshme,
ninëzat e mia e shohin
si ngrihet matanë malit
gjersa brerorja e tij përhumbëse
bëhet njësh me ditën e re.

Dielli lind herak në Tetovë
male të tjera i janë vënë përballë
atje ku syri m'i mat shtëpitë
si ndërtesa të vogla kukullash,
kurse lumi ka kujtesën time
teksa më rrëmben udhës së vjeshtës
si një sasi uji e paqëllimtë ende.

Të gjitha dëgjohen në ajër
brennga e zogjve të pagjumë,
frymëmarrja e bimëve kureshtare,
ti në mua që strukesh e ngjishesh
brumë për gjendjen pasardhëse
dhe magjija e botës
që hesht për duart e tua
të mbetura në ajër,
si krijesa flurake rreth meje.

Ti e di
se është koha e grurit,
e misrit
dhe e një lulëkuqeje të parakohshme
në korrikun e arave,
por edhe unë e di
se është koha jote,
koha jote,
koha që ndodh kur ti je pas kuintave.

Arkitektura e guriçkave
nuk më jep më shumë se një ose dy pika referimi
aní,
ideja është e guraçokëve gjithsesi,
pasi kulla e Babelit u shpik njëherë e mirë
është e kotë të mendosh të kundërtën,

mbase është më mirë kështu,
mbase gjithçka ngjan më e durueshme kështu.

Qielli bie me copa katrore
dhe thërrmijat e tij më ikin flauri, a tempo
asgjë për t'u besuar
përveç kësaj qiellnaje të ngrënë
ku diçka mungon sërish,
ku kohët janë aq të tymta
sa as mungesave nuk mund t'u besojmë.

Dielli lind herët në Tetovë
ti je nisur në një anije kozmike
e vetëm lulet do ta dinë
dritëhijen tënde të përveçme,
kurse muzikës do t'i bjerë shiu përsipër
ashtu si ti pikëllimeve të vona,
muzgut me gojë hëne.

Që në krye të herës
përqaqimet i druheshin
kësaj dite të thyer,
por askush nuk i gjen të shtira
luhatjet e ujit nën dritë
ato ndodhin,
pastaj terri, uh terri,
pastaj ndodh një rrjedhë tjetër,
kjo është koha e shiut, e shiut.
A do të kthehesh me shiun?

Dielli lind herët në Tetovë,
dënesa të buta jete
ndijova mbështjellë me natë,
gjersa dritë në hije,
ky ag ndanë bote
më mbërriti pezulit të dritores.

Hije në dritë,
bota është një skenë e vogël
dhe ne jetojmë në një anije kozmike,
këmbët e gjata të frikës
këpusin penjtë e hollë e të shkurtër
penjtë e ndjeshëm

si fijet vrastare të merimangës
që kohën e end
me ahtin e gjatë të dhembjes së zvjerdhtë
të xixëllonjave si ne.

Dielli lindi më shumë se herët e tjera në Tetovë.

E mërkurë e të gjitha të mërkurave
që nuk ishte e mërkura e stinës së plogët
po bëhet koha jonë e amullisë së verdhë
apo e asaj çka ra kanaleve të holla
kështu pingul,
si tingull i rëndë
si asgjë e veshur me një dritë të zakonshme.

Dita mbillet mu këtu në Tetovë
me diell të ri
e me ajrin që më ngjan
me ahtin e pemëve të qytetit ku linda.

Kështu na duket,
dashuria bie si shiu
mbi trupat tanë,
gjersa poret mbushen sërish
për të na bërë edhe njëherë
njerëz të baltës
me dheun në zemër
dhe më në fund të vdekshëm.

Kështu janë vdekjet e ajrit
të vogla, të imëta sa më s'ka,
prandaj ne për të mbetur të plotë
mbajtur si pe i hollë merimange,
mu në thelb themi:
asht
eshtra
kockë

kocka
koc
kocij,
sepse e gjitha kjo është një
skelet i plasaritur i vetes sonë
që do ta ringjallim në të ardhmen.

Diellin e lashë herak në Tetovë
në qytetin që ma shkroi mallin
një mëngjes,
atë mëngjes që u ngjiz
mesnatës kur më përshëndete
me qiejt e tu katrorë-katrorë.

Agsholi i panjohur
erdhi në Tetovën herake
dhe drita lara-lara
u derdh të më mbulonte supet
si të ishe ti,
si të ishin duart e tua
të hijshme e ndjellake
me diej udhëtues.

Dielli herak lind në Tetovë,
po ti hënë më hënë
u shkruhesh vijave të fatit
me shpirtin për dore.

KËNGË E BUKUR E RËNDË

Pashë në ëndërr sikur vdiqe,
dhe unë qesha me të madhe kryqëzuar në trupin tënd.
– O i pashpirt, – të thirra, – ku ikën kështu?

Trupi yt, blu e thellë si agu i parë më foli:
– E dashur, po të kisha shpirt do të të përgjigjesha,
por ti këndo, këndo që të zgjohen ata që flenë.

Unë qava e prej sysh më rrodhën këngë,
përshpirtje trishtake në gojë të mëngjesit,
dhe trupi yt blu u mbush me shpirtin tim.
Pashë në ëndërr sikur u ngjalle,
trupi yt i bardhë kryqëzuar në dashurinë e trupit tim
ngrihej baticë si hyjni uji.

– Do të vdesësh sërish? – të pyeta.
Ti përmyte dheun e u tërhoqe zbatice
me trupin tënd blu të përshpirtshme.

Kurmi yt ende i patharë mbi mua foli:

– E dashur, po të kisha shpirt do të të përgjigjesha.

Mbaji gjallë ëndrrat e tua të ujshme që të mos plasaritet qielli.

Unë qesha hidhur, gishtat futa në sy,

dhe kripë e egër mbuloi dheun.

Këngët e mia të njelmëta ruajtën trupin tënd blu të thellë.

Pashë në ëndërr sikur vdiqe, u ngjalle, vdiqe

dhe këngët e mia të blatonin mjaltë.

– Çohu i pashpirt, të ngjyesh në jetën time të ëmbël,

– të thashë.

Kurmi yt me vija të kuqe lëshoi aht:

– E dashur po të kisha shpirt do të të përgjigjesha,

por ti mbille një lule që shpirti yt ta shpojë tokën me rrënjë.

Unë qava, qesha, qava, qesha

dhe këngët e mia iu ngjitën trupit tënd blu të thellë

si mjaltë që mëkon plagët.

Pashë në ëndërr që koha vdiq,

trupi yt blu e thellë mes agut e muzgut

mbushej hoje më hoje me shpirtin tim.

– I dashur, tani nuk do të vdesësh më,

unë do të zgjohem dhe damarët e tu do të kenë

kujtesën e frymës sime të kuqe në trupin tënd.

Pashë në ëndërr jetën

dhe trupin tim pus të thellë me këngë uji.

Pastaj çela sytë e u mbusha me frymë.

DU ME T'PUTH

Du me t'puth,
n'kohen zero t'gjitha gjanave
n'stinen e pest si nuk nrron asnjher
n'motin e t'gjitha moteve
ba nji.

Du me t'puth,
me mend
aty ku fjalt bahen shpend t'lllastum,
me sy
aty ku koha lidhet me land,
me frym
aty ky elipsi i bots metet gjys,
me buz
mu n'buz.

Du me t'puth,
tu t'ndigju frymn
si kapercen poret e lkurs,
pikerisht n'at or
kur çdo gjë metet pezull,
veç pse ti m'shef
sikur tjeterkush s'ka met perky dheut,
e veçpse un t'shof
sikur t'mos munesha me ba nryshe.

Du me t'puth,
n'puthjen tane,
me nji kang prej qafe n'goj,
me dy sy t'myllun
qe t'shofin mu n'shpirit.

SHIU NUK TREGON

Shiu nuk ka gojë,
po fjalët e tij bashkë i ndajmë
unë e ti.

Një tingull unë,
një tingull ti
qielli e dheu gjysmohen.
E ndien dhe ti ahtin e tyre.

Shiu nuk ka sy,
po soditjet e tij i mbledh unë
në emrin tënd.

Syri im në re,
syri im në dhe
mbjellin bimën e shpirtit që jam.
I ndien dhe ti rrënjët e mia.

Shiu nuk ka veshë,
po këngët e mia i dëgjon ai
në vendin tënd.

Zëri im plot me ujë,
uji im plot me zë
shpërndahen rrathë-rrathë mbi botë.
E ndien dhe ti gjallimin tim.



KINGA FABÓ

(HUNGARI)

Kinga Fabó është poete hungareze. Poezia e saj u botua gjerësisht në gazeta ndërkombëtare letrare dhe revista poezie, duke përfshirë *Modern Poetry in Translation* (përkthyer dhe komentuar nga George Szirtes); *Numéro Cinq*, *Ink Sëeat & Tears*, *Deep Eater Literary Journal*, *The Screech Oël*, *The Original Van Gogh's Ear*, *The Opiate*, *Fixpoetry*, *Lyrikline.org*, *Atunis*, *MeArteka* dhe gjetiu si dhe në antologji si *The Significant Anthology*, *Ëomen in Ëar*, *The Colours of Refuge*, *Poetry Against Racism*, *Ëorld Poetry Yearbook 2015*, *Anthology of Contemporary Ëomen's Poetry*, *Anthology of Contemporary Ëorld Poetry*, *Ëorld Poetry Almanac* dhe të tjera. Disa prej poezive të saj individuale u përkthyen në gjithsej 17 gjuhë: anglisht, arabisht, bullgarisht, esperanto, frëngjisht, galego, gjermanisht, greqisht, indonezisht, italisht, persisht, rumanisht, serbisht, sllovenisht, spanjisht, shqip dhe në gjuhën tamile. Njëra nga poezive të saj (*Veshët*) ka, mes tjerash, gjashtë përkthime të ndryshme indoneze nga gjashtë autorë të ndryshëm. Libri i saj i fundit, përmbledhja dygjuhëshe indonezisht-anglisht e poezisë "*Racun/Poison*" u botua më 2015. Fabó jeton në Budapesht, Hungari.

TRANSFIGURIMI I BOTËS

I hapur, deti duket në gjumë.
 Duke mbajtur dallgët e tij.
 Një puls nën skenën e mbytur të dimrit.
 Duke hedhur një buzëqeshje në plazh.

Një njollë memece mbi trupin e vogël të nxehtë.
 Një ngjyrë mbi xhamin e thyer.
 Një gjest që dikur ishte i mbyllur.
 E këndshme kur deti u çua.
 Duke hedhur një buzëqeshje në plazh.

Doja të mbetesh një objekt.
 Por jo, pavdekshmëria nuk është e imja.
 Jam tepër e fortë për ta mbrojtur veten.
 Duke pritur dënimin.

Kjo dhe e njëjta ndodhën bashkë.
 E heshtur isha e ulur në xham.
 Vetëm njolla shtegtoi mbi skenën lakuriqe.
 Tingujt *nuk vazhduan*.

Vetëm një gjest i pakryer.
 Lumturi si një valltar i palëvizur.
 Rrahje në kurrizin lakuriq eshtak.

Dhe deti nuk do të jetë më i pavdekshëm.
(Përkthyer nga hungarishtja në anglisht nga Zsuzsanna Ozsváth dhe Martha Satz, nga anglishtja në shqip nga Silke Liria Blumbach)

ISADORA DUNCAN DUKE VALLËZUAR

Si skulpturë në fillim. Pastaj, sikur të lindte dielli brenda
 saj, gjest
 i gjatë.
 Një buzëqeshje e vogël e pastaj e plotë.

Bukuria
 e ritit ndriçonte, vërdallë.

Ajo vinte vërdallë, sillte vërdallë,
 e flakëruar.
 Vetëm trupi fliste. Trupi mbante

gjuhën e saj.

Vallja e saj, një magji
që shtillte ajrin, një spirale qenkej ajo

dhe

shalli i saj, gjysmë-rrethi përreth saj,
kthesa e bregdetit dhe
vajzës,

valltare dhe vallja të ndara...

(Transkrijuar nga *Cathy Strisik* dhe *Veronica Golos*
në bazë të përkthimit nga *Katalin N. Ullrich* nga
hungarishtja në anglisht, përkthyer nga anglishtja në
shqip nga *Silke Liria Blumbach*.)

HELM

Nuk di se ç'është kjo, por është shumë
qëllimsëmure. Sigurisht duhet t'i përkasë një femër.
Dhe diçka si një buzëqeshje.

E rrotulloj qytetin mbi unë,
rrotulloj bukurinë time. Ja si është!
Shumë çelësa, vrima të vogla çelësash që rrotullohen.

Jo të gjitha vështrimet mund të jenë të kota. Po
përgjigjja?
Vetëm një tallje.
Vazoja më përqafo dhe më vret, nuk marr dot frymë.

Tani tiparet e mia - edhe me qëllimet më të mira -
nuk mund të thuhet të bukura.
Po ajo? Vajza? Perfumi i saj i modës

është Helm. Për mua vërtet një helm i mirëfilltë.
Po vazoja?
Më përqafo dhe më vret.

Por çfarë të bëj pa të?
(Përkthyer nga hungarishtja në anglisht nga *Kinga Fabó*, nga anglishtja në shqip nga *Silke Liria Blumbach*)



Nga tradita 4. Teknik e kombinuar . 146 x114 2005



SHAIP EMËRLLAHU

(MAQEDONI)

U lind më 1962, në Trebosh, Tetovë. Fakultetin Filologjik, Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe e mbaroi në Universitetin e Prishtinës. Magjistroi në Letërsi në Universitetin e Tiranës. Është doktorantë i Letërsisë në

Tiranë. Ai, është mësimdhënës në Universitetin e Tetovës.

Botoi vëllimet me poezi *"Pagëzimi i viteve"* (1994), *"Projekti i thyer"* (1997), *"Vdekja e paktë"* (2001) dhe *"Troja e kalit"* (2018). Më vitin 2001, "Akademia Orient - Oksident" e Bukureshtit ia botoi në gjuhën shqipe dhe rumune vëllimin me poezi *"Vdekja e paktë / Putina moarte"*. Në vitin 2004, PEN-i kroat dhe Shoqata e Shkrimtarëve Kroatë ia botoi vëllimin dygjuhësh kroatisht/shqip, me titull *"Poezi"*. Në vitin 2004, sh.b."Feniks" nga Shkupi ia botoi në gjuhën maqedone librin me poezi të zgjedhura *"Dvorski son"*. Në vitin 2000, në bashkautorësi botoi librin me dëshmi të masakrave në Kosovë shqip/anglisht *"...edhe ne dëshmojmë / We Witness"*, sh.b. *"Ditët e Naimit"* (shqip-anglisht). Në vitin 2009, shtëpia botuese italiane *"La stanca del poeta – 57"*, ia botoi vëllimin me poezi *"Stracci di vita"*, ndërkaq, po atë vit i botohet në gjuhën angleze libri poetik *"Life's Rags"*. Më 2014, i botohet në gjuhën frenge librin me poezi *"Les Albanian marathon"*. Në Japoni, Junpa books ia boton poezinë në një libër me titull *"Duet of Roads"* (dialog poetik -Taro Aizu). Ndërkaq, sivjet në Taiwan i botohet në gjuhën kineze (mandarin) dhe në ate angleze libri *"Life's Rags"*. Cikle poetike të tij janë bo-

tuar edhe në gjuhën spanjolle, hebraike, suedeze, arabe, rumune, ukrainase, induse, turke, polake, bullgare, boshnjake, maqedonase etj. Poezia e tij është përfshirë në disa antologji ndërkombëtare. Ka marrë pjesë në festivale poetike ndërkombëtare dhe ata vendore.

Është lauruar me çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare, si; çmimin letrar për kreativitet “*Naji Naaman*”, në Liban, 2003, çmimin letrar “*Ali Ben Ghadem*”, të Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë në Tunis, 2003, çmimin letrar “*Lyra e liqenit*”, në Festivalin e Poezisë në Pogradec, 2003, çmimin letrar “*Skampini*” në Festivalin e Poezisë “*Lulet e Verës*”, Elbasan 2002, çmimin letrar të Radio Ulqinit në Festivalin e Poezisë “*Kalimera poetike*”, Ulqin 2001, çmimin letrar “*Dritero Agolli*” në Festivalin e Poezisë “*Netët Korçare*”, Korçë 2018 etj.

Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë i ndan Mirënjohjen e lartë “*GRAMOTA*” për ngritjen e urave të komunikimit të kulturës shqiptare dhe asaj bullgare. Në Greqi, nderohet për punën e tij shumvjeçare për promovimin e letërsisë, kulturës dhe artit nga UNESKO - Dega e Pirreut dhe merr gjithashtu Medaljonin e praruar në ar “*Aleksandri i Madh*”.

Ka punuar gazetar në mediumet elektronike dhe të shkruara, brenda dhe jashtë vendit. Në Berlin bashkthemelon dhe punon kryeredaktor i Radiotelevizionit “*Zëri i Shqiptarëve*”. Për disa vite ka punuar redaktor i Rubrikës së Kulturës në të përditshmen “*Flaka*”, Shkup.

Është themelues dhe drejtor i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë ‘*Ditët e Naimit*’.

ZBRITE MADRIDIN MES NESH

e shkundur gjithsesi se je kthyer
 s›ka si të jetë ndryshe
 pa fyer ndjenjat që u bymien në atë diell sysh
 e qeji i shpirtit ta çante tupanin e lirisë së paanë
 ëndrra jote ishte tango
 tango që i jepeshe dëshirës së lirë
 nuk kishe gardian robi të të besdiste

me sy vrojtuesi të të vriste
 hapsirën e mundësisë që ishte krejt jotja
 sa një Madrid
 ku luhet loja e djersën e ndryrë hedh
 liria është si dielli
 ku të prek qielli, qielli, qielli...
 dhe përshëndet Perëndinë
 e falenderon për Madridin
 i kërkon të kthehesh prap
 në shtëpi e prap në Madrid
 ku lufta me dema ndodh këtu në Shkup
 e fustanin e kuq si ke si e vesh
 se vërsulen dema, edhe desh
 ec e merre vesh
 ku mendon ta lësh shpirtin
 e ku mishin

unë pres ta pij kafen në «Galaxy»
 e ta dëgjoj paqën që ka marrë formën tënde

Madridin
 zbritë mes nesh
 këtu te Skederbeu në Bit Pazar

Zoti është një
 Jeta është një

SILUETË GAETIANE

mbi atë gjideti si gji femre
 në Gaeta
 Ditet i tregoja, Ventotenen
 e mendimit të burgosur shqiptar

ngrohtësi rëzonte shpirti
 valë e nxehtë afshi
 fliste përballë

ishte dehur deti
 ishte rrëmeti
 kuaj të bardhë krushqie vinin me dallgë

dhëndër isha zgjuar, nuse kisha në kalë
një këngë e dehur dasme me klarinet
përdridhej jugut

arbëreshe më zbriste nusja

siluetë qe Diti
siluetë
që zhdiregj gjirit tënd
si gjideti në Gaetë

TROJA E KALIT

me thikat kafshuar
zgjerohet gjeografia e trokut
të kalit të Trojës

pëlçet
e s'ta kap ajo e vockla mendje
si e hamë karemin
kur hijet na e veshin trupin
pashë e më pashë me Trojën e kalit
e na bëhet më e bardhë se bora
shkuma e gojës

tavolinat na i mbushë

askush s'ia turbullon koklës së qejfit

ç'na mbet nga Troja
përveç kalit
me hingëllimën e hiles

13 janar 2011



**MARISOL
BOHORQUEZ GODOY**
(KOLOMBI)

Marisol Bohórquez Godoy (Santa María, Kolombi, 1982) është poete, piktore dhe përkthyes letërsie, e cila tani jeton në Shtetet e Bashkuara. Ka kryer studime të inxhinierisë industriale dhe administrimit të biznesit.

Autore poezish dhe tregimesh shumë të shkurtra. Disa prej shkrimeve të saj u botuan në antologji dhe revista në Kolombi, Meksikë, Spanjë, Argjentinë dhe Itali. “Los Conjurados Collection” ka botuar librin e saj të parë “La Soledad de los Espejos” (2016) dhe shtëpia botuese “Rafaelli” nga Italia ka botuar një përzgjedhje dygjuhëshe të poezisë së saj me titullin “Effetto Farfalla - Efecto mariposa” (2017).

Ka marrë pjesë si poete mysafirë në Festivalin Ndërkombëtar të Medellín-it (Kolombi) në vitet 2016 dhe 2018, në Festivalin e Poezisë së Re “La Juntada 2016” në Buenos Aires (Argjentinë) dhe në Konferencën Latinoamerikane të Poezisë në Universitetin “Carlo Bo” në Urbino (Itali) më 2017. Një pjesë e poezive të saj është përkthyer në gjuhën frënge dhe italiane.

ATJE KU JETON EMRI IM

Nëse fshihem si sot
në ditë pa buzëqeshje
dhe në ato ditë
lulet e të cilave u vyshkën dje
duke harruar shikimin e ndritshëm të agut të tyre
dhe majën e pakorruptueshme të një perëndimi dielli

Nëse mbetem e varur nën heshtjen
e këtyre mureve që nuk sjellin kujtime
të një dritareje nga një pyll i populluar nga mungesa
Eja dhe shpëtomë!

Do të pluskoj në erë
pranë gjetheve të vyshkura
si krizalidë në kokonin e saj të brishtë
do të puth lakuriqësinë e ujit
në pikën e fundit të shiut të këtij dimri

Kërkomë në fluturat që mbushin ajrin me ngjyrë
dhe kanë tatuazhin e pafundësisë në krahët e tyre
pa marrë parasysht që në çdo rrahje krahësh
koha e tyre do t'i jetë më afër
psherëtimës së fundit

DETI DHE HUMNERAT E SAJ

E dënuar për të humbur çdo betejë,
vendos të jem det në vend të shkëmbit,
të shtyhem nga era pa frikë të dorëzohem

duke u përballur me marramendjen e skërkave,
sepse pas rënies
e njoh fuqinë me të cilën ngrihen
dallgët e mia të tërbuara
dhe i njoh vorbullat e formuara nga to.

E njoh shkumën e butë që shfaqet nga dallgët e mëdha
- buzë të etura që zbehen kur puthin brigjet e tua -

nuk do t'i shmangem kripës sime, që di të gërryey anijet
madhështore,
as nuk do t'u shmangem grykëderdhjeve me ujëra të
freskëta
që sjellin lajme nga botë të tjera

Në mitrën time do të ruaj krijesa fisnike dhe bisha të
egra
dhe do të dëshmoj dashuri të përqafulara me lëkundjen
e muzikës sime.

Do të varros kufoma dhe ëndrra,
por këto kundërshtime të përhershme do t'ia vlejné
sepse di që ndonjë ditë do të më gjesh.
Do t'i pyesësh yjet për dritë
për të më lundruar netëve,
dhe guximtar si Odiseu
do t'u bësh ballë të gjitha stuhive
për të më çuar në bregdet
ku trupi im i tejdukshëm
do të zbresë vallen e tij në rërën e ngrohtë,
dhe këmbët e tua do të përqafohen nga ledhatime
jetëshkurtra
me dëshirën për të më përmbajtur
ose për t'u kthyer në ujërat e mia,
sepse një detar që gjendet mbi dhe të ngurtë
është një burrë që ka humbur jetën.

A EKZISTON ENDE?

Për femrat viktime të dhunës gjinore

Po të përplasësh buzët e mia me grushtin tënd
do të arratisem prej teje
pa pritur që një princ do të më shpëtojë,

po të bësh që vagina ime të derdhë gjak
duke më dhunuar,
do të shkruaj vargje
që do të mbijnë në çdo mbresë

Fjalët e mia do të të kujtojnë që ishte një femër
që nanuriti trupin tënd të thyeshëm në mitrën e saj
e pavetëdijshme për fuqinë e metamorfozës sate

Ngaqë unë jam nëna
mitrën e së cilës vazhdon ta thyesh
unë jam mishi të cilin e gatuan për darkën tënde
duke sjellë Zotin si mysafir

Megjithatë po pres nga larg
e pres çastin e kthyeshëm,
ditën kur tregon fytyrën tënde
të denjë për t'i përkatur species sonë
- një mashkull i aftë për të mbajtur fluturën në dorë
pa ia shtrembëruar krahët -



ELIZABETH GRECH

(MALTA)

Elizabeth Grech është përkthyesë autodidakte (frëngjisht-anglisht) dhe bashkëpunon me disa shkencëtarë sociale, OJQ si dhe shoqata kulturore dhe artistike. Ajo është konsulente pranë CIHEAM-it (Qendra Ndërkombëtare për Studime të Përparuara Mesdhetare Agronomike) dhe e ngarkuar me versionin anglisht të dokumenteve të tyre të punës dhe botimeve të tyre. Ajo është edhe përkthyesë letrare dhe përkthen në frëngjisht veprën e disa poetëve/shkrimtarëve bashkëkohorë maltezë, duke përfshirë poetët John Aquilina, Clare Azzopardi, Norbert Bugeja, Antoine Cassar, Adrian Grima dhe John Portelli. Shumë prej përkthimeve të saj u botuan si libra, në përmbledhje poezie ose në revista letrare. Ka shkruar poezi në gjuhën malteze për 15 vitet e fundit, por ka filluar vetëm para pak kohe t'i ndajë. Disa prej tyre u botuan në përmbledhje poezie dhe gazeta, dhe shumë shpejt do të botojë librin e saj të parë me poezi në një shtëpi botuese të njohur në Maltë. Ka marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë në Sidi Bou Said, Tunizi, në qershor 2018 dhe do të marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë në Tetovë, Maqedoni, në tetor 2018.

DASHURI TË TJERA

Nga Philippe tek Alberti

I biri, ai është sekreti i të atit,
kështu thotë një proverb arab.
Por edhe mund të jetë
i ati, që është sekreti i të birit.
Këtë ai të tha ty.

Heshtja përhapet
midis babait dhe djalit.
Atje sundon distanca e dashurisë.

Është sizmike, vdekje.
Një cefël të frymëmarrjes
e mbyll me krisma,
pa marrë parasysh që dridhjet
të kanë paralajmëruar.

Mungesa e mbush zbrazëtinë.
Por mos ki frikë,
ka dashuri të tjera, hapur.
Këtë ai të tha ty.

ISHUJ

Merrmë me ty
për të hekurosur rrudhat,
për të qepur lotët
në Mesdhe.
Në qoftë se ka hapësirë për mua,
më le të trem
nëpër plasat tejet të holla
të mishit tënd.
Dhe më le të lidh,
të var
një gjerdan dafine
midis ishullit tënd
dhe timit.
Eja,

pusho kokën tënde
mbi supin tim,
nis në lundrim mendimet e tua
mbi aromën
prej kedre
nga gërshetat
që thure në flokët e mi.

VJESHTË

Një pas një
petalet e zbehta të trëndafil
nga pema në anën tjetër të rrugës
shpien mbi një frymë të erës
aq të brishta si ditët
që të mbeten për t'i numëruar.
Do t'i mblidhja në prehrin tim
t'i grumbulloj si përkujtesë
të erës sate,
por era nis një luftim,
era është më e fortë se unë dhe
një
pas
një
petalet e zbehta të trëndafil
rrëshqiten
midis gishtërinjve të mi.



E kuqja tradicionale 14.3. Vaj në pëlhurë. 40 x40 2014



KRISTIAN GUTTESSEN

(ISLANDË)

Kristian Guttusen u lind më 1974. Është autori i 11 librave në islandisht. Ka botuar librin e tij të parë, në vitin 1995, në moshën 21 vjeçare. Vijuan shumë libra të tjerë, dhe më së fundi *Hrafnaklukkan* (Lule qyqeje), në vitin 2018. Kristiani u nominua për Çmimin Islandez të Përkthyesve në vitin 2007, për përkthimin e romanit norvegjez *Brekkan* nga Carl Frode Tiller. Vepra e Kristianit u përkthye në shumë gjuhë, mes tyre në gjuhën shqipe, daneze, angleze, frënge, lituaneze, spanjolle dhe ukrainase.

ESTAMPAS DEL LAGO OHRID

Françoise më dërgoi një poezi të cilën ka shkruar
për udhëtimin që bëmë në Ohër
ku shkuam me Ditin dhe Khaledin (ajo është
nga Izraeli dhe ai, nga Palestina)
ishtre një ditë e bukur dhe errësira erdhi
tepër shpejt
por fshati me kalanë mbi
shpatin e malit dukej
edhe më madhështor në muzg sikur
ta ndiznin ushtarë me fenerë
Diti qau për një të dashur të vdekur ndërsa Khaledi

që mund të mos ketë kurrë mundësinë për t'u kthyer
në shtëpi
u mbet i qetë dhe pa shprehje por unë
ndjeva që është i zemërngrohtë
folëm shumë dhe shkruam poezi
në çdo çast duke shikuar ratë
edhe pse dinim thellësisht
që është mëkat

Françoise dhe unë ishin të lidhur me lidhje të forta
në bisedat që zhvilluam për Zotin
gjatë të cilave ndjeu që fola sinqerisht
(më vonë kur tërmete tronditën vendlindjen e saj
më luti të lutem për
të dashurit e saj, gjë që bëra edhe vetëm
edhe me vajzën time),
ishim atje në festivalin e poezisë në
Maqedoni dhe ngaqë ishim të lirë në atë ditë
vendosëm të drejtoheshim
në veri drejt liqenit të Ohrit

Khaledi ngau makinën i heshtur ndërsa të tjerët prej
nesh
folëm për gjithçka nën diellin
ishte udhëtimi im i parë jashtë
pasi e lashë alkoholin dhe isha nervoz
për të qenë mes poetësh dhe për shkak
të pirjes por mora forcë nga Françoise
së cilës i pëlqente të dëgjonte mendimet e mia
për joshjet
e botës dhe vdekjes
për vetveten në botë
ku ekzistenca e secilit poet është mëkat
dhe e trajtojnë Zotin dhe të vërtetën
vetëm si fantazi në vend të kërkojnë t'i përjetojnë
të dy ekzistencialisht

nëpër xhamin e përparmë shikuam katastrofa
që tërbonin në errësi si luftëra botërore
por duke u përqëndruar në Françoise arrita
të bllokoja shiun e predhave në sytë e të
tjerëve dhe mund të ndieja fuqinë që në fund të fundit
është
e vetmja gjë që mbijeton një person kur fëmijë

të vdekur lihen të shtrirë në rrugë
gradualisht ramë në heshtje sikur nga
respekti për vdekjen kërcënuese që kurrë
nuk do të mund të kapërcehet
dhe më në fund e tëra që dëgjohej ishte rrahja
e ngadaltë e fshirëseve të xhamave sikur nga një
distancë dhe tingujt qetësues të motorit
që na ndihmuan të harronim të tëra që kishin
ndodhur në jetët tona por për të cilit nuk do të
shkruanim kurrë dhe në këtë mënyrë vazhduam
pa fjalë nëpër natë si një kon i gjallë
dite në një rrugë të errët ku pamë fëmijë të vdekur
të Zotit

NË VENDIN E ZOGJVE PA FLUTURIM

Në vendin e zogjve pa fluturim jeton vajza e ujit.

Atje banon një shoku im që nuk vizaton më
frymën.

Në vendin e zogjve pa fluturim pushon përvoja
e peshuar.

Më merr gjithçka që nuk harroj dot të marr frymë.
Në vendin e kujtimeve ka errësi të amshuar.

Universi zgjerohet, përvoja e jetuar lajmëron
zeron absolute.

E vetmja gjë që e e tërheq bashkë dhe na lidh
me lidhje të besueshme është dashuria

FËMIJËT E MI MË MUNGOJNË AQ SHUMË SAQË DERDH GJAK

Isha një vend
Isha një gjojë e hapur
Isha një pejsazh lëvizës
gjithçka ishte e heshtur

Deri tani kisha menduar
që mund të shikoja në
të kaluarën
por errësia nuk
lëshon asnjë kujtim
Edhe pse nuk ka shenjë
banorësh të mëparshëm
imaagjinoj që dikur
shtriga
jetonin këtu
Pastaj të zveshura nga rrobat - të shenjuara
por nga ku po shikoj djerrinën
kuptoj që jam në të ardhmen
Jam një akrep që lulëzon ku nuk gjendet dot jetë
Një furacak i dalë nga jetët e pasardhësit
dhe jeta e të cilit u ngrit nga oqeani i shkretuar
Isha një vend
Isha një gjojë e hapur
Po shoh se si u bëra relike të kalbura
se si u bëra dhe
Shpërbëhem në një gjojë të hapur
dhe më në fund
bëhem vetëm një pejsazh
i qetë



**SITI RUQAIYAH
HASHIM**
(MALAJZI)

Rokiah Hashim nga Malajzia shkruan duke përdorur emrin Siti Ruqaiyah Hashim. Duke filluar më 1987, pozitë e saj dhe tregimet e saj të shkurtra u botuan nga revista dhe gazeta

të letërsisë kryesore. Gjithashtu është shumë prodhuese si kritike filmi dhe teatri dhe prej vitit 2007 shkruan një kolonë në një gazetë të madhe ditore në Malajzi dhe më 2015 botoi një libër për kritikë filmi. Një antologji dygjuhëshe me poezitë e saj me emrin “Catharsis” (Katarsis) në anglisht dhe në gjuhën malajziane u botua më 2015 dhe në spanjisht më 2016 në Argjentinë. Më 2017, antologjia e saj dygjuhëshe bashkë me 12 poetë të tjerë të botës për paqe u botua në formë libri elektronik me titullin “Neës From Strasbourg” (Lajme nga Strasburgu). Të gjitha përkthimet në Bahasa Malajzia u bënë nga vetë Siti Ruqaiyah. Veprat e saj u botuan edhe në shumë antologji të tjera bashkë me poetë të tjerë nga gjithë bota si dhe në revista dhe gazeta të huaja. Poezitë e saj u përkthyen në gjuhët kineze mandarine, serbokroate, uzbeke, arabe, mongole, spanjolle dhe frënge. Prej viteve 1990 ka marrë pjesë në shumë festivale lokale poezie, si më 2014 në Peru, më 2015 në Tajvan, më 2016 në Çeki dhe më 2017 në Mongoli dhe në Marok. Antologjia e poezive “Paradise 2” (Parajsa 2) është e dyta në serinë “Poezi për Paqe Botërore”.

KUR OMARI U LUT JASHTË NJË KISHE

Kujtohet historia
Kur Omar Al Khattab
U lut jashtë një kishe
Pas pushtimit të Jerusalemit
Pika të ngrohta
Rrodhën poshtë të paftuara

Omari tha përsëri
Jua lë të gjitha këtu
Juve vëllezërve të krishterë
Për t'u mbrojtur
T'u kujdesur si për pronat tuaja
Duke përfshirë kryqet tuaja
Kishat
Sepse
Këtë e mësoi Islami
Edhe në fenë tuaj

Sot
Ende flasim në të njëjtën gjuhë
Sikur fjalët e Omarit
Të ishin shqiptuar dje

O burrë
Thuaj fjalët e tua
Sikur si ndihem
Sepse
Do të them
Sikur si ndihesh

Vetëm atëherë
Të gjitha fatkeqësitë
Do të mbarojnë përgjithmonë

NGA VJEN URREJTJA?

Nga vjen dashuria?
Thanë në shikim të parë depërton në zemër
Nga vjen urrejtja?
Nga errësira e shpirtit
Zvarritet në mendjet dhe ndjenjat

Historia shkruhet
Kur urrejtjet gllabërojnë shpirtin
Konsideratat ikin
Mëshira hidhet poshtë
Njerëzimi varroset

Dhe monumente të përgjakura
Qëndrojnë deri tani
Të kujtuara dhe të treguara
Por ndodhin prapë
E prapë!

Sabra, Shatila
Auschëitz, Dachau
Siem Reap, My Lai
Boshnjë-Hercegovina dhe Kosova
Nagorno-Karabah
Dhe tani në Rakhine

Urrejtja është krim
Urrejtja shkatërron
Hidhe larg
Le të kultivojmë paqe të përhershme
Le të ushqejmë dashuri përgjithmonë
Le të përhapim dashuri në gjithë botën
Gjithë botës!

PORT DICKSON DHE PERËNDIMI I DIELLIT

Shumë shpejt mund të mos jemi në gjendje të shohim
perëndimin e diellit në horizont
dhe të dëgjojmë cicërimin e pulëbardhave
në këtë territor të artë sepse
të gjitha plazhet bëhen pronë private
për shkak të zhvillimeve agresive
kompleksash godinash, shtëpish pushimi, hotelesh
ndërkombëtare me katër e pesë yje
me tela me gjemba në majë të mureve dy metra e
gjysmë të larta; me rojë sigurie me lëkurë ulliri
që qëndrojnë besnikërisht pranë tabelës së kuqe me
fjalët:

TË PAFTUARIT DO TË NDIQEN PENALISHT;
pra ku tjetër mund të vrapojnë fëmijët e peshkatarëve,
bujqve dhe punëtorëve të bashkisë
dhe të ngrënë në qiell balona të bëra nga gazeta të
vjetra
apo ku tjetër fëmijët e banorëve të qytetit mund të
ndërtojnë kështjella rëre
çdo herë që vijnë në këtë territor të plagosur?



**SILKE LIRIA
BLUMBACH**
(GJERMANI)

Me, emrin e saj shqiptar Liria, u lind më 13 dhjetor 1970 në Göttingen, Gjermani, në një familje mësuesish. Filloi së shkruari poezi në moshën 8 vjeçare dhe mori pjesë në një klub letrar në Heidelberg. Mirëpo, depërtimi i saj erdhi vetëm pasi mjeshtroi gjuhën shqipe. Si e huaja e parë që shkruante shqip, ka botuar tre libra me poezi dhe një ditar në gjuhën shqipe, si dhe një libër me poezi në anglisht.

- Dyzet vdekje në Sarandë, Tiranë 1999
- Karavela e fundosur, Tetovë 2002
- Lumi që rrjedh drejt burimit, Tetovë 2007
- Ditari i një kthimi, Tiranë 2010
- Beyond the Bows of the Heart, SHBA 2012

Poezitë e saj, që u botuan në revista dhe gazeta letrare të vendeve të ndryshme, duke përfshirë revista interneti, u përkthyen në boshnjakisht, rumanisht, odia (një gjuhë e Indisë) dhe kinezisht, ndërsa ajo ka shkruar edhe poezi në frëngjisht, spanjisht, gjeorgjisht dhe hungarisht. Ka fituar një sërë shpërblimesh letrare, veçanërisht, por jo vetëm, në botën shqiptare. Është anëtare e Drejtorisë së Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" në Tetovë.

Fjalët janë edhe në qendër të jetës profesionale të saj si përkthyes. Ka përkthyer libra të poetëve nga gjuhë të huaj në gjuhën shqipe.

Jeton në Berlin, ku punon në një ndërmarrje të madhe përkthimesh.

Prej gushtit 2014, lufton me kancer të gjirit me meta-staza në mushkëri dhe në eshtra.

VINÇI

Krenaria e njerëzimit
Nga poshtë nuk shihet ku mbaron
E pashë në televizorin
Që prindërit e mi kanë blerë
Si aq shumë njerëz të tjerë
Për të mos humbur këtë rast

Gjatë ndërtimit vdiqën më shumë punëtorë
Sa ka banorë vendi im
Por sapo ta shohim hënën
Mbi sfondin pafundësisht të zi
Do ta harrojmë këtë vogëlsi
Ose së paku mendojmë: Ja ka vlejtur!

Sot është dita e madhe
Nuk kemi shkollë, të rriturit s'kanë punë
Përveç atyre që punojnë mbi vinçin
Heronjtë e njerëzimit
Për kohën e kohërave

Sa poezi për hënën kemi lexuar
Mësuar përmendsh
Shkruam nota të këqia për shkak të kësaj hëne
Që dikur gjendej në qiell dhe ndriçonte natën
Si dritë më e përshtatshme për të dashuruarit dhe
vetëvrasësit

Nuk na treguan kur dhe pse ka rënë nga qielli
Apo kush e ka zbritur apo vjedhur
Edhe pse nuk më shkon mendja se si e vjedh hënën
Dhe sidomos ku e mban të fshehur

Sot pra do ta shohim në TV me gjithë familjen
Suksesin më të madh të njerëzimit
Nesër më pret Kali i Bardhë

Me sytë e tij të stërmëdhenj
Me bardhësinë verbëruese
Mua më duket hënor

POGRADECI

laraska e gushtit më këndon
për një qytet me një shkronjë të humbur
në një kuti të mbyllur me tel

kthehu në mitër
dhe pi raki rrushi

*(Kjo poezi përmban emrat e shkrimtarëve Lasgush
Poradeci dhe Mitrush Kuteli.)*

MANIPULIM

manipuluesi
manipulon
të manipuluarin

manipulimi
manipulon
manipuluesin

kush është pra
më i manipuluar?



Nga tradita 18.2. Vaj në pëlhurë. 70 x 80 2018



JON HØYER
(DANIMARK)

Në fotografi jam i ulur mbi një bankë në Stamboll me poezi mbi mbështetësen e saj. Edhe pse nuk e njoh gjuhën më pëlqen e gjithë ideja të promovohet poezia në këtë mënyrë duke e kthyer në një pjesë shpërblyese të jetës së

përditshme, që bie në sy.

Gjithmonë e kam ndier kështu. Jam tani 76 vjeçar dhe deri më tani kam botuar 21 libra, 9 prej të cilëve janë përmbledhje poezie dhe të tjerë janë romane dhe tregime të shkurtra dhe tregime shumë të shkurtra si dhe libra shkencorë. Paralelisht me shkrimin tim kam punuar si mësues gjimnazi në Danimarkë dhe pastaj si pedagog universiteti në Islandë dhe në Finlandë. Prej kthimit tim në Danimarkë jam edhe përkthyes i poezisë nga anglishtja dhe gjermanishtja dhe islandishtja në danisht.

Momentalisht po punoj në një përmbledhje poezie për njerëzit e shumë prej nesh që sigurisht ende nuk janë më në moshën e mesme por që as nuk janë të moshuar ende.

ZBULIM

Në fillim nuk ishin këtu
në kohën kur bota
nuk ishte e populluar aq dendur
Pastaj erdhën duke u gremisur
njëra pas tjetrës
dhe pastaj edhe një tjetër
në jetën time të përditshme
pa më bërë gjë
as unë nuk dyshova
se sa më mungonin
para se të ishin këtu
të reja fringo
dhe thellësisht të ndryshme
secila prej tyre
plotësisht vetja e saj
me dorën e saj të vogël në timen
dhe plotësisht e thithur në lojën tonë
askush prej nesh nuk pretendon
dhe pa një brez të zënë dhe të lidhur në kohë
midis nesh
vetëm së bashku
për të qenë bashkë
në terren të paeksploruar

PO MU TANI

Në anën tëndë
një kohë më pas

një ndjenjë lumturie
në nxitjen e seksit të tretur
lëvizet drejt agut

në vjeshtë
flakëruese

e gjithë paqja
më hap sytë
për çfarëdo që mund të vijë

ndërsa e gjitha këtu
është më se mjaft

dhe gatishmëria
flakëruese

NË DITËN KUR VDIQ VËLLAI IM

16 Birch Street është vendi
ku Niku nuk jeton

ku heshtja e mobiljeve
mund të dëgjohet

ku çdo dhomë
goditet nga mungesa e tij

Dhe pikëllimi
vetëm na përket neve të tjerë

Nikut nuk i shkon mendja
për vdekjen

dhe për shpendin e saj grabitqar
që ngritet me rrahje të rënda të krahëve
dhe me kthetrat e vet përreth gjahut
ne
të afërmit mbijetues
të gjallë dhe të hedhur
por të mbajtur fortësisht
në një pozitë
që vë në dukje një botë të tërë
ku Niku nuk jeton



Nga tradita 16.12, Vaj në pëlhurë. 190x100 2016



ARJAN KALLÇO

(SHQIPËRI)

Arjan Kallço lindi në Korçë më 22 nëntor 1967. Frekuentoi shkollën e mesme Raqi Qirinxhi në qytetin e lindjes dhe më pas Universitetin e Tiranës, në degën Gjuhë Italiane, ku u diplomua në vitin 1990. Ka dhënë mësim në shumë shkolla të qytetit të Korçës dhe si pedagog në Universitetin Fan S. Noli.

Ka qenë disa herë bursist i Ministrisë së Jashtme Italiane në Peruxha, ku ka kryer edhe studime për tema gjuhësore dhe letrare.

Që nga viti 2008 është pjesëmarrës në Konferenca të shumta Ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, si në Korçë, Selanik, Tiranë, Kraiovë, Banja Luka, Shkup, Sofie, Tetovë, Ljubjanë, Ohër, Stamboll etj.

Është Ambasador i Akademisë UNIVERSUM, Zvicër për Shqipërinë

Është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Kritikëve Letrarë me qendër në Itali dhe ka marrë pjesë në disa konferenca të saj si, në Morra de Sanctis dhe Leçe.

Është zv/sekretar i Lidhjes së artistëve Pegasi- Shqipëri

Është sekretar i Klubit të Shkrimtarëve "Bota e re", Korçë

Ka përkthyer :

- Proverba të gjuhës italiane,
- Poezi italiane për dashurinë,
- Tregime të shkrimtarëve italianë të viteve '80,
- Novela Plaku i mirë dhje vashëza e bukur,

-Lundrim nëpër valë – (antologjia e poetëve bashkëkohorë italianë)
 -poezi dhe tregime të shumë autorëve italianë dhe të tjerë të botuara
 nëpër revista, gazeta dhe internet.

Është autor i disa vëllimeve me poezi :

-Pafundësia jote më deh-poezi të shkruara gjatë qëndrimit në Greqi;
 (versione dygjuhëshe të librit të tij të parë me poezi: shqip-greqisht, italisht-greqisht etj.)
 -Imazhe të jetuara jete – poezi të shkruara në Itali,
 -Flatërim nëpër stinë – poezi udhëtimi nëpër Evropë;
 -Volum me Haiku : Rreze aureolash

Është autor i dy vëllimeve me tregime :

-Ëndrrat thyhen shpejt,
 -Shkëndija drite mes reve.

Në vitin 2016 boton dy volume me haiku në shqip dhe italisht

-Vallëzimi i gjetheve (italisht)
 -Vargjet kanë mall
 -Ribotimi i volumit Flatërim nëpër stinë
 -Urtësia s’është kurrë e tepërt

Merr pjesë në shumë konkurse në shumë vende, si në Itali, Shqipëri, Kosovë, Greqi, Amerikë dhe poezitë e tij botohen në antologjitë respektive.
 Vitet e fundit boton me gjigantin e editorisë Amazon.

Është fitues i çmimeve :

-Në festivalin Netët korçare të poezisë çmimin e Përkthimit
 -Në janar të vitit 2014 u laureua në Romë në Selinë italiane të Parlamentit European :
 “Një poet për Evropën”
 -Në Festivalin e Strugës, korrik 2014
 -Në Ulqin çmimi i I nëntor 2014
 -Në Ulqin çmimi i II nëntor 2015
 -Në Itali video-poezi, çmimi i III 2015
 -Në Ulqin çmimi i III shtator 2016
 -Në Salamina, Greqi laureat i Medaljes së artë “Aleksandri i madh”

DRITAT E JETËS

Sa shumë e kërkuam dritën
 E diturisë në shekuj, fshehur
 Pas dritareve të mëdha
 Të mbyllura me grila të drunjtë
 Ku brenda errësira sillej
 Si padrone e pamëshirë.
 Sa shumë e kërkuam dritën
 E diellit ditëve gri të vjeshtës
 Apo ditëve dimërore, kur
 Ngricat ta fikin zemrën.
 Sa shumë e kërkuam dritën
 E të vërtetave tona historike
 Por ato janë ende të ngujuara
 Në copa letrash me vulë
 Thellë nëpër arkiva. Koha
 Ua ka kyçur gojën, ngjarjet
 Ua kanë rënuar kujtesën.
 Buzëliqenit të Kosturit
 Drita shumëngjyrëshe
 Tek pasqyrohen në sipërfaqe
 Si pika të dukshme referimi
 I japin qetësinë jetës.
 Një tjetër dritë, oj sirena greke,
 Dalë prej lashtësisë,
 Ma mban gjallë shpresën sonte:
 Drita e syve të tu që në këtë lokal
 Gumëzhitës nga zërat e njerëzve
 Natën e bën ditë.

SHENJTORI ORONC I LEÇES

Një tjetër shpirt pelegrin artisti
 Trazuar me histori dhe heronj,
 Mes rrugicave të ngrysurë plot të papritura,
 Fshehur në ndonjë shtëpi të thjeshtë
 Dhe pa emër të madh, dikur
 Papritur u derdh në art. Aty ku
 Takohen damarët e shtrirë nëpër
 Përdredhje arkitekturash murale

Një lapidar qëndron në këmbë
Dhe një shenjt rri syzguar. Protektorë
I quajnë, shenjtorë, mendimtarë. Asgjë
Nuk kishin të bënin me qiellin, veç një
Betimi të heshtur recituar përmendësh
Në ndonjë tempull dhe grigjën e gjatë
Ditëve në faltore mbushur me pendimtarë.
Përtej detit përballë, një atdhe i dytë
I hapi dyert e mikpritjes. Përndjekja
Nuk njih kufij, despotë, xhelatë.
Histori e njëjtë, avaz i lashtë.
Memoria nuk paket nga dhimbjet,
Mirënjohje nuk do të thotë lëngatë.

PAK BRENGË

Klithma papushim tek rrëshqisnin
Dembele nëpër mugëtirën
E çasteve, e shurdhuan shpirtin
Ditëve të vetmisë nëpër memoriet
E Ohrit që shpesh më është bërë
Mik. E shkuara nuk është e verbër.
Çdo hap që hidhja në lagjen
E ndarë më dysh, nuk ma thërrmuan
Bregën e largësisë, ndërsa
Rënojat e vjetra të mbetuara jetim
Nga idilet e shkuara, për çudi
Koha i rrëzoi shpejt. E reja triumfon
Lehtë mbi ca molepsje të kota
Ndjenjash që gjumin s'e lënë rehat.
Pas shpine mbetën imazhet e takimeve
Në himtësinë e ndarjes, ndoshta shpejt
Kthehen në dhëmbë helmues, por
Për fatin tonë të keq armiqtë tanë
Nuk i zgjedhim dot.



**GERRY VAN DER
LINDEN**
(HOLANDË)

Gerry van der Linden, shkrimtare Holandeze, u lind në Eindhoven, më 25 Nëntor 1952. Van der Linden, ka botuar përzgjedhjen e saj të parë me poezi, “ Shënime”, në vitin 1978. Në vitin 1979 ajo shkoi në USA, jetoi në New York dhe San Francisko për katër vite. Pas kthimit në Holandë, botoi librin me poezi, ‘Rënie nga tehu”

Van der Linden, është profesoreshë e të shkruarit kreativ në Amsterdam. Ka punuar për PEN qendrën e Holandës. Poezitë e saj janë përkthyer në shumë gjuhë të botës. Është botuar në Bullgari, Angli, Francë, Gjermani, Rumani, Indonezi, Maqedoni, Turqi, Slloveni, etj.

Është autore e shumë librave, e midis tyre : “Zarf’, ‘Era’, ‘Në duart e mia prej flatrash’, “Qelq rëre’, “Rrugë pafund”, ‘Njerëz të mirë”, etj.

Gerry e shpreh me krenari se djali i saj Luani, (Kantautor dhe autor tekstesh) njeriu më i rëndësishëm në jetën e saj është prej gjaku shqiptar. Ajo është një nga poetet më të njohura të Holandës. Romani i saj “Era” është përcaktuar nga kritika si libri më i bukur i kohës nën penën e një shkrimtareje femër.

1. I FTOHTI PREK ZJARRIN

I ftohti prek zjarrin
I nxehti ngrin
Ne biem
Gjersa të mos mbetet asnjë lutje

Ne lëndohemi deri sa të mos mbetet asnjë dhembje

Kohët ndryshojnë
E ne të njëjtë mbetëm...

2. KU PISHA GJELBERON

Koka e larvës
Rritet prej tokës, toka
Me bujarinë e saj madhështore
Si boçe e gështenje
Që mban frytin

Shtëpitë njëra - tjetrën prekin
Dhe shiu bie
Larvat dalin nëpër
Vjollca që pulitin sytë

Secili qetësinë thyen
guaskash të zbrazura fjalësh
Rrënjët zënë vend
Nëna mban tabakanë
E çajit të ngrohtë prej bimësh

E udhën nis përmes drurësh
Ku shtëpia më pret
Frika e përhershme
Se mos më kanë rrëmbyer
Fëmijët
Bijat dhe bijtë...

3. NJË GAZETË NJË KËND NJË E FSHEHTË

Nuk dua t'i lexoj gazetat
Nuk dua t'i lexoj gazetat
Nuk dua t'i lexoj gazetat

Asgjë s'mund ta përmbaj
Asgjë s'mund ta përmbaj
Asgjë s'mund ta përmbaj

Asgjë më nuk më mban
Asgjë më nuk më mban
Asgjë më nuk më mban

Një gazetë, një kënd, një e fshehtë fëmijësh...

Nis e them se ti je një dunë rëre
Në një shkretëtirë
Ose një kokrrizë rëre në kyçin e kohës

një stuhi rëre
midis poreve dhe fytyrave
një oazë e paqenë
në një natë pa hënë

Them, je një e kollitur
Në thyerje të ditës
Muzikë e panjohur popullore dhe pse jo
çdo lëvizje tjetër e panjohur

e je një dune që endet
mbrapsht
Them se asgjë nga këto
Nuk është ajo që jam
era që s'ndal

4. NUMURIM

Është një orë që se njoh
Pjesësh të pamatshme
Që ecën vetë

Është një natë që se njoh
E papërshtatshme lëkurës
Në thellësi të zemrës mënjeluar

Është një pëshpërimë që se kuptoj

E flaka tej dhe eci me bukën e mëngjesit
Si stafetë

Është një orë që se njoh
Njerëzish, kafshësh, mjetesh.

5. LUANIT

Të hedhësh gurë mbi dallgë
Rotull teje, ende
Dëshiruar të them
Pa përgjigje,
mos bëj asgjë.

Tani kumti i fjalëve kthehet
Mbi të njëjtët gurrë, të njëjtin shkëmb
Dhe shpresoj, shpresoj e dridhem
Nën rroba feksur në prag të derës
të arsyes në luftë të heshtur
I njëjti gur
I njëjti shkëmb
Godet drejt, lëshohet jashtë
Si breshër

puthjeve që më hëngrën shpirtin
po të them thjesht
pa krenari
kam derdhur në një rreth uji
Një oqeani të zbrazët

Përktheu: Entela KASI



**GIUSEPPE
NAPOLITANO**
(ITALI)

U lind në Minturno (Itali) në 12 shkurt 1949 dhe banon në Formia. Është i martuar me Irene Valonen, poete dhe aktore, kanë një vajzë, Gabrielën. I diplomuar për Letërsi në Romë, në 1972, Xhuzepe Napolitano ka dhënë mësim për 33 vjet letërsi italiane dhe latinisht në gjimnaze të ndryshëm. Që nga viti 2006, drejton një kolanë librash të vegjël: "dhoma e poetit", në të cilën ka botuar, përveç se shumë libra të tij poetikë dhe me ese, edhe autorë të ndryshëm italianë të njohur dhe debutues, dhe sidomos përkthime të poetëve të Mesdheut, të panjohurmë parë në Itali (francezët D. Leuëers, G. Drano, E. Burgos, dhe N. Stamberg, spanjollët C. Vitale, A. Serna dhe G. Vega, tunizianët R. Chehaibi, shqiptarët A. Tufa dhe Sh. Emërllahu, algjerianen S. Negrouche, boshnjakët S. Hadzialic).

Në vitin 2008 ka themeluar shoqatën kulturore "dhoma e poetit", me të cilën ka organizuar prej vitesh një festival ndërkombëtar poezie në jug të provincës së Latinës. Në vitin 2011/2012, Festivali u mikprit nga ekspozita ndërkombëtare "Yacht Med Festival" (Gaeta) me poetë që vinin nga 10 vende të ndryshme.

Botimet kryesore në poezi:

Çaste 1970; *Brenda gjurmës* 1978; *Maskë* 1978; *Nëse te e nesërmja gjen pak të djeshme* 1989; *Kri-jesë* 1993; *Poezi / jopoezi* 1994; *Fjalë fjale* 1998; *Zemër rëre* 1998; *Loja* 1999; *Ekuilibër i ndryshue-shëm* (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2000; *Kalime* (5 libra të vegjël), 2002; *Sextines de Campodimele* (përkthimi

nga Nicole Stamberg) 2002; *Bashkë me ty u linda sërish* 2003; *Në bregun e kohës* 2005; *Fluturo lart, fjalë* 2007; *10 poezi* (përkthyer në gjermanisht nga R. Vecellio) 2008 dhe (përkthyer në shqip nga R. Salihu) 2010; *Antologji* (poezi 1967-2007 nën kujdesin e S. Di Spigno) 2009; *Masa jetësore* (përkthyer në spanjisht nga C. Vitale) 2009; *Ditët e Naimit* (përkthyer në shqip nga E. Zaimi) 2009; *Genius loci* (18 poezi për N. Soscian), 2009; *Fletorkë* 2010; *Pastaj...* (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2010; *Ditët e Tunizisë* 2011; *Shfaqja e sigurisë* (përkthyer në frëngjisht nga G. Drano) 2007 dhe (përkthyer në arabisht nga A. Youcef) 2011; *Tren po tren* (përkthyer në sërabisht nga D. Mraovic) 2011; *Divine dignité du verb* (përkthimi nga Athanase Vantchev) 2014; *Pëshpëritje hënës* (përkthyer në shqip nga I. Zajmi dhe Anton N. Berisha) 2014; *A repentaglio* 2015; *Seminari di lettura* 2015; *Libertà di parole* 2017.

Ai është Anëtar Nderi i Festivalit Ndrëkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" dhe fitues i çmimit letrar "Ditët e Naimit".

NJË BUZËQESHJE, NJË PUTHJE, NJË PËRKDHËLJE

Është tregtar i çuditshëm poeti
që mallin e vet e nxjerr në ankand
për një buzëqeshje, puthje, përkdhelje
e ndoshta për pak gjë e dhuron

Endacak u përgjigjet njëqind ftesave
duke ecur në rrugët më të largëta
duke i shëtitur fjalët – ato të vetat
-që ndoshta më pas dikush do t'i përsëritë

Është gjithmonë gati nëse duhet ta njohë
botën e vet të kufizuar – por ka gjasa
ajo e vetja të jetë më mikpritësja
kur dikush mbetet pa shtëpi

DERA E PARAJSËS

I.

E megjithatë... yshtje tunduese,
shkëlqimi i ekzistencës flet
për një histori magjike

tundim i fshehtë vetmitar
-tinëzar në shikimet e tua, e rrëmbyer
jeta në copëza të shformuara,
saqë edhe me një përqafim atë e njoh

II.

Ndodh kur një rast çapkën
ëndrrës i ofron garnitura vërtetësie,
duke u fshehur në buzët e pasqyrës

-është iluzion i padepërtueshëm-

nëse të shijosh ende do të thotë
një lojë pa rregulla të qarta,
me maska përsosmërisht e luajtur,
por që duhet humbur e mësuar

III.

Pastaj ti përballë meje, në mendimet e tua,
duke ndjekur harmoni të fshehta
i hap udhë dëshirës për një takim-
duke tretur shtigje të kapërcyeshme

dhe tek ty i qetë jam ndërsa end
një fshikëzë mbrojtëse dashurie
për fluturën që lind me dëshirë

ORFEU. PROLOG DHE REFRENE

Anton Baevit (Tetovë, tetor 2017)

*Orfeu – bashkëpunëtor Hermesi – provoi lojën
para Aliçes duke e kapërcyer kufirin
përndryshe s'guxon nëse poezia
nuk këndon me një zë dhe gabohet
se e nesërmja do të jetë ëndrra e djeshme*

Është shumë i hutuar Orfeu që t'i besojë
përrallës së një gruaje të dashuruar
me zërin dhe me poezinë e vet,
dhe i kënaqur heq dorë prej ëndrrave të tjera
ndërsa përralla e vet bëhet e vërtetë
duke e larguar nga tundime të reja

Poeti e di se një mision
edhe më i vështirë e pret
nëse zërin e tij, nëse poezinë e tij
do të dijë t'ia besojë atij që e dëgjon
duke u larguar nga tundimet e lashta

Një refren i stonuar s' mund ta bëjë
jetën e një vajze të dashuruar
nëse poezia e një përralle të vërtetë
nuk do dijë si të këndojë me dashuri

Përsëri përjeton prapë një dashuri
në fjalët e ruajtura me besimin
e atij që di si t'i ndezë ato në poezi

Flaka e sapondezur s'mund të fiket
nëse një zemër e mirë e ushqen ëndrrën
dhe tashmë këtë Orfeu nuk e harron

Përktheu Arjan Th. Kallço



ELENA PRENXHOVA

(MAQEDONI)

Elena Prenxhova u lind më 1985, në Shkup. Ajë është profesoreshë e Gjuhës dhe letërsisë angleze, si dhe magjistre e shkencave filologjike. Ka botuar libra me poezi dhe me ese për poezinë. Është reda-

ktore e “Antologjisë së poezisë së re avangarde maqedone” dhe bashkëredaktore e antologjisë ekskluzive të poetëve bashkëkohor maqedon “Kjo është heshtja ime e fundit”.

Prej vitit 2012, ajo është anëtare aktive e Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë.

Ajo organizon gara konkurruese për qytetet e Maqedonisë, ka marrë pjesë edhe në regjion dhe ka qenë përfaqësuese e Maqedonisë në gara Evropiane. Punon si lektore në gjuhën bashkëkohore angleze për nevoja specifike në universitet dhe mban puntori për shkrimin kreativ.

MEQË NUK MUND TË DUHEMI MES VETES

pasi të na i gërvishtin zemrat
sërish do t’i kthehemi njëri-tjetrit
dhe pasi të na derdhin gjak
gjak do të dhurojmë
dhe secili për vete luftërat e veta i bën

dhe sa herë trupat t'i bëjmë bashkë
dhe sa herë shpirtrat e përvëlur
heshtazi edhe t'i ndajmë
me zjarr e flakë
njëri nga tjetri do të ndahemi
si një gacë e vogël e fundit
dashurinë do ta djegim lehtas
qetë-qetë do të tretemi në zjarr
derisa mos ta djegim përfundimisht veten
nga brenga djega dhe halli
nxitojmë drejt fundit duke rënë pa fener në dorë
dhe atje shpirtzbrazur do të takohemi
dhe dhembje e britma do të përjetojmë
dhe me një kore mëkati për kungatë do të takohemi
dhe me një shportë mllefi do ta përcjellim njëri-tjetrin
dhe sërish
verbërisht e me inat
premtimeve të rreme dhe fjalëve të zbrazëta
do t'u kthehemi
ngase nuk mund ta kuptojmë
se kohën s'mund ta kthejmë dot prapa
se nga shkaku që nuk mund ta duam njëri-tjetrin
prandaj dergjemi qajmë dhe vuajmë

VRIMA E ZEZË

të kaluarën e kemi të ndërtuar me gjak,
kurse të nesërmen e ndërtojmë mbi eshtrat
që ende s'janë shpërbërë

e tashmja kundërmon nga lëkura e mishi i kalbur
dhe asnjë parfum nuk mund ta freskojë kundërmimin,
kurrfarë silikonit nuk mund t'i rianimojë skeletet

jetojmë në një varrezë
më të madhe edhe nga varret e luftërave,
më luksoze edhe nga pallatet më të stolisura të sun-
dimtarëve

e vrimë e zezë jemi –
s'e dimë se çfarë ka brenda nesh,

çfarë absorbojmë nga jashtë
dhe çfarë rrezatimi shpërndajmë rreth nesh

vimë e zezë jemi –
e gëlltisim vetveten

vimë e zezë jemi –
e kapërdijmë historinë
dhe e gogësimë të ardhmen
por në kushtore

vimë e zezë jemi –
po të mos kishin ditur për ne
nuk do të ekzistonim nga vetvetja

vimë e zezë jemi –
dhe kurrfarë e vërtete
iluminizmi
stabilizimi
materieje
përfundimi
nuk do të na e plotësojë zbrazëtinë

SHKUPJANI

shkupjan
të takoj gjithmonë në një terren të huaj
asnjëherë në terren të vendit të Shkupit
në stacione hekurudhore dhe vende të huaja
në vende me pak mirëseardhje e shumë ndarje
atje na takohen jetët
dhe së bashku na vazhdojnë shtigjet
duke na shpjerë deri në stacionin e fundit
që na ndan në veri e perëndim

shkupjan
të takoj gjithmonë në terren të huaj
asnjëherë në terren të vendit të shkupit
në stacione hekurudhore dhe vende të huaja
në vende me pak buzëqeshje gazmore
dhe shumë lot ndarjeje

atje na takohen jetët
dhe së bashku na vazhdojnë shtigjet
ne jemi vetëm aktorë të shfaqjeve të huaja
ti e luan pjesën tënde
unë rolin tim
regjinë e bën fati
ose Ai të cilin nuk e besojmë

shkupjan
të takoj gjithmonë në terren të huaj
asnjëherë në terren të vendit të shkupit
në stacione hekurudhore dhe vende të huaja
pa pritur e pa kujtuar pa ndonjë shpresë
në pauza midis disonancave të dashurisë
në dhomat e hoteleve me krevate bashkëshortore
nga çarçafët nuk rrjedh gjak i bardhë e farë e bardhë
por shumë TV dhe doza të tepruara vere të bardhë
unë femër në masë të pamjaftueshme
ti tepër xhentëllmen (ose boll gej)
dhe të dytë të dozuar përpikërisht me miqësi
shumë respekt shumë admirim
hiç dashuri hiç pasion
kështu është më së miri kjo është përkryerje
po të mos kishe qenë aq inteligjent me finesë
dhe i kujdesshëm e galant
sa je tmerrësisht i bukur
do t'ia merrnim virgjërinë miqësisë
po hymë nga një tregim në tjetrin
krijojmë kujtime për vete
të tilla që nuk fshihen dot
sepse janë filmike të rralla
dhe të rrënjosura në qelizat tona
pasqyrohen si pamje fotografish
kumbojnë si rruzare fjalësh tingëlluese
ke hequr dorë nga arti
jam bashkuar me artin
të pyes ku i paske pajisjet
i paske shitur më thua
më pyet ku i kam fjalët
t'i recitoj vargjet
të pëlqejnë
ose së paku pohon se të pëlqejnë
atë që me të vërtetë e mendon s'e thua
nuk mund të t'i lexoj mendimet

ti lexon fytyra
sepse krijon piktura
neve pak na jepen raste
prandaj me shkathtësi mësuam t'i rrëmbejmë
dhe gjithashtu pa dhembje të heqim dorë prej tyre
kur të vijë koha
ose thjesht
kur udhëtimi të na përfundojë në shkup

shkupi
ka shumë shtigje e udhëkryqe
atje na presin moshatarët tanë
të pyes sa shpesh udhëton
t'i llogaris matematikisht shanset
për takimin tjetër me ndarje të paevitueshme
ta tregoj destinacionin tim të ardhshëm
dhe menjëherë refuzoj
nga frika se përsëri do të të takoj
dhe nuk do të mundem të duroj
ngase i ke shitur pajisjet
dhe ke hequr dorë nga arti
je bërë i kujdesshëm financiarisht
menaxher banke
kurse unë renxher i pazbutshëm rebel
fle me miqtë e tu
hooop territor i ndaluar
rregulli themelor në teorinë miqësore të meshkujve
dhe ne jemi miq
(por nga dy gjini të ndryshme)
dhe sa më rrallë që të shihemi
aq më shumë respektohemi
dhe sa më rrallë takohemi
aq më shumë gëzohemi
aq më shumë na rrjedhin kujtimet
ty si piktura mua si fjalë
unë në tungjatjeta ti në çao
pra me të vërtetë bravo
ngado që të nisemi shkojmë vetëm drejt
se shkupi është si roma
të gjitha udhët shpijnë atje
dhe të gjitha ndarjet ndodhin atje

shkupjan
të takoj gjithmonë në terren të huaj

asnjëherë në terren të vendit të shkupit
në stacione hekurudhore dhe vende të huaja
e udhëtoj shpesh
nëpër autostrada të gjera e udhë të pafund
atje është vendi im
dhe nëse ndonjëherë kërkon gjini të kundërt
për këmbim qetësish e fjalësh
kah paanësia e rrugëve shiko
dhe në të ftofshin nëpër to urdhëro nisu
mbath këpucë të reja
merri me vete kujtimet e vjetra
rrugës do t'i gjesh ndryshimet e njëjta
do të jem ajo por më ndryshe
e ndryshme po e njëjta
dhe historia do të përsëritet
dhe largësia afërsinë midis nesh do ta hapë
dhe pasi t'ia themi replikat njëri-tjetrit
e t'i ngjallim imazhet
do të përshëndetemi
kinse një takim të sërishëm kemi caktuar
ndonëse e dimë se edhe koha e vendi kanë hequr
dorë prej nesh
miq jemi ... jemi në tel ... flemë

Përktheu: Lindita Ahmeti



PRIMOŽ REPAR

(SLOVENI)

Primož Repar (Lubjanë, 1967) ka studiuar filozofi dhe histori në Universitetin e Lubjanës, ku ai mbrojti gradën akademike pasdoktorale (Ph.D) në vitin 2009. Tema e doktoraturës së tij ishte filozofia e Søren Kierkegaard-it.

Ai është autori i 26 librave në gjuhë të ndryshme dhe një përkthyes i përkushtuar i

veprave të Kierkegaard-it në gjuhën sllovene. Primož Repar është bashkëthemeluesi dhe kryeredaktori i shtëpisë botuese »KUD Apokalipsa«. Njëkohësisht koordinon simpoziumin ndërkombëtar filozofik »Miklavž Ocepek« dhe projektin

ndërkombëtar »Rishikim brenda rishikimit«. Ai është drejtori i Institutit Kërkimor të Europës Qëndrore »Søren Kierkegaard« në Lubjanë (Slloveni).

PSE E ARDHMJA DUKET E ZYMTË PËR SHKENCËN, POR MË MIRË PËR POEZINË

(lirisht sipas Husserl-it dhe Patočka-s,
që për herë të dytë)

Jurij-t, i cili është më shumë për t'u fajësuar për këtë poezi se të tjerë

Shpesh lexoj tekste heretike të cilat nganjëherë edhe shkruaj - edhe pse zakonisht jo aq me guxim.

Por mu tani çdo gjë më neverit dhe duhet të pështyj
 jashtë,
 kur përsëri lexoj Patočka-n në Istrinë e Jurij-t.
 Realiteti partikularist i shtetit si korporatë
 i kapitalit nepsqar
 është bërë *llap* që të bën që dëshiron të vjellësh.
 Rol fatal në kohë fatale.
 Suksese kalimtare të cektësisë dhe gënjeshtrave të
 kalbura.
 Hipokrizia që e përmbyt Europën.
 Personalizmi shtyhet kundër mureve të Bizantit
 ose fasadave të qyteteve urbane të sotme.
 Shkenca, industria dhe teknologjia po krijojnë një
 kuptim
 të rremë të vetes.
 Pa përmendur besimin në vetveten.
 Vetëkuptueshmëria,
 që është dukuria e pamend
 e burokratëve dhe vartësve të vegjël të Brukselit.
 Universalizmi i Iluminizmit të fuqishëm u rrëmbye diku.
 Totalitarizmi i konsumizmit tërbohet në terren të djegur.
 Cinizmi po shpërthehet me sinqeritet.
 Prandaj ekzistencializmi nuk është një racë humanizmi
 por universaliteti i individit.
 Për jetën dhe kundër furisë orgjike të hordhive,
 I nxitur nga aparati i korrektësisë pa të meta.
 Të gjitha këto dobësi na u zbuluan nga Perandoria
 të lyera përherë në shpërbërje
 të *shtratit të detit të shkretuar* – ja realiteti i shkretëtirës.
 Dhe i shteteve të reja (ose më saktë, i idealit të tyre
 pervers),
 ku vendasit vendosën lëndë plasëse.
 dhe policia (vuri) rrjete prej telit me gjemba nga brisqë
 të mbrojtura nga ushtria
 për pelegrinët drejt së *ardhmes*, të cilët në shtëpi vriten
 si mizat.
 Dhe kjo është ende më e keqe.

Kërkimi filozofik tregon se
 kjo *pikturë flet vetëm për vetveten*.
 Sokrati Teatetit:
 “*Është kryesore të kesh një mendim.*”
 Teateti:
 “*Jam dakord.*”

Dhe ti di shumë mirë që dielli do të zbehet
dhe të zhytet në det.
Gjë që nuk është më e keqja që mund të ndodhë.
E keqja është që filozofët janë të heshtur
kur plotësojnë aplikime për projekte.

Për dreqin, njeriu duhet të mbijetojë,
të mbulojë shpenzimet bazë
dhe të ushqejë gojë të uritura.
Jo ato në Afrikë, kjo është abstrakte,
por tonat, vetëm tonat.

Fashizmi bëhet përsëri arma kryesore e lindjes
europiane
(në njëfarë mënyre edhe e perëndimit, mos gabo),
për të ruajtur dhe mbrojtur përsëri kufijtë e Perandorisë
që po vdes. Për të mbrojtur vlerat
e perëndimit dekadent. Më mirë zero se asgjë(ja).
Nihilizmi absolut që po lëshohet.

Jan Patocka ishte Sokrati i fundit kur shkroi:
“Është ironike që Husserl-i ka shkruar veprën që
përmban
konceptin e tij fenomenologjik të historisë në prag të
zjarrit të madh global që definitivisht zhvendosi
Europën
nga roli i saj udhëheqës në botë. Është e vërtetë që
njëkohësisht
e ktheu shkencën dhe teknologjinë europiane në një
lidhje globale.


Por qytetërimi european u bë një lidhje globale në
pikërisht atë
formë të cilën *Kriza nga shkencat europiane* nga
Husserl-i provoi si
dekadente, që në të ndodh një humbje kuptimi,
humbja e
mu asaj ideje teleologjike kuptimdhënëse e cila, për
Husserl-in,
përbën esencën e brendshme spirituale të Europës.”

Por para se të vdiq Sokrati pasi u torturua në burgun
komunist,
tha diku që gjithçka është shumë më e thjeshtë.
Kufijtë europeanë duhet të hapen njëherë, kurse
dashuria është ende e re

dhe kur mundësia e kthesës ekzistencialiste ende mund
 të mbijë
 në *dashuri* aktive,
 Një pezullim i teleologjisë.
 (Këtë e shkroi në fillim të viteve 1970 prapa perdes së
 hekurt,
 kur regjimi tashmë e vëzhgonte dhe ai shkoi për në
Universitetin Nëntokësor.)
 Dhe ne të gjithë jemi të *huaj* për njëri-tjetrin,
 gjithmonë.
 Dhe të ve dhe jetime.
 Ajo që na nevojitet nuk është asgjë tjetër përveç asaj
 që kërkoi Myshkin-i
 për t'u martuar me Aglajën
 dhe për të mos u çmendur për shkak të poshtërsisë së
 botës
 ndërsa askush nuk donte ta vriste Nastasiën,
 më së paku nga çmenduria e imagjinatës së dashurisë
 së sëmurë dhe të gjymtuar.

Këtu Wittgenstein-i kujdeset për *tonin* apokaliptik,
 nëse marrim hua nga Derrida-ja,
 dhe ai aludon për Dostojevski-n
 (duke i bërë me kokë).
 Nuk vras mendjen nëse të ashtuqajturit burra të urtë
 ose disa psikoanalistë ose filozofë socialë super-
 inteligjentë
 do të shpallin këtë copë shkrimi për një telenovelë
 ekzistencialiste.
 Fjala në fjalinë u bë një imazh i thjeshtë. Një ikonë
 nga e cila pikoi një lot kur vdiq Miklavž-i.*
 Fjalët e tij të parët dhe të fundit ishin: Nuk mund të jem
 përgjegjës.

*Përkthyer në anglisht nga Ana Jelnikar dhe Barbara
 Siegel Carlson, nga anglishtja në shqip nga Silke Liria
 Blumbach*



REMZI SALIHU

(MAQEDONI)

Remzi Salihu u lind në Gajre të Tetovës. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Tetovë, kurse Fakultetin Filozofik-Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe në Prishtinë. Pos poezisë shkruan edhe kritikë dhe përkthen nga gjuha gjermane. Ka përkthyer poezi prej Erih Fridit, Paul Celanit, Roze Auslanderit, H. M. Eckenbergerit, Folfgang Behlerit. Ulla Hanit, Myhael Krygerit, si dhe studimin „Mjeshtria e interpretimit“, nga Emil Shteigeri, etj.

Në konkursin letrar „Goranova prolet“, që mbahej në Zagreb, fitoi me librin „Fluturimi i largët“, të cilin shpërblim e botoi “Rilindja”, 1987. Librin e dytë „She-shi i shtrigave“, e botoi më 1992, librin e tretë „Gjur-më malli“, ia botoi “Flaka” 1993. Ka qenë themelues i Grupit letrar në Tetovë dhe redaktor përgjegjës i revistës “Vlera”. Ai ka qenë edhe njëri ndër themeluesit e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Zvicër. Një kohë ka qenë në Kryesinë e Shoqatës së poetëve „Pro dichtung Ballada“, Zvicër etj. Me poezitë e tij ka fituar nëpër shumë konkurse letrare. Më 2007, merr çmimin “Akti i shpirtit” për poezi motivuese nga Shoqata e Artistëve „Pushkin“. Klubi i Shkrimtarve “Jehona e Karadaku” më 11 mars, 2009 i dha mirënjohje për fitimin e vendit të parë me poezinë „Nënat e dëshmorve“. Në vitin 2014, merr shpërblimin “Abdzlayis Islami” nga përkthyesit e Maqedonisë. Më 2015, në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë “Ditëte Naimit”, ai vlerësohet me çmimin letrar “Qiriu i Naimit” etj. Ka punuar disa

vite në arsim. Një kohë të gjatë ka vepruar dhe punuar në Zvicër. Tani jeton si krijues i lirë në Tetovë.

Veprat e botuara të tij në poezi janë:

Fluturimi i largët, "Rilindja", Prishtinë, 1987

Sheshi ishtrigave, Tetovë, 1992

Gjurmë malli, "Flaka", 1993

Vepra kritike

Largimi nga izolimi, Tetovë 2010

Povokime metaforike, Tetovë 2011

Theksime letrare, "Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë", Shkup 2017

Përkthime

Todor Çalovski, "Truall", poezi 2010

Antologji e poezisë moderne gjermane 2013

STACIONI FUNDIT I KËRKIMIT

besim i stërzgjatur rituali
merr frymë kozmike në ajër
imazh lëngate vret buzëqeshjen
kurse misterin e thellësive
e varr të vetmuar në heshtje

pritja e copëtuar nga durimi
djeg portretin me sytë tu
të nazuara nga përqaftimi i çastit
në parakalim mendimi të pa pritur

ofshama merr aromën heshtejes
kalon shija e saj matanë afshit
dhe mbyllet në kafazin e pritjesjes
në stacionin e fundit të kërkimit

GIJOTINË E FTOHTË

Një lëkurë e lagur vjeshte
kalon e freskët nëpër lëkurën
e hijes sime të rrëzuar në dritë

Qese najloni shpërndajnë
copa të ndryshkura ngjyrash
nëpër këmbët e ndjeshme
një fllad stine m'i përkund
faktomat e zinxhirta në trup

Pastaj një qiell i thinjur
mbjell flashka të mplakura
nëpër pasqyrën e ujit në asfalt
gjethe të zverdhura vitesh notojnë
si anie të braktisura në shtegtim
nëpër muskujt e ujit të arratisur

Miza përdhecë me trasta në shpinë
kërkojnë rrugëdalje kohe
nga rrënjët e sulmuara të ndarjes
dhe dallgëve që përplasen
papandehur në gijotinën e ftohë

NË MUZGUN E NJË KUJTESE

të gjata i ke bredhjet në kohë
nëpër atë rrugë të ylbetë kalimi
kur lodhja gudulis mendimet
vetminë shpërlanë me stërkala dritash

me stinë ëndrrash rrethuar
e mikluar me shikim kujtese

ti qëndron atje në breg
si guacë e rrallë deti
e përkëdhelur nga dallgët e njelmëta
e shpërlarë me shije davaritjesh
dhe përqafon vjedhurazi ikjet
me lisan fjalësh të freskëta në gishta
në muzgun e një kujtese të brishtë

BAZELI NATËN

Në përçafimin e udhëkryqit
tetuazhophet shkuarja dhe ardhje e kulturave
vetmia noton kujtimet përmbi dallgë
Bazeli alfabetizon gjurmët e pranisë sime
fshehtësitë zbulohen ngadalë nga dritat
e rrëzuara vertikalisht në Rajnë
çdo gjë e ëndrruar thellohet në ne
vetëm shkënditë e vezulluara
na rijnë mbi kokë si meteor
këmbejmë pyetje dëshirash
në arratisje dallgësh nën blanë
për lashtësitë e feribotave në shtegtim
që venë e vijnë nëpër mendimet tona
si bagazh kohe në jehonë malli
ambientohe mi nëpër përkëdheli dritash
dhe zhytëmi papandehur në kujtesë
thellësive të përfytyrimeve marrim frymë
me Bazelin natën në shtegtim
dhe me aromën e mallit kah jugu



ELIZA SEGIET

(POLONI)

Ka kryer studimet “Master” në Filozofi. Ka mbaruar studime pasdoktorale në Njohuri Kulturore, Filozofi, të Drejtën Penale, Fiskale dhe Kriminale Ekonomike, Art dhe Letërsi në Universitetin Jagiellonian si dhe të Drejtën Penale dhe Fiskale, Prodhim Filmi dhe Televizioni në Lodz.

E thyer midis poezisë dhe dramës. I pëlqen të shikojë retë, por i ka të dy këmbët në dhe. Zemra e saj është afër mendimit të Schopenhauer-it: “Njerëz të zakonshëm vetëm mendojnë se si ‘harxhojnë’ kohën e tyre; një burrë i talentuar përpiqet ta ‘përdorë’.”

Poetja e muajit (qershor 2017) në *Viti i Poetit* në SHBA.

Poezia e autores “Pyetjet” qe botimi i muajit (gusht 2017).

Autorja e Botimit Ndërkombëtar të Vitit (2017) në shtëpinë botuese Spillëords Press.

Laureate e Çmimit të Veçantë Ndërkombëtar “Frang Bardhi - 2017”.

Vendi i dytë në konkursin ndërkombëtar “Nature 2017-2018” për poezinë “Grumbuj frutash”.

Autorja e muajit (janar/shkurt 2018) në Spillëords Press.

Autorja e muajit (maj 2018) në arkivin indian “Poezia jonë”.

Poetja e muajit (qershor 2018) në *Viti i Poetit* në SHBA.

Veprat e autores gjenden në antologji dhe revista letrare në Poloni dhe jashtë (Australi, Bosnjë-Hercegovinë, Britani e Madhe, Filipinet, Indi, Kanada, Kili, Kosovë, Portugali, Rumani, Singapur, Skoci, Spanjë, Suedi, SHBA, Shqipëri, Zambì).

JETA NDODHI

Për disa
Jeta ndodhi
prapa telit me gjemba.
Atje u lindën Numrat
- punuan,
- vdiqën,

po vdekja?
i vizitoi jo vetëm
gjatë një banjoje.
Gjithë
atyre
me kostume të ndyra me shirita
mund t'u ketë ndodhur -
Jeta.

DET MJEGULLASH

Në strofull
kuptoj
që normaliteti është kur
gënjen kur të duash
dhe jo kur të duhet.

Kur tjetër?
Kur nga deti i mjegullave
nuk dalin trupa.

Normaliteti është kur
njerëzit nuk dëmtojnë njerëz
dhe fëmijët nuk luajnë vrasje!

-Dada, për çfarë po mendon?

-Për luftë.

-Pse? Mbaroi.

*-E dashur,
brenda nesh-
do të mbetet përgjithmonë.*

BUZËQESHJE

Bota e së kaluarës
iku me tren
për të mos u kthyer
kurrë.

Kohë bashkë s'ka më.

Të kujtosh
prindërit kujdesës
nganjëherë sjell prapë një buzëqeshje,
por
asgjë nuk do të jetë siç
ishte para ikjes.

Tepër shumë karrige të zbrazëta.
Tepër shumë pjata të zbrazëta.
Kanë jetuar këtu aq gjatë.

-Ende duket
që dikur,
që bashkë,
që...



Nga tradita 16 19. Vaj në pëlhurë 70x90 2016



GLORIA SOFIA

(PORTUGALI)

Gloria Sofia u lind më 1985, në Kepin e Gjelbërt. U diplomua në inxhinieri dhe menaxhimin e mjedisit në Universitetin e Ishujve Azore. Zhvillon aktivitete në fusha të ndryshme kulturore. Është nominuar si

kandidate për nismën “R.M. & P. Arts”. Ka kompozuar muzikë për poezi. Ka marrë pjesë në festivalet e poezisë në Stamboll dhe në Rumani. Ajo ka botuar tri libra me poezi. Poezia e saj është përkthyer në antologji të ndryshme ndërkombëtare.

VUAJTJE PËR TË TË PASUR TY

Dielli shpërthen në qiell
 Duke djegur hënën
 Duke shkatërruar të kaltrën e amshuar
 Mbin në mitrën time
 Ylli i mbushur me muzikë E lëndon gjithçka
 Nënë e enjtur
 Lukth i mbështjellur
 Gji që skuqen
 Trupi im valëzues
 Është vetëm çarçafi që mbulon një lumë
 Çarçaf i plagosur nga hija e muzikës.
 Këmbët e mia shkelin baltën e botës.
 Me peshën e një fëmije në mitër,
 Frika shkel shpirtin tim Në një agim të ri
 Sa vuaj të të kem ty, paqel!

HARROJE LIRINË

Shpeshherë duhet të harroj
Që edhe retë mund të trishtohen
Nga dritat e së qeshurës, të ngjeshura
Dhe nga lotët e tingujve, të braktisura
Duhet të harroj që dielli ndriçon

Aq lart por hedh dritë mbi udhën
Duhet të harroj
Që para jetës së perëndimit
Dielli djeg ashpërsisht dhe vë zjarr
Gjithë ndjenjën, në zinxhirë

Duhet të harroj
Pemët e trishtuara të vjeshtës
Të lulëzuara nga vdekja, pa e merituar
Era gjëmon në një kumbim monoton

Sot mbasdite lulet janë bërë shpata.
Por nuk mund të harroj
Mos u rrëqeth kurrë
Kur poezia është liri

PRESTARI I DHIMBJES

Toka pret detin
Gri pret të kaltrën
Lotët presin zërat
Kujtimet presin zemrën time
Lakmia pret klithmën
E keqja pret fëmijërinë
Qejfi pret pafajësinë
E ftohta pret gishtat
Askush nuk pret dhimbjen time

*Përkthyer nga portugalishtja në anglisht
nga Cândida Mendes, nga anglishtja në shqip
nga Silke Liria Blumbach*



MOAEN SHALABIA

(IZRAEL/PALESTINË)

U lind më 14 tetor 1958 në qytetin Maghar, në rajonin Galilea.

Është një poet palestinez, njëri nga pakica arabe palestineze që jeton në Izrael.

Ka kryer studimet e mie në Universitetin e Haifa-s.

Filloi karrierën time si poet dhe shkrimtar proze më 1973.

Botoi poezitë e tij në gazeta kombëtare dhe lokale dhe në gazeta arabe.

I linduri im i parë qe libri i parë i poezisë në vitin 1989.

Ka botuar gjashtë libra me poezi dhe tre libra me prozë.

Ka marrë pjesë në shumë festivale lokale dhe ndërkombëtare.

Fitoi Çmimin e Poezisë të Bashkimit Arab për vitin 2018, çmimin më të rëndësishëm në botën arabe.

Ministria palestineze e Arsimit e shpërbleu për përpjekjet e tij për të pasuruar arsimin kombëtar dhe për besnikërinë e tij ndaj çështjes palestineze dhe parimeve të drejtësisë dhe lirisë.

U shpërblye edhe nga Forumi i Intelektualëve Arabë, Jerusalem - Alquds.

Gjithashtu, mori shumë mirënjohje si anëtar i Bashkimit të Shkrimtarëve Arabë dhe Lëvizjes së Poetëve të Botës (Poetas del mundo) dhe anëtar i Fondacionit "Mahmud Darvish" për Krijimtari.

Vepra e tij letrare u diskutua dhe u kritikua nëpër universitete dhe në shumë seanca në vendlindje dhe jashtë.

Disa nga poezitë e tij u përkthyen në shumë gjuhë, si frëngjisht, turqisht, anglisht, rumanisht, polonisht, maqedonisht, italisht, hebraisht, boshnjakisht, shqip, kroatisht dhe në gjuhën malajase.

Përmbledhje e tij të poezisë u përfshinë në antologji kombëtare dhe ndërkombëtare.

VIZION

Supozova, shoqja ime

Se leximi i poezisë

Mund të jetë një habi ose një dashuriçkë ose një
pëshpëritje zjarri

Dhe supozova, e shkëlqyera ime

Se shkrimi i poezisë

Mund të jetë një mendim ose një vrull ose një shtysë

Dhe supozova, e dashura ime

Që feminiteti

Mund të jetë një butësi në zbulim ose një dridhje
mahnitjeje

Dhe supozova, princesha ime

Që ribashkimi yt përbindëshor

Mund të jetë një dhunti ose një dozë qelibari

Dhe supozova që trishtimi, e çmuara ime

Është një vend si të gjitha pasqyrat dhe të gjitha detet

Dhe supozova, e vrara ime, që vdekja është e
mbështjellur

Në të gjitha aspektet e ardhjes së moshës, dhe që
mund ta mbush boshllëkun

Dhe supozova që pasioni, frymëzuesja ime, është një
gjuhë

Që vjen shpejt pa pritur

Dhe supozova që të ëndërrosh, dashnorja ime

Është një obsesion i vjetër që kurrë nuk ndalon të
vërtitet

Dhe që shpirti dhe trupi, robëruesja ime

Është një flautë mbi dhembshurinë e ditës

Gjithsesi nuk supozova kurrë

Që ikja jote e përhershme

Do ta përfundonte vendin dhe mbaronte kohën

Dhe që ngritja ime drejt humneres sime

Do të ishte për dashuri

Edhe pse ishte vetëvrasje.

DRITARJA IME E MJEGULLT

Prapa dritares sime të mjegullt,
Dëshira e zbulësës më nxit
Të zbuloj një planet që shkoi thellë në retë;
Mbetjet e një ere që gërvishtin trupin tim për ta
depërtuar,
Si një ëndërrues që shkon nëpër pasqyrat e mungesës!

Prapa dritares sime të mjegullt,
Një hapësirë për hënën thyhet para meje në errësi,
Vjedh një vështrim në spektrin e saj në rritje nga
poshtë shiut.

Prapa dritares sime të mjegullt,
Ajo lëvizet para meje si paraqitja e shkurtër e "ah!"-ut
në gjoksin tim;
Deti regëtin brenda meje si një kalë përtej qeifit,
Kurse e katra e amshuar fshin hijet e rërës,
Dhe unë iki kudo që të më çojnë fjalët në elegjitë e
kujtimeve.

Prapa dritares sime të mjegullt,
Mblodha drurin brenda meje dhe i vura zjarr;
Rregullova qilimin tim persian, disa nga shkrime të
mia, duhanin tim, shqisat e mia,
Një dorë plot muzikë dhe aromën e rrobave të saj
Dhe i kalova duart madje mbi muret.

Prapa dritares sime të mjegullt,
Më sulmon një intuitë e thyer, e goditur nga stresi,
ankthi, frika dhe malli
Për dikënd që depërton drejt paqartësisë së dukshme
dhe rritet deri në hidhërim;
Shqyrton veten time por shpejt përfytyroj që unë jam
Askush, Askush!

Prapa dritares sime të mjegullt,
Flokë dëbore bien mbi palltot e zembrës sime dhe
humbja derdhet poshtë
Shija e shiut intensifikohet; brenga lundron në shpirtin
tim -
Dhe unë qaj:

Zonja ime, Zonja ime! O grua që heq gjithçka përveç
feminitetit të saj;

Era do të mbushë veshjet e mia dhe mbi shtratin e
dashurisë, britma e krijimtarisë do të burojë!

Prapa dritares sime të mjegullt,

Ajo më vjen nga mosqenia, duke mbajtur plagën e saj
të zjarrtë

Për ta zgjuar Tammuz-in, i cili kurrë nuk ka munguar,
brenda meje,

Tammuz, i cili sigurisht do të kthehet!

LARGIMI I SHPIRTIT

Të pashë duke pikturuar ëndrrën

Midis zjarrit dhe natës,

Dhe hënat mbi natën,

Dhe pikëllimin prapa shpirtit,

Dhe ngjyrës së pikëllimit i pëlqen muzgu.

Të pashë duke mbajtur detin e mërguar në sytë e tu

Dhe pjata besimi dhe mosbesimi,

E pyeta detin se a njeh bartësen e tij,

Deti u përgjigj me valë lodhjeje.

Të pashë duke shkarkuar heshtazi pikëllimin në buzët
e tua,

Mos më pyet tani për mbytjen time?

Ti the: "po",

Pse lumi nuk rrjedh ashtu si duam,

Nuk duam ta kalojmë dashurinë si gjethe.

Të pashë duke përqafuar gjembin,

Dhe gjembi plagos,

Pastaj thashë: mjaft

plaga të gjembit në të brengosurit.

Të pashë prapa pikëllimit tim dhe brenda tij,

A mund ta durosh pikëllimin në udhëtime?

Jam lodhur nga pikëllimi, nuk e di

Se ku largohen shpirtrat derisa qafat

E fshijnë pikëllimin.



LUCILLA TRAPAZZO

(ZVICËR)

Cassino, 1964. Jeton në Zyrh dhe Nju Jork. Studioi letërsi gjermane në Itali në universitetin "La Sapienza", më vonë mbaroi studimet Master për film dhe video në "American University" në Uashington, D.C. (ku njëri nga filmave të saj të shkurtër u shpërblye me një çmim). Studioi teatër në "Fersen Academy" në Romë me Elizabeth Kempin (Actor's Studio) dhe me Jonathan Fox-in (Playback Theater) dhe art me Barbara Rose-n.

Aktivitetet e saj përfshijnë poezinë (laureatja e çmimeve të ndryshme, botime në antologji dhe libra arti), teatrin (udhëheqja e punëtorive, regjisore, aktore), instalime videoje si dhe kritika letrare. Në punën e saj synon një sintezë të të gjitha gjuhëve të ndryshme artistike. Veprat e saj u treguan në disa ekspozita dhe festivale të ndryshme. Prej vitesh bashkëpunon me tri shoqata kulturore në Itali (*TiconZero*, Cagliari, elektroakustikë eksperimentale dhe gjuhë anësore; *ARS Cultural Movement*, Romë, art pamor; *Tracce nel vento*, Palermo, letërsi dhe botim).

"*Ossidiana*" është libri i saj i parë me poezi, i botuar në shtator 2018 nga Voltornia Edizioni, Isernia, Itali.

PAMJE E PALËVIZUR

Zbret juga e ngjyer me rërë
në qytetin e veshur me të kuqe.
Larg treni fërshëllen përshëndetje.
Koha e ndalur, e zbërthyer
e bymen asfaltin dhe mendimin
e shqyer. Verdhësia është e arratisur
përtej mjegullës duke i lënë
gjërat të kërkojnë vlerën
e qënies që rrokulliset dhe rrëshqet.

Në thelbin e vet një karrike është karrike
edhe në një fotografi në mur.
Një trëndafil është gjithnjë trëndafil nëse
në kokë ruan tiparet.
Ideja është një lidhje e qëndrueshme : sinaps
që i jep formë. Asgjë më shumë.
Tek stacioni i autobusit
një i moshuar thith llulën
dhe ndoshta pret të zbresë mbrëmja.
Apo ndoshta tramvajën e radhës.

HORIZONTI I NGJARJEVE

Nuk e di nëse fjala përfshin
pafundësinë apo është vetëm abstraksion
një *flatus vocis**. Në janë shenja apo ndijë
qënie të mendimit, nuk e di.
Mendja është një mekanizëm
i ngushtë, një lojë në duar kalamajsh.

E prapë e kuptoj nga toka emrin
dhe nga sendet, bletën, erën e lehtë,
drithërat, nata që kalon
dhe që kthehet, qiellin e kthjellët
zhubravitet si një velë liqeni.
E përmbyt bukuria lakurique dhe
pafundësive të gjërave mugullon
mendimi. Të joshur në perlën e kaltër

brenda pakufisë së zbrazët, luajmë
duke treguar botën, të përhumbur
në horizontin e ngjarjeve.

**Polemikë pa bazë*

PIKA PIKA

Poezia derdhet në botë pika pika
e vadit gjithçka.
E ndesh në ngjyrën e verdhë të duajve
shtatorakë
kur dielli vonon në shije
dhe dembele miza ulet
pa e kuptuar vjeshtën.
Shfaqet e lehtë në karpat e kaltra
të një fustani Shifon
në sytë e pasqyrës së një fëmije
të përhumbur – princeshë.

Ecën poesia me hap të lehtë mes telajove
të një fabrike mashtruese,
vrapon mes gishtave të huaja pa ëndrra
që zbukurojnë dantellat e fustaneve
që veshim.
Më pas ndalet në ato fytyra
me rima të shtrembta, si bajamet e harruara
në hapësira fushash me oriz.

A nuk e ndjen në ajër aromën e shiut?

Përktheu: Arjan Th. Kallço



Nga tradita 16.3. Vaj në pëlhurë 70x80 2016



NATALIA TREVINO

(SHBA)

E lindur në Meksikë, Natalia u rrit në Teksas, ku nëna e saj i fliste vetëm spanjisht dhe mësoi anglisht nga programi i televizionit për fëmijë “Ruga Sesam”. Natalia ka fituar disa çmime për veprën e saj duke përfshirë Çmimin “Alfredo Cisneros del Moral”, Çmimin e Poezisë “Dorothy Sargent Rosenberg”, Çmimin letrar për romanin e saj që është duke u shkruar, nga “Artist Foundation of San Antonio”, si dhe Çmimin e poezisë “BorderSenses”. Ajo është autorja e librit *Lavando La Dirty Laundry* (Mongrel Empire Press) dhe librit të ardhshëm popullor *VirginX* nga Finishing Line Press.

SHKRITORE

U rrita nën pirqje marramendëse tymi
disa blloqe larg shtëpisë së gjyshes.

La Fundidora, shkritorja e çelikut, tubacione të errëta
ngjyre portokalli

të dala - oxhakë të stërmëdhenj mbi shtëpitë e
fqinjëve.

Tyrtaja të mandarinta ngritëshin në re në një lym të
vazhdueshëm përpjetë.

Në një natë të çelët, e kaltra e portokalltë ndezte qiellin
flakë mbi majat e çatave të afërta,

qirinj romakë me maja të bardha me të cilët vetëm një
perëndi mund të merrej,
ose ndonjë rival i King Kong-ut; shkëlqimi i tyre
shndriste më shumë se
drita e hënës së mugët kundrejt netëve të errëta pa yje.

Si fëmijë çuditeshe pse tymi ishte i portokalltë si
karotat.

Nëse kjo ishte ngjyra e preferuar e dikujt. Çfarë
ndodhte

që nganjëherë e kthente tymin të bardhë dhe flakën të
kaltër pas muzgut.

Nëse flakat ishin si yje,
të padukshme gjatë ditës. Habiteshe se si planeti ynë
rrotullohej përreth diellit dhe ç'do të ndodhte po të
humbte rrugën. E pyesja veten

për besimin se a ishte e vërtetë ajo që mësonim në
shkollën time amerikane.

Dita a shkonte vërtet në Australi apo Afrikë gjatë natës
sonë?

Pyeteshja nëse lufta bërthamore ose pengjet që kthehen
në shtëpi

kishin rëndësi në klasat e kushërirës sime këtu pranë
shkritores?

E dija që karburanti ishte i shtrenjtë në të dyja anët e
kufirit,

që rryshfeti funksiononte vetëm në Meksikë

dhe ky qiell afër shtëpisë së gjyshes sime kundërmonte
naftën e papërpunuar. Emri i këtij qyteti përkthehej si
mbreti i maleve

dhe në të vërtetë kurorëzohet nga male tymuese.

Mezi shihja majat e tyre të gjelbërta nëpër tavanin,
nëpër renë e blozës, nëpër mbulesën e errët prej
kajsie, nëpër mjegullën e pluhurtë prej balte,

pyeteshja pse nuk ishte e lehtë të luaje jashtë,
pse gjithçka, madje gjyshi dhe xhaxhallarët e mi
mbanin erën e pikës së karburantit prapa qoshes.

Prandaj i testoja gjërat: nuhasja portokaj në dyqanin e
Don Marco-s,
mollët i mbaja afër para se kafshoja, për të siguruar
që ishte fruti i vërtetë që jetonte nën lëvoret e tyre.

Ishte era e bojës së re që ngritej
kur hapja një kuti me këpucë të reja,
gomë e djegur, tymra fabrike të futur në karton.

Në moshën nëntëvjeçare vura re që asnjëri nuk kishte
kopsht -
që luanim në korridore betoni
midis shtëpive, të gjitha ato vite.

Zonja Cunningham na mësoi për shiun acidor.
E pyeta veten nëse ai që e kishte bërë ajrin kështu.
Dhe nëse ishte për këtë që më quanin meksikane të
pistë,

ngaqë makinat, aq shumë, dhe autobusat, që
digjeshin dhe frynin
tymrat e tyre, ngaqë plehrat, mbeturinat në zjarr nëpër
verandat,
ngaqë unë isha nga të gjithë këta gazra djegieje këtu
poshtë.

E vrisja mendjen se si t'i pastroja të gjitha, me
detergjent,
copat e mbeturinave që nuk lejoheshin në Teksas.
Atje pashë një ëndërr të keqe se u asfiksova:

mbajta valixhen time me kukullën Barbie, si në çfarëdo
dite tjetër,
gjyshi më çoi në shkollë me Volksäagen-in e tij blu të
çelët.
Tymrat futeshin brenda si tymi i cigares, aq familjar për
mua sa lëkura;

me garazhin e vajisur gjithmonë në veshjet e tij sepse
mekanikët
punojnë në garazhe dhe duart e tyre, me gishtat e
mesëm mungues,
mbajnë biomën e Penzoil-it, Pemex-it dhe një grimë
sapuni Ariel pas drekës.

Përçafimet e tij kishin erën e zhurmëmbytesve që
prisnin riparim në garazhin e tij,
dhe në këtë ëndërr, me mua dhe valixhen time
të lyer rozë plot rroba kukullash, ajri jashtë makinës së
tij

u rrëmbye nga qielli. Si ëndrra që pashë për bombën
atomike:

isha në verandën e përparme, dëgjova sirenën nga
diku përtej oxhakëve.

Qielli i mugët i portokalltë u kthye i bardhë. Pa asnjë
zhurmë.

Një shpërthim më përshkoi. Befas asnjë rrugë. Na
kishte vrarë të gjithë.

Dija që të gjithë në familjen time ishin bashkë, por ikur
në të bardhën.

Pastaj një turmë e jona brenda një holli. Ishte si
parajsa në hotelin Hyatt.

Kushërira-motra ime dridhej pranë ashensorit të
kristaltë

që shkoi lart në apartamentin e Zotit nën çati.

Secilit prej nesh iu dhanë pesë minuta për t'i bërë një
pyetje.

Kushërira ime e vogël ishte e përlotur kur shkuam lart.

E tmerruar. A kishte bërë diçka të gabuar?

Ç't'i thuash Zotit kur je një vajzë e vrarë
njëmbëdhjetëvjeçare?

Kur më erdhi radha të flisja,

në anglisht thashë,

Çfarë saktësisht po bën këtu?

JETA E PËRTEJME

Të vdekurit e mi më vizitojnë tani në ëndrrat,
njëri struket në dollap, me kokë të përkulur, pakëz
inkontinent.

Njëri më takon në një restaurant,
pret në një tryezë për të cilën duhet të kemi rënë
dakord në një ëndërr të mëparshme.

Askush prej nesh është i vetëdijshëm që janë të vdekur.
Ky është tani i vetmi lloji ynë vallëzimi.

Jemi të qetë, pak të sikletosur.
Nuk flasim as nuk dimë se ky është ribashkimi ynë.

Vetëm një gjumë pa shikim, një depresion, një
shqetësim elektrik
disi i madh mund të ketë fuqinë

të më pengojë të kujtoj që paskan vdekur.
Një shkulum ere, një trazirë, një ciklon mund ta fshijë
kujtesën njësoj si katastrofat.

Uraganë të atij lloji që kërkon varka dhe helikopterë
shpëtimi

lejojnë këto çarje në korenë e re të kësaj pasjete,

tërmete si ai këtë mëngjes në qytetin e lindjes sime -
ndoshta kjo qe vetëtimia sizmike që më lejoi të takoj
babin tim

përsëri për një darkë të shkujdesur, të shoh Blassy-n
përsëri, gëzofin e saj që dridhet në dollap,
një farë mbijetese, kështu e quajti veterineri kur
lëdhatoi veshët e saj të kujdesshëm.

E gjej babin në tavolinë, qilimin plot me parmesan të
vjetër, të paduruar.

Veprën e madhe të natyrës e quajti atë: Petrushkën e saj,
koka e së cilës, po ashtu plot kashtë, u thye në kalldrëm.
Bushtra jonë e shpëtimit, e turpëruar nga shurra që
pikoi mbi qilimin,

Im atë, që nuk duronte të priste për një tryezë.

SI BOSCH-I NUK VIZATOI SHËN MERIN: NJË TREGIM KRISHTLINDJEJE

Sipas "Adhurimit të Magëve" të Bosch-it

Në *Adhurimet* e *shumëfishtë* të *tij* të *Magëve*
ai nuk e zbukuron me imagjinime karakteristike,

nuk e ngjit gjoksin e saj në fytyrën e një bufi
ose le të fluturojë një luleshtrydhe në qafën e mitrës
së saj,

por paraqet fytyrën e saj të thjeshtë, të lyer me krem,
rrobat e saj monotone: ngjyre marine, një shenjë
smeraldi,

pelerinën e saj të fshikulluar si një guaskë në një
kaçurrel të erës.

As nuk i jep një aureolë me një sferë të tejdukshme.

Sikur t'i lejohej vetëm një vështrim të saj,
sikur të mos kishte kohë të pozonte për një tjetër
Adhurim e ulur.

Megjithatë tunikat e magëve pikojnë në xhufka, pika të
mprehta
që sfidojnë ligjet e gravitetit.

Një përkrenare metalike varet si rastësisht nga dora e
një burri
të çuditshëm pothuaj lakuriq dhe kurora e Baltazarit

në mënyrë të përshtatshme stolis dyshemenë.
Një panoramë lufte dhe jete, bashkë me qenin e sulmit

mbi kreun e Virgjëreshës.
Një bishë ushqehet nga zorrët e një burri

dhe Betlehemi është i plotë me një mulli ere.
Por ylli mbi Betlehemin nuk është ylli i pikturës.

Është kofsha e zbuluar e atij burri, gjoksi i tij i zbehtë,
nyja e këmbës
dhe krahu i veshur në një prangë dhe zinxhir filigran.

Pëlhura e tij e leshtë i bie përgjysmë nga trupi:
një pamje e rrallë në ndonjë *Adhurim*.

Supi i tij i zhveshur mbështetet brenda.
Shumica thonë që qenka antikrishti. Duket se askush
nuk e di.

Unë di që madhësia është e rëndësishme në pikturat
mesjetare,
dhe ky burrë, i gjatë si magët

adhurues, josa e tij thuaqse e dalë
nga veshjet e tij i përket kësaj historie.

Bosh-i njihje Mrekullinë e Merit,
Zonjës së ëmbël e Den Bosch-it nga qyteti i tij i lindjes.

Si një burrë që udhëtonte nga Flamandia u arrestua
gabimisht
më 24 dhjetor. I lidhur me pranga në murin e burgut,

dhe në çastin kur thirri emrin e saj,
zinxhirët u thyen. Sa i falënderoi me një pelegrinazh

nëpër ajrin e akullt verior
dhe eci miljen e fundit drejt saj plotësisht i zhveshur.



Tendencë për fluturim. Vaj në pëlhurë 100x90 2018



NDUE UKAJ

(KOSOVË)

Ndue Ukaj (1977), shkrimtar, kritik i letërsisë dhe publicist. Është i përfshirë në disa antologji të poezisë, brenda dhe jashtë vendit. Poezitë dhe tekstet e tij janë përkthyer dhe botuar në anglisht, spanjisht, italisht, rumanisht, finlandisht, kinezisht, suedisht, turqisht, dhe janë botuar në shumë revista. Është autor i librave: *"Diskursi biblik në letërsinë shqipe"*, 2004, *"Ujëvarat e metaforave"*, 2009, *"Godo nuk vjen"* 2010, *"Ithaca of the Word"* 2010, poezi, *"Godo is not coming"* 2010, *"Arka e shpëtimit,"* 2012 dhe *"Gjithmonë diçka mungon"*, 2017 dhe *"Krimi i dashurisë"*, 2017.

Libri me poezi *Godo nuk vjen*, u laureua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli", për librin më të mirë të botuar me poezi në vitin 2010. Në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë, "Ditët e Naimit", u laureua me çmimin për poezinë më të mirë. Revista letrare *The International Poetry Translation And Research Centre*, që botohet në Kinë, më 2014, e ka vlerësuar një nga poetët më të mirë të botuar në vitin 2013 në këtë revistë. Po ashtu, ka fituar çmimin *Creativity prizes*, në *Naji Naaman's Literary Prizes 2016*.

Është anëtar i Drejtorisë së Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë, "Ditët e Naimit."

Është vlerësuar edhe me mirënjohje dhe çmime tjera letrare. Ukaj është anëtar i PEN-it në Suedi.

ALGORITMET E ZEMRËS

Perandoria e zemrës nuk ka ushtri, buxhet të menduar
për disa vite,
as drafte të hartuara nëpër konferenca të gjata, ku
harxhohet shumë letër
dhe flitet me tension.
Algoritmet e saj janë krejt ndryshe.

Një dhe një mund të mos bëjnë dy.

Asaj nuk i duhen shpikjet e kohës: doktrinat, shkollat,
Formulat e ndryshme për sukses, as për lumturi.
Nuk i duhen flamujt e fitoreve,
Që mbahen në duar të papastra nga ata që presin të
hyjnë në portat e triumfit.

Ajo është mirë, e qetë, pranë një peme, në livadhin e
shpirtit
Ku ka lule. Një lum të qetë dhe zogj të gëzuar.

Ajo nuk e duron rrebeshin e shtizave
Që vërsulen padrejtësisht,
Si ushtarë të tërbuar në beteja për jetë a vdekje.

Unë kam besuar në fenë time të dashurisë;
Atë perandorinë më të madhe të shtrirë përtej lëkurës
së ngushtë të tokës.
Ajo nuk ka sipërfaqe, kufi, rregulla dhe lojëra.
Ajo është një zemër e fortë;
Një zemër e dashur që ushqehet me lajme të mira
Dhe përjetëson algoritmet e zemrës.

BILETA

Biletat i blejmë me çmimet që i përcakton tregu.
I kalkulojmë ndjenjat, mërzinë dhe gëzimin;
Dashurinë minus mungesën e saj.
Dhe e shohim sesi matematika na shpie në rezultate të
gabuara.

Gabimisht e blejmë biletën e pikëllimit.
Dhe të hutuar mbesim në stacionin e shpresës-
presim ditën e re që të mbyllim portat e gabuara.
Shkojmë në teatër dhe e marrim biletën për dëfrim,
por Tartufi na tregon se shpirti koprrac i botës jeton në
çdo kohë.

Ne gudulisim vetveten dhe nuk hapim bebëzat të
shohim

të vërtetën në sy, sepse hipokrizia është e modës.

Një ditë tjetër- Hamleti ngjitet në skenë dhe me
shikimin e mbrehtë,

i llastuar pëlçet nga pezmi. Ai sheh shumë fantazma
që grisin rrobat e lirisë.

Por ne mbyllim sytë, sepse hipokrizia na pëlqen.

Ndonjëherë si të hutuar nëpër stacione ardhjesh e
pritjesh gabojmë rrugën.

E presim trenin që shpie ka gëzimi, por ai na çon në
dyert e trishtimit.

Të hutuar kthemi prapa dhe e shohim se kemi humbë
shumë.

Një termin pune, një kafe me atë personin e dashur që
e prisnim gjatë;

apo pjesën e fundit të një romani që e lamë pa
papërfunduar.

E mbyllim ditën dhe biletat i hedhim në mbeturina,
por nesër sërish na duhet një biletë e re.

Një rrugë për të parë piktura madhështore në Luvër;
një shëtitje në katakombet e Romës;

apo një përqaftim në muzgmbremje te deti i kujtimeve
të mira.

Kur mbaron java pushojmë dy ditë.

Dhe të dielën në mbrëmje i bëjmë llogaritë, si fëmija
detyrat e shtëpisë:

Parat janë harxhuar, muaji ka edhe ca ditë.

Duhet të blejmë biletën mujore për më shumë dashuri;
apo për dhimbje

më të gjatë.

Në fund të muajit kalkulatori i ndjenjave bie përtokë

Dhe përnjëherë çohemi peshë.

Muaji që vjen është më i mirë- vjen pranvera dhe ditët janë të gjata,
Ose bie pikëllimi dimëror- dhe netët janë më të gjata.

Njëmend: gjithmonë varet prej nesh çfarë bilete blejmë.
Dhe ku e ngulim flamurin e mërzisë dhe ku atë të gëzimit.

FRAGMENT

Ata gjithmonë ëndërrojnë tërësinë e gjërave,
dashurinë e plotë - të pafund si universi.
Një udhëtim fantastik me anije nëpër ujërat e kristalta-
ato vende të largëta, ku takimi me sytë e ditës
zgjat sa një kalim nëpër Kepin e Shpresës së Mirë.

Ata shkëputen nga gjërat e rëndomta. Nëpër ujëra të ëmbla,
flasin për dashurinë dhe imagjinojnë një kthim të madh te foleja e lumturisë.

Atje ku shtrihet Edeni si deti i pafund i qetësisë.
Ku nuk ka valë të trazuara, furtunë;
ku dielli vezullon dhe bebëzat e syve shndritin si
kristale mëngjesore,
ashtu siç shndrit lulja në një ditë të bukur pranvere.

Ata marrin fragmente të lumturisë, por tërësinë e kanë synim.

Gjerbin kafënë e shpresës dhe harrojnë se
në Eden gjithmonë është një pemë e ndaluar;
një pemë tunduese dhe me fruta plot.

Ata e shohin vetëm pjesë të mrekullisë: ujërat e ëmbël dhe yjet në qiell,
nëpër misteret e një ëndrre që shpaloset përditë.
Siç shpaloset intriga e një historie kur lexon aventura udhëtimi.

Për shembull- kur Odiseun e përvëloi malli për Itakën dhe shtratin e ëndrrave të patrazuara.

Ata shpjegojnë të kaluarën dhe pjesën tjetër e lënë për nesër;
për një agshol mëngjesi që e presin tash e sa kohë.

Rinë më këmbë të shtrira ka qetësia,
por papritur një re turbulluese tundon qiellin: pritët shi dhe bubullimë.

Dhe shpejt mbledhin gjërat për dimrin e shpirtit.
E shikojnë prapa një pranverë që iku dhe një tjetër që e presin tash e sa mote.

Oh, ata thyjnë harqet e dëshpërimit,
duke e kuptuar vonë se jeta është fragment dhe merr nektarin e poezisë
dhe shkruan dramën e përditshmërisë-
Atje ku shumë personazhe përbëjnë një historie, në të cilën secili ka një funksion.

ATDHEU IM

Atdheu im është një shtëpi e madhe,
Me dyer të vjetra dhe dritare të reja për ajrosje. Atë e kanë punuar shumë duar.
Dikush ia vuri themelet, por kur u ndërtuan muret- u tha se ishte mot i keq. Kulmi u qëndis me duar nga nuset e reja që hedhin valle dhe flisnin për dashuri. Atë vit pati shumë erëra dhe stuhitë. Pemët u shkulën me rrënjë dhe kopshti i historisë sime u grabit.
Qe dëgjuar nëpër tregime të mbretërve pa emër- se n' borë mbetën të ngrirë shumë kalë e kalorës.
Atëbotë nuset u mbyllën në bodrume, pinin raki dhe ruheshin t' mos binin sërish në dashuri.
Ato thurnin ëndrra për stinën e tyre, por stuhia nuk pushoi gjatë. Në kronikat e kohës u tha se, një magjistër i vizitoi për çdo natë dhe nuk i la të mërziteshin.

I ngushëlloi me tregime dashurie,
deri kur kumti për kalorësit çau tejpërtej errësirën,
dhe u dëftua në portat e shtëpisë. Atëherë kulmi ra
përtokë,
si trup qiellor që e përplasin perënditë e mallkimit.
Dhe shtëpia u nda si një xham i thyer.
U dashtë shumë kohë që me duar të përgjakura të
niste një rrëfim i ri.
Por atdheu im ende nuk e ka shtëpinë e plotë.
As nuk i kupton tregimet misterioze që i vërtiten
si yje në natën kur hëna nuk shkëlqen-
dhe njerëzit si të shastisur bërtasin “të kujt jemi ne.”



NARIN YUKLER

(TURQI)

Narin Yukler u lind në Şanlıurfa të Turqisë, në vitin 1988. Ajo u diplomua në shkollën e Menaxhimit të Hoteleve dhe Turizmit në Universitetin e Gaziantep dhe në Fakultetin e Administrimit të Biznesit të Universitetit

Anadolu. Pas diplomimit, ajo filloi të punoj si menaxhere hotelesh. Ajo u martua në vitin 2012, dhe ka vajzën e saj në vitin 2014. Gjatë asaj kohe, ajo mori pjesë në aktivitetet e organizatave të ndryshme joqeveritare dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht organizatat e drejtave të grave. Në vitin 2011, ajo u padit nga Qeveria për arsye se, ajo mori pjesë në një deklaratë për shtyp të Shoqatës së Drejtave të Njeriut Şanlıurfa. Në vitin 2014, ajo u dënua me 10,5 vjet burg për shkak të atij rasti dhe për këtë arsye ajo duhej të linte punën e saj dhe të ikë nga rrethi i Duhokut në qeverinë rajonale të Kurdistanit (të Irakut) me burrin e saj dhe femijen 40 ditë te porsalindur. Shumë nga historitë dhe poemat e saj të shkruara rreth Lindjes së Mesme, veçanërisht të drejtave të grave u botuan në disa gazeta dhe revista në Irak, Belgjikë, Palastinë, Iran, Holandë, Poloni, Angli, Indi, Kinë, Kore, SHBA, Afrike dhe Turqi. Ajo mbajti takime në kampet e refugjatëve, ku lexoi poezitë e saj të shkruara në gjuhën kurde dhe ate turke. Ajo ka shkruar vepra teatrale mbi të drejtat e njeriut dhe të grave, disa prej të cilave i ka organizuar. Ajo është drejtore kurde e WCIF (Fondacionit Nderkombetar Kapital te Shkrimtarve), anëtare e WNWU (Unioni i shkrimtareve botëror

kombetar), HPAW (Princi Afrikan i botes se Artit), WFP (Festivali Botëror i Poezisë).

Librat e saj:

Aynadaki Çürüme (poezi turke) / 2017

Rê û Rêç (poezi kurde) / 2018

Çmimet e saj:

Çmimi Hüseyin Çelebi Story (2.) (2015)

Ali İsmail Korkmaz Çmimi i poezisë (3.) (2016)

Çmimi i Artë Dafne për Poetët e Rinj të Komisionit të Përzgjedhjes (2016)

Arkadaş Zekai Özger Çmimi i poezisë (2017)

Çmimi Poezise Arjen Arî (2017)

Çmimi Poezise Sennur Sezer (3.) (2017)

DUKE RËNË NGA PASQYRA

Tregime vatrash janë të fshehura në çatinë e saj

Në ngjyrën e saj ka djegie të brengës

Frugët nuk mund të përdoren për të udhëtuar

Në vrimën e shpimit ka një këngë të trishtuar të nuses
që copëton mëngjesin

Buka e bërë nga fama e shoshur hollë nxeh këmbët e
zhveshura

Mbi zjarrin është ulur trishtimi i padjegur i një nëne

Një histori pa gjumë regjistron dhoma

Në anën e pasme të derës, mami pi duhan me
kujtimet

Shumë jete reflektohen mbi pasqyrën

Vija që bie nga pasqyra vendoset nën syrin

Vajza rri e qetë me flokët e saj të gjatë

Korniza është armiku për muret nga tulla balte që nuk
i thyejnë kujtimet

Vajza që ikën fshehtas me vrap është gjëja më e keqe
për nënën

PËRRALLA UJI

Asnjë ujë nuk i prek kombet e shkretëtirës
 Këmbët vazhdojnë me erëra të ngrohta
 Shtigjet mund të shihen nga peshat e çantave
 Ngadalë i presin rërat
 Unë e vë gjuhën në anën e pasme të tasit të bakrit
 Duart e mia janë si rrugët midis gëlltitjeve
 Duart e mia shemben në Sahara
 Misteri dhe lutja rrëzohen nga fytyra ime
 Si një shtëpi që nuk ka llaç
 Fortesa dhe plaga qëndrojnë ende në gjoksin tim
 Pemët kapen pas tokave të shterura
 Epilepsia fillon nga krahët e dobët të pemës
 Cilido krah që prishet
 Cilado anë që kthehet në të verdhë

Unë e bekoj
 Shenjtorët që vijnë për t'i rrëfyer pemës
 Unë i uth me dëshirë të madhe
 Që nga dita që kam rënë në Sahara dhe në epilepsi
 Duke u mashtruar nga vrima që vjen nga plasaritjet e
 mia
 Besoj në një përrallë uji

JETË TË VJETËRUARA

Jeta është një fukara zeshkan
 Me emrat e gdhendur në pëllëmbët
 Kemi dashuri edhe në xhepat tanë
 Ajër edhe në xhepat tanë
 Shenjën e farës edhe në xhepat tanë

Ëndrra ishte shiu që shumëfishohet si lule të egra
 Dhe lan lulet e gjakut të këputura nga oborri
 Barbarizmi është zjarri që digjet në pëllëmbët
 e një vendi mbi gjuhën e të cilit fiken cigare

Është e vërtetë
 Koha
 Të cilën e lexoj nga gjuha e një nëne

Trotuaret e lagura
Se poeti i provokuar është mizor
Se shkrimtari me një stilolaps të mërguar
Ka erë lirie

- një liri e tillë;
është vatra familjare me tymrat që përshkojnë çatinë
zbret mbi zemrën time të papërfunduar -

Ndërgjegjja është skena e përbashkët e atyre
që mbajnë arkivola
dhe atyre që bashkohen në vallet popullore

Një ndërgjegje e tillë;
Është era verilindore që bie mbi ne
Një plagë e shprehur, dhe shkalla në kufi

Do të biem nëse nuk e mbajmë



BARDHYL ZAIMI

(MAQEDONI)

Bardhyl Zaimi është i lindur në vitin 1970, në f. Sllatinë të Tetovës. Mbi 20 vite ka punuar si gazetar dhe redaktor i kulturës në media të ndryshme, të shtypura dhe televizive. Ka qenë editor i dy gazetave javore në gjuhën shqipe “Epoka” dhe “National” dhe i revistës mujore për kulturë “Prokultura”. Ka bashkëpunuar me shumë revista kulturore, ndërsa ka qenë edhe kryeredaktor i TV nacional “TV-Alb”.

Krijimtaria tij letrare përfshin një periudhë gati mbi 25 vjeçare. Është botuar në revista të ndryshme kulturore dhe letrare në vend dhe jashtë vendit. Në vitin 2004 ka botuar librin e tij të parë me ese të titulluar “Fuga e fjalëve”, ndërsa në vitin 2008 ka botuar librin e tij të dytë me ese “Violinat e vjeshtës”.

Në vitin 2017 ka botuar librin e tij me poezi dhe tregime të titulluar “Dorëshkrime prej ajri”.

Brenda kohës ka qenë pjesë e shumë debateve mbi jetën kulturore dhe letrare, ndërsa vazhdon të botojë ese, kritikë letrare dhe poezi në mediat e vendit dhe të rajonit.

GJETHE TË TRISHTA MBI TROTUARE

Është vonë për shumëçka
 Pritjet janë lodhur dhe kanë ulur shikimin
 Edhe zogjtë duken të paqenë
 Mbi trotuare gjethet janë shpërndarë
 si nota të trishta
 Hapa pa vullnet ngjiten drejt mëzisë
 stolat ëndërrojnë dashnore arkaike
 Dhe iniciale përjetësie të përkohshme
 nata pa avuj trupash të ekzaltuar
 Duket si një plaf i ngjyer me katran
 në çdo qosh dyer të mbyllura frike
 Dhe heshtje sigurie neveritëse
 jeta ka mbyllur sytë e kureshtjes
 dhe kotet në skleroze
 në akuariume të kristalta ekspozohet lumturia
 Eja afrohu dhe më çik me fletët e buta
 sepse çdo gjë duhet ribërë nga fillimi

FLASIN ME TË ME SHIKIME KLANDESTINE

Matanë krizantemave tavolinave të dekoruara
 Ajo mban ritmin e natës me freski parfumesesh
 Shkrihet në jazz të butë çmendurak
 E duart i lëvizin si notat në imagjinatë
 Herë mbyll sytë e sikur kërkon pamje
 Të goditshme si në pikturat futuriste
 Zotëron gjithçka përreth me një frymë
 E bota i vjen ngushtë si fustani blu
 Edhe frymëmarrjen e ka blu siç e ka shikimin
 Të gjithë nëpër tavolina flasin me të
 Fshehurazi me shikime klandestine
 Vetëm nganjëherë ul sytë përtueshëm
 sa për t'i paqtuar padurimet
 Që i ngajjnë një trafiku të rënduar
 Ndjehet e lehtë si një pupël në ajër
 Që vështrohet nga sytë kureshtarë
 Të gjithë bashkë me të e ndjejnë thellë
 si një thikë në duart e realitetit
 Se jeta është diçka më tepër
 Teksa cigaret digjen në taketuke pa i prekur

UDHËTIM ËMBËLSISHT I HIDHUR

Nuk e di deri ku do të mbërrij me këtë karrocë të vjetër
Kuajt janë të lodhur e ngojëzat shkëlqejnë nga shkuma
Jam përkulur mbi fenerin dritëpak
Dhe e ndjej harbueshëm erën e gazit
Përreth drurë të moçëm me ngjajnë si njerëz të huaj
Kaq i huaj dhe i vetmuar qenkësh njeriu në udhëtim
frenat janë shtendosur e lëvizja është dorëzuar
Dëgjohen vetëm ca kërcitje të lehta dërrasash
Si eshtrat e harxhuara të një plaku
Harrohem dhe me harrojnë Imzot
Vetëm gjethet e njohin këtë muzikë
Që hëna e ekzekuton me dritën e saj
As kthehem mbrapa e as para mundem
Duket si një dashuri ëmbëlsisht e hidhur
Që as duam ta pushtojmë
As duam ta harrojmë
Gjithçka duket e trishtë si një ëndërr e lodhur
Si kuajt që dihasin me sy të pikëlluar
Nuk kam ku të shkoj me larg
Të gjitha vetmitë janë gjethe që fëshfërijnë
Për karrocën e mbetura maje lodhjes

PËRMBAJTJA

BEAT BRECHBÜHL (ZVICËR)	11
TOZAN ALKAN (TURQI)	27
BRAHIM AVDYLI (KOSOVË)	31
NOAH AYALA (PORTO RIKO)	35
SSLAXHANA BOJANOVSKA (MAQEDONI)	41
PIERFRANCO BRUNI (ITALI)	45
GEMA BOCARDO CLAVIJO (SPANJË)	51
YLLI ÇELA (SHQIPËRI)	55
ERINA ÇOKU (SHQIPËRI)	59
KINGA FABÓ (HUNGARI)	67
SHAIP EMËRLLAHU (MAQEDONI)	71
MARISOL BOHORQUEZ GODOY (KOLOMBI)	75
ELIZABETH GREICH (MALTA)	79
KRISTIAN GUTTESSEN (ISLANDË)	83
SITI RUQAIYAH HASHIM (MALAJZI)	87
SILKE LIRIA BLUMBACH (GJERMANI)	91
JON HØYER (DANIMARK)	95
ARJAN KALLÇO (SHQIPËRI)	99
GERRY VAN DER LINDEN (HOLANDË)	103
GIUSEPPE NAPOLITANO (ITALI)	107
ELENA PRENXHOVA (MAQEDONI)	111
PRIMOŽ REPAR (SLLOVENI)	117
REMZI SALIHU (MAQEDONI)	121
ELIZA SEGIET (POLONI)	125
GLORIA SOFIA (PORTUGALI)	129
MOAEN SHALABIA (IZRAEL/PALESTINË)	131
LUCILLA TRAPAZZO (ZVICËR)	135
NATALIA TREVINO (SHBA)	139
NDUE UKAJ (KOSOVË)	147
NARIN YUKLER (TURQI)	153
BARDHYL ZAIMI (MAQEDONI)	157

Boton
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar
DITËT E NAIMIT
Tetovë

Drejtor
Shaip EMËRLLAHU

Lektor
Ekrem AJRULI

Botimin e mbështetën
Ministria e Kulturës e R. së Maqedonisë
Logos A

www.ditetenaimit.org

CIP - Katalogizimi në publikim
Biblioteka popullore dhe universitare 'Sveti Klimen Ohridski',
Shkup

821-1(082.2)

Festivali ndërkombëtar i poezisë
"Ditët e Naimit" (22 ; 2018 ; Tetovë)
Pësjtjellim i dendur / [përgatiti Shaip Emërllahu;
përktheu Silke Liria Blumbach]. - Tetovë: Ditët e Naimit,
2018. - 164 fq.: ilustr. ; 21 cm. -
(Biblioteka Meridiane poetike. Edicioni 22)

Fotografi dhe biografi për autorët e përfshirë

ISBN 978-608-4769-14-9

COBISS.MK-ID 108539914